

Gusht 2018
Numri: 125
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Mëso të
ENDOSH



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Gusht 2018

VITI: XII

NUMRI: 125

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

I nderuar mik, student, i ri, plak apo i vjetër, burrë apo grua, a e di se ajo që e dallon dhe lartëson njeriun duke e shquar nga qeniet dhe ekzistencat e tjera është pikërisht aftësia për të menduar!

Por a e dini që, megjithëse të gjithë njerëzit mendojnë, jo të gjithë dinë të mendojnë. Ka me mijëra doktorë shkencash, magjistra, të diplomuar, nga ata që e quajnë veten intelektualë, që kanë harxhuar dhe harxhojnë me dhjetëra mijëra orë ose të gjithë jetën e tyre, duke studiuar dhe duke menduar mbi çështje të ndërlikuara, që kanë të bëjnë me fusha nga më të ndryshmet, duke filluar që nga teoritë e mësimit e të edukimit, nga studimet e komplikuar mbi gjuhën, mbi letërsinë, mbi filozofinë, mbi dokumentet dhe metodat historike e deri në çështje që kanë të bëjnë me fusha, si matematika, mikrobiologjia, informatika e deri tek nanoteknologjia e shumë të tjera.

Dija njerëzore ka arritur sot në maja të tilla, saqë përditë kjo trashëgimi e përbashkët e qytetërimit njerëzor shtohet me ritme të jashtëzakonshme, duke e bërë të nevojshme lindjen e shkencave të reja, si edhe ndarjen e shkencave ekzistuese në degë të reja, me qëllimin për ta bërë sa më të përvetësueshëm e sa më të dobishëm për njeriun këtë thesar të vyer, që është dija dhe shkenca njerëzore.

"Më jepni një pikë mbështetëse dhe me një levë mund të lëviz gjithë tokën", thoshte gjeniu i lashtësisë, Arkimedi. Natyrisht, Arkimedi si gjeni e kishte të qartë se një levë sado e mirë dhe e fortë pa një pikë të fortë mbështetjeje nuk mund të bënte shumë. Madje, pa një pikë të tillë të fortë mbështetjeje, asnjë levë nuk është në gjendje, jo vetëm të lëvizë gjithë tokën, por madje as vetveten.

Dija apo shkenca njerëzore, kjo levë e artë në duart e njeriut, nuk mund ta lëvizë botën, pa një pikë të fortë mbështetjeje. E shumta, mund të krijojë iluzionin se po e bën një gjë të tillë, por në fakt, në vend që ta lëvizë botën dhe qytetërimin njerëzor drejt lartësive të merituar, nuk do të bëjë tjetër veçse do ta rrokullisë në një greminë, fundi i së cilës nuk dihet, por gjithsesi është i padenjë për këtë qenie të mrekullueshme, siç është njeriu.

Thelbi i dijes qëndron në aftësinë për të dalluar atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme, do të thotë të dish vlerën dhe rendin e gjërave. Nëse një shkencëtar i diplomuar në inxhinieri gjenetike, në vend që të merrej me këtë fushë të shkencës, duke e kërkuar kënaqësinë aty ku ka studiuar aq vite, do të shpenzonte kohën e tij duke thurur barcaleta e skeçe për estradë, natyrisht që kjo do të ishte shpërdorim i asaj dhuntie të çmuar që është mendja. Edhe pse fusha e humorit, që përbën një dije më vete dhe me vlerë, do t'i dukej më kënaqësishmë, për të mund të thuhet se nuk di të mendojë, mbasi nuk di të shquajë atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme.

Por gjërat e rëndësishme nuk janë medoemos më të komplikuarat. Duhet të fillojmë të mësojmë alfabetin nga gërma *a*, domethënë nga e para dhe jo nga e mesit apo e fundit. Fakti që e shohim botën përditë e më shumë përmes dritares së vogël të televizionit, nuk na bën më të mençur sesa po ta shikonim përmes fushëpamjes së gjerë e të gjallë të realitetit. Është një hap shumë pozitiv fakti që sot shumica e njerëzve dinë të lexojnë, se analfabetizmi po bëhet përditë e më tepër një kujtim i hidhur i së kaluarës, por fakti që dimë të lexojmë nuk na garanton aspak se dimë gjithashtu edhe të mendojmë. Gjakatari Beshir el Asad, edhe pse (ç')njeri i shkolluar, edhe pse e ka të qartë fundin e vet në koshin e fundërrinave të historisë, prapëseprapë nuk i dorëzohet arsyes. Me të tillë mendjembrapshtë kjo botë ka qenë e mbushur përherë plot e përplot. Përndryshe, nuk mund të shpjegohen gjithë ato luftëra, masakra e shfarosje masive, që njerëzimi ka provuar kohë mbas kohe...

Përmbajtja



Jeta me lutje
Ali Riza Temel

16



Adhurimi
Nexhla Gynaj

7



Bajrami i Kurbanit
Edukimi i sakrificës
Osman Nuri Topbash

34



12



O drita e syrit tim!
Neslihan Nur Turk

40

- 5 Korniza e personalitetit të besimtarit
Ahmet Tashgetiren
- 8 Leximi i Ajetit Kursij
Xhafer Durmush
- 10 Besimi në Allahun
Prof. dr. Jashar Kandemir
- 12 Ndjeshmëria ndaj shpërdorimit ose etika e konsumit
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 15 Mëso të mendosh!
Dr. Ardian Muhaj
- 19 Rreziku i ndryshimeve dytësore
Muhamed Gazali
- 20 Dy bazat e një shoqërie të endërruar
Ma. Luan Afmataj
- 22 Fjalë që vuajnë nga mungesa e përdorimit
Edison Çeraç
- 23 Urtësi



56

- Veprat që të shpien në xhenet 24
Dr. Murat Kaja
- Agjërimi si kurë ndaj kancerit 28
Mikro Univer
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32
- Vlerësimi i mundësive 42
Xhemal Nar
- Shija e jetës 46
Mehmet Dinç
- Mund të fle edhe në stuhi 47
A. Jasin Demirxhi
- Mesazhi i fjalës së bukur 48
Idris Arpat
- Varfëria, fanatizmi dhe fetaria e thatë 52
M. Muhtar Esh-Shenkiti
- Ruajtja nga përgojimi 55
Sadik Dana
- Ushqime natyrore apo përforcuese? 56
Dr. Ali Akben



44

Marrëdhëniet
besim-moral në Islam
Prof. dr. Iljas Çelebi



Gruaja e parë myslimane
Adem Saraç

50



Korniza e personalitetit të BESIMTARIT

— Ahmet Tashgetiren —

Termat me të cilët Zoti përmend disa lloje njerëzish në Kuran janë: besimtar, monoteist, i devotshëm, mysliman, ateist, mosmirënjohës, politeist, femohues dhe hipokrit.

Katër termat e parë shprehin tipet pozitive, kurse pesë termat e tjera shprehin tipet negative.

Kurani kërkon mbrojtjen e personalitetit njerëzor me katër veçoritë e para dhe qëndrimin larg pesë veçorive të tjera.

Midis katër tipeve pozitive, tipi “besimtar” është më gjithëpërfshirësi. Besimi shpreh krijimin e komunikimit të njeriut me Zotin.

Besimi fillon me “amentu” (besoj), por nuk mbaron me “amentu”.

Në Kuran është një ajet që thotë: **“O besimtarë! Besoni!”** (Nisa, 136.)

Por është edhe një ajet tjetër: **“Vërtet mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?!”** (Ankebut, 2.)

“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: ‘Ne besojmë’.

Thuaju: ‘Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: ‘Ne përulemi’, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja.’ (Huxhurat, 14.)

Ajeti i parë u kujton besimtarëve besimin, u kërkon atyre forcimin, pastrimin, mbajtjen gjallë dhe të freskët të besimit në zemrat e tyre. Ajeti sikur thotë që puna e besimit nuk mbaron thjesht me të qenit besimtar, por atij i duhet shtuar përpjekja dhe veprimi.

Edhe dy ajetet e tjera po të njëjtën gjë theksojnë.

Surja Ankebut na informon që pas besimit ka sprovë dhe vetëm pas këtij testi dhe provimi, besimi konsiderohet i vërtetë dhe i sigurt.

Kurse ajeti i sures Huxhurat na informon se deklarimi verbal **“Amentu” (besova)** i siguron njeriut vetëm hyrjen në Islam, sepse çështja e besimit është shumë më e thellë dhe e gjerë, madje sipas ajetit nuk mjafton vetëm deklarimi verbal, nuk konsiderohet **“iman”** vetëm shqiptimi me gojë i besimit. Allahu në mënyrë të qartë dhe qortuese u thotë: **“Ju nuk keni besuar.”**

Pse nuk kanë besuar?

Sepse **“Besimi ende nuk ka hyrë ne zemrat e tyre.”**

Nga kjo pjesë e ajetit kuptojmë që njeriu duhet të realizojë një udhëtim drejt zemrës së tij dhe besimi i tij do ta fitojë vlerën e vërtetë vetëm përmes realizimit të këtij udhëtimi.

Ajeti **“ O besimtarë! Besoni...”** na tregon se për një besim cilësor duhet ndërtimi i një strukture të personalitetit sipas atij besimi.

Pra çështja nuk mbaron me deklarin verbal.

Në fakt shyllat e besimit, të cilat përfshihen në fjalën **“Amentu”** përcaktojnë dhe paraqesin një strukturë personaliteti. Besimi tek Allahu, librat, pejgamberët, melekët, Dita e Gjykimit dhe tek caktimi i Allahut... Të gjitha këto shtylla janë pjesë të domosdoshme të besimit. Deklarimi **“besoj në Ahiret”** dhe të jetuarit në këtë botë sikur nuk ke për të dalë një ditë para Allahut për të dhënë llogari, kurrë në fakt nuk është **“besim në Ahiret”**. E njëjta gjë është edhe me librat. Deklarimi **“besoj librat”** dhe bërja e një jete krejtësisht në kundërshtim me mësimet e Kuranit, deklarimi **“besoj pejgamberët”** dhe ndërtimi i një jete në kundërshtim me mësimet e Pejgamberit (a.s.), nuk mund të konsiderohet një jetë brenda strukturës së imanit.

Udhëtimi nisët me **“amentu”**, por nuk mbaron me të. Duhet që personi që pretendon besimin dhe lidhjen me Allahun të ndërtojë një jetë sipas mësimëve të besimit.

Nëse beson ekzistencën e botës tjetër dhe gjykimin në të, atëherë përpiku të bësh një jetë të atillë në këtë botë, që të dalësh faqebardhë atje.

Për të ndihmuar njeriun, Allahu i ka treguar atij të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të gabuarën.

Në Kuran ekzistojnë me qindra ajete, që fillojnë me **“O Besimtarë”**. Të gjithë këto ajete përcaktojnë kornizën e jetës sipas kritereve hyjnore, përfshijnë të gjitha detajet e personalitetit të njeriut.

Ajetet përfshijnë një zinxhir sjelljesh, që zgjatet deri të mirësjellja dhe respektimi i prindërve.

Ecja me kryelartësi konsiderohet mendjemadhësi dhe diçka e padëshirueshme nga Allahu.

Thashethemet konsiderohen të pështira, të ngjashme me ngrënien e mishit të vëllait të vdekur.

Përkëdhelja e jetimit, kujdesi dhe ruajtja e pasurisë së tij, ndihma pa kushte ndaj nevojtarëve... janë shkaqe për të fituar dashurinë e Allahut dhe Xhenetin.

Ironia, qesëndia dhe përqeshja janë të ndaluara.

Vargu i zinxhirit që vizaton personalitetin e besimtarit vazhdon me përgjegjësinë për veten, për pasurinë, fëmijët dhe të gjitha mirësitë e dhuruara nga Allahu, për të vazhduar më tej me zhvillimin e një ndjeshmërie sikur e shikon Allahun dhe vetëdijshmëria për vëzhgimin e vazhdueshëm të Tij mbi ne dhe afrimitetit të Tij.

Pejgamberi (a.s.), na informon se besimi përbëhet prej 73 pjesësh dhe më e çmuara është fjala **“La ilahe ilallah”**, kurse më pak e çmuara është pastrimi dhe heqja e diçkaje që pengon njerëzit nga rruga. Dhe turpi është prej imanit.

Konkludimi i parë që nxjerrim prej hadithit është: Besimi nuk është i kufizuar vetëm me gjashtë kushtet e besimit, por zgjatet deri te pastrimi i rrugës nga një pengesë.

Në fakt, këto 73 pjesë përbëjnë gjithë kornizën e personalitetit të myslimanit.

Ajetet që fillojnë me **“O Besimtarë!”** një personalitet të tillë ofrojnë dhe thurin për besimtarin.

Nga kjo që parashtruam, arrijmë në përfundimin se personaliteti i myslimanit është një i tërë dhe të gjitha ajetet që fillojnë me **“O Besimtarë!”** u drejtohen atyre që e ndjejnë dhe e përkufizojnë veten si besimtarë.

Në të drejtën islame është debatuar dhe trajtuar gjerësisht marrëdhënia besim-veprim. A është vepra pjesë e besimit apo jo?

Në përgjithësi është pranuar se vepra nuk është pjesë e besimit. Për shkak se humbja, dobësimi, dhe pakësimi i besimit është si humbja e gjithë njerëzimit, është preferuar mendimi se mungesa e veprës nuk e dëmton besimin. Por është pranuar gjegjësisht se disa vepra e dëmtojnë rëndë besimin. Për shembull, një fjalë e vetme nënçmuese për Kuranin dhe Pejgamberin (a.s.), e çon njeriun drejt blasfemisë.

Shuma e sjelljeve të inkurajuara nga Kurani, për besimtarin përbën tërësinë e personalitetit të tij, prandaj braktisja e çdo sjelljeje të urdhëruar dhe përfshirja e çdo sjelljeje të gabuar çon në rrënimin e së tërës. Për shembull, nëse personaliteti i myslimanit quhet i përmbushur me praninë e 100 cilësive dhe në një person gjenden vetëm 50 cilësi, atëherë tërësia është dëmtuar në masën 50 %.

Një dietolog, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara, kërkon prej pacientit zbatimin me përpikmëri të dietës. E njëjta gjë vërehet edhe në jetën e njeriut. Islami është një dietë hyjnore për njerëzimin.

Për të gjitha organet e njeriut ka dietë, si për dorën, këmbën, syrin, veshin dhe zemrën. Mirëfunksionimi i organizmit bëhet i mundur përmes mirëushqyerjes dhe jetës së rregullt, kurse kequshqyerja dhe jeta e çrregullt e bën të pamundur funksionimin normal të tij. E njëjta gjë ndodh edhe me sjelljet e njeriut. Braktisja e sjelljeve të mira dhe mbingarkesa me sjellje të këqija e bën të pamundur funksionimin normal të shpirtit të njeriut.

Prandaj, duhet bërë përpjekje për rritjen cilësore të jetës sonë fetare. Duhet të përpiqemi me gjithë qenien tonë për një jetë brenda kornizave hyjnore.

Sepse **“Kthimi është tek Ai.”** (Gafir,3.)

Në fund **“do të ktheheni tek Ai”**. (Bekare, 28.)

Kurse të dështuar: **“Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me Allahun!”** (En’am, 31.)

ADHURIMI

— Nexhla Gynaj —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Prandaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përuken Atij duke u falur! Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 98-99.)

Koha për të zbatuar urdhrat e fesë sublimë të cilës i përkasim, është e caktuar. Çdo besimtar që del nga fëmijëria dhe arrin kohën e pubertetit, është i obliguar ta adhurojë Allahun Teala derisa t’i vijë vdekja.

Ai që nuk e vendos kuroren e ibadetit si kundërvlerë ndaj mirësive të pafundme të Zotit (xh.xh.), do ta humbasë shansin për të shkuar me anijen e shpëtimit në audiencën e Allahut të Madhëruar. Myslimani është i obliguar ta zbatojë Islamin në çdo fushë të jetës. Zbatimi i Islamit bëhet duke iu bindur urdhrave dhe duke u larguar nga ndalesat. Besimtari duhet ta programojë dhe sistemojë rrjedhën e jetës sipas Islamit.

Lidhja jonë më e fortë me besimin është ibadeti. Çdokush që i kryen adhurimet pa mangësi, i jep vlerë permanente çdo fjale që nxjerr nga goja dhe çdo veprë që mund të bëjë. Të ndërjet e kënaqësisë së thellë e të qenët rob i Allahut Teala, nuk qetëson vetëm shpirtin, por, në të njëjtën kohë, rregullon edhe jetën e përditshme.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vërtet, numri i muajve të Allahut është dymbëdhjetë..” (Teube, 36.) Prandaj kërkon nga rob i ta sistemojë jetën brenda një plani, të mos i çojë dëm muajt, ditët e orët dhe të mos e nxjerrë nga mendja llogarinë që do të japë për to. Kur bëhet fjalë për ibadetet, myslimani nuk mund të shprehet kurrë: “Nuk po gjej dot kohë.” Ata që largohen nga adhurimi, duke u strehuar prapa preteksteve, nuk duhet të harrojnë se në asnjë mënyrë, nuk do të kenë mundësi të bëjnë pazarllëk me Azrailin.

Nënvlerësimi i afrimit të Allahut Teala me anë të ibadeteve, i shkatërron


edhe ndjenjat shpirtërore. Atëherë, agjërimi shndërrohet në kursim dhe bujaria në harxhim të tepruar.

Sa përplasje skandaloze është preteksti ndaj farzeve dhe suneteve të njeriut të sotëm, i cili ndan kohë për çdo lloj preokupimi që nxit dëshirat vetjake!.. Ndërkohë që njeriu e harxhon kohën bujarisht ndaj këshilluesve artificialë të kohës, ankohet se nuk gjen kohë për ibadet, për të mbajtur lidhjet me të afërmit dhe për të vizituar miqtë. Në këtë mënyrë, e humb kohën me justifikime të pavlefshme.


Shkalla e parë e ibadetit është namazi. Ky adhurim themelor, që i Dërguari i Allahut (a.s.), e përshkruan si “Shtylla e fesë”, i shkatërron të gjitha shqetësimet, pengesat dhe shtrembërimet e mëparshme. E rregullon drejtimin e të gjitha sjelljeve. Çdo fjalë dhe çdo veprë që nuk na afron të Krijuesit, nuk ka ndonjë dobi për jetën tonë, sepse jeta e merr vlerën nga Ai. Nuk ka njeri më të fortë se një rob që flet në namaz me Zotin e tij. Nuk ka njeri më të lirë se një rob që e ka bërë traditë kërkimin vetëm nga Zoti (xh.sh.), me lutjet e sinqerta, që i vijnë nga thellësitë e zemrës dhe i dalin nga gjuha.

Shqetësimet që vijnë nga vështirësimi i vetes dhe vesveset e shejtanit përgjatë ibadeteve, e pjekin zemrën dhe e përsosin besimin. Le t’ia vëmë veshin sihariqit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), në mënyrë që të mos bëhemi prej atyre që e konsumojnë jetën me pretekte:

“Lum për atë që e ka jetën e gjatë dhe veprat e mira!” (Tirmidhi)



Leximi i ajetit Kursij



— Khafer Durmush —

Ajeti 255, i sures Bekare, madhështinë e së cilës e ka vërtetuar edhe Profeti ynë (a.s.), është shprehja më e përmbledhur që tregon Madhështinë e Allahut Teala. Ajetu'l-Kursij...

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin), përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd, pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u 43 i Tij, shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (Bekare, 255.)

Në Ajetu'l-Kursij, i cili përbëhet nga dhjetë fjali, deklarohet në mënyrë të përmbledhur besimi i teuhidit¹, duke na bërë të ditur njësinë e Allahut, gjallërinë dhe përjetësinë e Tij, të qenit larg prej dobësive njerëzore, si gjumi apo hutimi, menaxhimin e gjithësisë nga ana e Tij, domosdoshmërinë e lejes së Tij për të ndërhyrë tek Ai, dijen e Tij, që përfshin gjithçka, pa fillim dhe pa fund, shtrirjen e fuqisë

së Tij, që përfshin gjithçka, në qiej e në tokë dhe Madhështinë e Tij.

Kuptimi i fjalës **“kursij”**, e cila përmendet në ajet, nuk është “froni” që njohim ne, por është diçka që i shkon për shtat vetëm Madhëstisë së Allahut Teala dhe përbërjen e tij nuk e di tjetërkush, përveç Tij.

Hajj: Në fjalor shpjegohet me fjalën i gjallë. Kjo është një nga cilësitë e larta të Allahut dhe do të thotë se qenia e Tij është e vazhdueshme dhe e pandërprerë, pa fillim dhe pa fund.

Kajjum: Do të thotë se Allahu është Ai që i menaxhon dhe u kërkon llogari të gjitha krijesave.

Sine: Do të thotë dremitje. Në këtë ajet, pjesa mohore “la”, që gjendet midis fjalëve “sine” dhe “neum”, të cilat përkthehen: “Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi”, i përfshin të dyja këto fjalë.

Pra, në çështjen e menaxhimit dhe kontrollit të gjithçkaje që ekziston, nuk mund të flitet për gabim, shkujdesje, mërzitje dhe ngathtësi të Allahut Teala. Këto dobësi, që u takojnë vetëm krijesave, nuk mund t’i atribuohen Atij, sepse Ai është cilësuar me veti të përsosura dhe është i pastër nga çdo të metë.

Aliu (r.a.), na tregon një kujtim të tij, në lidhje me përdorimin e emrave të Allahut “hajj dhe kajjum”, në lutje:

1. Besimi në një Zot të vetëm.

“Në ditën e luftës së Bedrit, po shihja se çfarë do të bënte i Dërguari i Allahut (a.s.). Papritur, ai u ul në sexhde dhe filloi të thoshte “Ja haju, ja Kajjum!”. Iu afrova dhe iu largova disa herë, por ai vazhdonte të thoshte të njëjtat gjëra. Ai vazhdoi t’i thoshte këto fjalë, derisa arriti fitorja.”

Në veprën Ruhu’l Bejan, na jepen shembuj se, ashtu siç kërkoi Rasulallahu (a.s.), ndihmë prej Allahut, me emrat e Tij “Ja haju, ja Kajjum!”, është e mundur që, nëse lutesh me sinqeritet të plotë, duke përdorur ndonjë emër apo cilësi të Allahut, ndihma hyjnore do të vijë patjetër.

Në lidhje me mirësitë e Ajetu’l Kursij, në hadithe të ndryshme, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Ajetu’l Kursij është ajeti më madhështor i Kuranit Kerim². Ai që lexon Ajetu’l Kursij para se të flerë, Allahu do ta ruajë dhe nuk do ta lejojë shejtanin t’i afrohet atij³. Në këtë ajet gjendet emri më madhështor i Allahut⁴ dhe Ajetu’l Kursij, është zotëria i të gjithë ajeteve të Kuranit Kerim⁵.”

Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), thotë: “Atij që e lexon Ajetu’l Kursij, Allahu i dërgon një melek, i cili shkruan veprën e tij të mirë. Shejtani e braktis për tridhjetë ditë shtëpinë ku lexohet Ajetu’l Kursij. Në atë shtëpi, për dyzet ditë nuk mund të hyjë as magjia dhe as magjistari”. Gjithashtu, Profeti (a.s.), i ka kërkuar Aliut (r.a.), që këto t’ua mësojë fëmijëve, familjes dhe komshinjeve të vet.

Në vendin tonë është bërë zakon që tesbihët, që bëhen pas namazeve farz, të fillojnë me Ajetu’l Kursij. Ky zakon është shumë i rëndësishëm për nga ana e zbatimit në bashkësi të një këshille profetike, e cila është nxjerrë nga këshillat që i ka dhënë Profeti (a.s.), Aliut (r.a.).

Gjithashtu, zakoni i leximit të Ajetu’l Kursij pas namazeve, na ndihmon që në çdo hap të jetës, të mbajmë gjallë vetëdijen që, para se t’i mbështetemi apo t’i besojmë ndonjë të vdekshmi si puna jonë, të mendojmë se ndodhemi nën vëzhgimin e Allahut Teala, ta kujtojmë Atë, t’i besojmë Atij, të presim ndihmë prej Tij, të strehohemi tek Ai dhe, sido që të jetë puna, të mundohemi të fitojmë kënaqësinë e Tij.

2. Muslim, Musafirin, 258.

3. Buhari, Vekalet, 10.

4. Musned, VI, 461.

5. Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’ân, 2.

Zbatimi me korrektësi i këtij zakoni, duke qenë të vetëdijshëm se Allahu Teala vëzhgon çdo gjendje tonën, është edhe fillimi i çdo pune të mirë, por edhe pengesë ndaj çdo veprë të keqe. Dhe për ta përvetësuar sa më mirë, kemi nevojë ta lexojmë duke menduar edhe kuptimin e tij.

DREDHITË E IBLISIT

Zoti ynë, që është Erhamu’r-Rahimin, në suren Bekare, pasi thotë: “*Mos ndiqni gjurmët e shejtanit, sepse ai është armiku juaj i hapët*”, na paralajmëron se “*Ai ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini.*”⁶

Në këtë ajet, ajo që kërkohet të thuhet me “nxitjet dhe vesveset e shejtanit”, është shtyrja e fshehtë në vepra të këqija, që i bën ai nefsit të njeriut. Gjërat për të cilat shejtani e nxit njeriun, i kemi përmbledhur në gjashtë pika:

Pikësëpari, shejtani e fton njeriun për në kufur (mohim), për në shirk (t’i bëjë shok Allahut) dhe në armiqësi ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nëse nuk arrin të ketë sukses në këto, e thërret njeriun në bid’atet më të dashura për të, prej të këqijave dhe gjynaheve. Pastaj, e thërret në gjynahet e mëdha. Por nëse nuk ka sukses edhe në këtë, e thërret në gjynahet e vogla. Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “*Po ju paralajmëroj nga moskokëçarja ndaj gjynaheve*”.

Nëse nuk arrin të ketë sukses në asnjë prej dredhivë që përmendëm më sipër, nxit në bërjen e gjërave, që janë mubah (prej të cilave nuk merr as sevap dhe as gjynah), duke të privuar prej sevapeve. Por, nëse nuk arrin të ketë sukses as në këtë dredhi, nxit në punët që kanë më pak shpërblime, me qëllim që të pengojë punët më të virtytshme.

Sipas asaj që thuhet në Ruhu’l Bejan, “Allahu Teala e ka krijuar shejtanin për t’i ndarë njerëzit e mirë nga njerëzi e këqij. Ndërsa shejtani, pasi u merr peng organet, u jep të shijojnë diçka. Pas kësaj, gjymtyrët, nuk dëgjojnë as këshillat, kur u thonë se kjo botë është e pavlefshme dhe as nuk i vënë veshin e as nuk shohin të këqijat e saj.”

Për të mos u mashtruar nga kurthet e tij tinëzare, duhet të njohim dredhitë e iblisit dhe të jemi gjithmonë të përgatitur.

6. Bekare, 169.



Besimi në Allahun

— Prof. dr. Jashar Kandemir —

Allahu Teala, i ka urdhëruar të gjithë robërit e Tij, duke u thënë:

“...S’ka Zot tjetër përveç Meje, andaj vetëm Mua më adhuron!” (Enbija, 25)

Me anë të këtij urdhri të prerë, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur se s’ka Zot tjetër përveç Tij. Dhe na thotë se ai që i beson Atij, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë.

Ai thekson se çdo krijesë në qiej dhe në tokë, me dëshirë apo pa dëshirë, i përulet Atij dhe se njeriu nuk duhet të kërkojë fe tjetër përveç Islamit.

SHKURTIMISHT

Të gjithë duhet t’i kthehen Zotit të tyre dhe të gjithë duhet të nxjerrin në pah ndjenjën e fesë, të cilën Allahu Teala e ka vendosur brenda njeriut, kur e ka krijuar. Kjo, sepse ashtu siç ka thënë edhe Profeti (a.s.), të gjithë kanë kapacitetin e duhur për të pranuar fenë e Allahut.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim thuhet:

Ata që i besojnë Allahut dhe bëjnë punë të mira, përgëzohen me mirësitë e pafundme të xhenetit. Ndërsa, ata që nuk besojnë Allahun, do të përballen me fatkeqësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

AJETI QË TREGON MË MIRË PËR ALLAHUN

Allahu Teala, në Kuranin Kerim, ka treguar për Vetën e Tij, aq sa ka dëshiruar që ne të dimë për Të. Ajeti që jep informacione më të qarta dhe më të organizuara në lidhje me besimin në një Zot të vetëm, është “ajetu’l-Kursi”. Profeti ynë (a.s.), ka

thënë se ai është ajeti më rëndësishëm i Kuranit.

Kuptimi i këtij ajeti, është si më poshtë:

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (Bekare, 255)

FORMULA E TEUHIDIT

Si do ta tregojë një rob që i ka besuar Allahut, pra që është besimtar? Sipas asaj që ka thënë Profeti ynë (a.s.), besimi ka deri në gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë degë. Në krye të këtyre, zë vend fjala, “La ilaheil-lallah”.

Ai që thotë “La ilaheil-lallah”, ka thënë se **“Allahu është një dhe i vetëm”**. Këtë shprehje e njohim ndryshe edhe si Formula e Teuhidit. Por le të dëgjojmë se çfarë ka thënë i Dërguari i Alla-

hut (a.s.), në lidhje me rëndësinë e Formulës së Teuhidit dhe se çfarë përfitojmë prej saj:

“Kush thotë La ilaheil-lallah, hyn në xhenet.”

“Kush vdes duke besuar se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, hyn në xhenet.”

“Ai që thotë fjalën e fundit të tij: “La ilaheil-lallah”, hyn në xhenet.”

“Ai që thotë “La ilaheil-lallah”, le të ketë bërë ç’ të dojë më parë, sepse një ditë kjo fjalë do ta shpëtojë.”

Profeti ynë (a.s.), kishte shumë dëshirë që xhaxhai i tij, EbuTalibi, të bëhej mysliman. Dhe këtë dëshirë ia paraqiti shumë herë. Prandaj, kur xhaxhai i tij ishte në shtratin e vdekjes, ai i tha edhe njëherë:

“Xhaxha! Thuaj La ilaheil-lallah, që në ditën e gjykimit të dëshmoj pro teje.”

Mirëpo, xhaxhai i tha:

“Nipi im! Sikur ta dija se kurejshët nuk do të më akuzonin duke thënë se “u bë mysliman nga frika”, do ta kisha plotësuar dëshirën tënde duke e thënë atë fjalë.”

Mbi këtë ngjarje zbriti edhe ajeti i më poshtëm:

“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.” (Kasas, 56.)

EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT

Kur idhujtarët e Mekës i kërkuan Profetit tonë (a.s.), t’u tregonte për Zotin në të cilin besonte, zbriti surja ihlas, e cila e prezanton Allahun shkurt dhe me cilësitë më të spikatura:

“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!’ (Ihlas, 1-4)

Në Kuranin Kerim janë përmendur **“Emrat më të bukur të Allahut”**.

Këta emra, të cilat quhen edhe *“esmau’l-husna”*, janë përmbledhur në këto tre ajete:

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!”

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbi-këqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!”

“Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Hashr, 22-24)

Profeti ynë (a.s.), na ka përgëzuar, duke thënë: *“Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Njëqind pa një. Kush i mëson përmendsh, duke ua ditur edhe kuptimin, hyn në xhenet. Allahu është tek dhe e do tekun.”* (Buhari, Muslim, Nesai, Tirmidhi, Ibën Maxhe)

AI ËSHTË KRIJUESI I ÇDO GJËJE

Sipas atyre që kemi mësuar prej shumë ajeteve, Allahu Teala është i Vetmi që mban gjithçka në dorë, që merr dhe jep, që lartëson dhe poshtëron, që vdes dhe ngjall. Këtë e tregojnë më së miri këto dy ajete:

“Thuaj (o Muhamed): ‘O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”

“Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.” (Ali Imran, 26-27)





Ndjeshmëria ndaj shpërdorimit ose etika e konsumit

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Shpërdorimi (israf) është një koncept kuranor, që ka kuptimin e të tejkaluarit të asaj çfarë konsiderohet e mesme, pra teprimi në përdorimin e diçkaje. Edhe nëse përdoret për mundësitë dhe vlerat materiale, si pasuria dhe trashëgimia, ky koncept përfshin çdo gjë që tejkalohet në përdorim. Shpërdorimi, ashtu sikurse mund të përdoret në raste konsumi ushqimor apo veshjesh, mund të përdoret edhe për kohën, shëndetin dhe ambjentin. Shkalla më e ulët e konsumit është koprracia, kurse ai që ndodhet në skajin e kundërt të koprracisë është shpërdorimi. Në këto dy ajete, kjo temë përmendet në këtë mënyrë: **“Dhe ata që, kur shpenzojnë nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes;”** (Furkan, 67) **“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”** (Isra, 29)

Sipas Islamit, edhe koprracia edhe shpërdorimi janë ndjenja epshore. Për shkak të dobësisë që ka për nefsën, njeriu shpërdoron duke bërë shpenzime të pakontrollueshme. Njeriu, po ashtu, duke u bazuar në ndjenjën e të kursyerit, bën koprracin dhe i bën rojën pasurisë së vet. Zekati, që është

një obligim hyjnor dhe fetar, në këtë rast është një spastrim; edukon ndjenjën egoiste që ka njeriu, e shpëton atë nga smira dhe koprracia. Kështu, e mëson atë të jetojë ekonomikisht, pa tejkaluar masën në përdorim. Obligimi i zekatit ka veçorinë e të ndarit të mundësive materiale që ka njeriu. Islami është një rrugë e mesme që urdhëron drejtësinë, që i kushton rëndësi ekuilibrit dhe këshillon të jemi etikë edhe kur konsumojmë. Ata që bëjnë koprracin në jetë, janë pikërisht ata që bëjnë shpërdorime të shfrenuara dhe adhurojnë nefsën e tyre, pasi koprraci, për arsye se mendon vetëm për veten e vet, nuk ndan gjë me të tjerët. Gjithashtu edhe shpërdoruesi, ngaqë mendon vetëm për dëshirat e veta, e përdor pakontroll gjithçka ka në duar. Ndaj dhe shpenzimi i tepruar që bën njeriu për veten e vet, është quajtur shpërdorim. Kurse ajo çfarë shpenzon për tjetrin nuk hyn në këtë kallëp. Shpërdorim do të thotë të shpenzosh më shumë seç duhet dhe të qenit i papërmbytur në konsum. Myslimanët përkufizohen në Kuran si një popull që ndjek rrugën e mesme. (shih. Bekare, 143) Gjithashtu, në Kuran gjenden plot ajete që ndalojnë shpërdorimin. Dy nga këto janë:

1. *"Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."* (Araf, 31)

2. *"Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruarra, hurma dhe bimë me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!"* (Enam, 141)

Në Kuran gjendet edhe një tjetër koncept që ka kuptim të përafërt me shpërdorimin, ai është *tebzir*. (Isra, 26) Tebzir është në kuptimin "të derdhësh dhe të shpërndash", "shpenzimi që bëhet në një vend të palejuar". Është një përmasë më tej shpërdorimit. Shpërdorimi përfshin shkeljen e kufijve që ka vendosur feja jonë e bukur dhe ekstremizimin e veprimeve. Ndaj dhe Allahu i Madhëruar na mëson që ne të bëjmë dua: *"O Zot! ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!"* (Ali Imran, 147)

DËMET E SHPËRDORIMIT

Shpërdorimi është një çmenduri e konsumit. Shpërdorimi ka dëme, si materiale ashtu edhe shpirtërore në planin personal dhe në atë shoqëror.

1. Dimensioi personal i dëmit të shpërdorimit

Shpërdorimi në jetën e njeriut ka dëme si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Ngaqë shpërdorimi është të konsumosh më tepër sesa prodhon ose të shpenzosh më shumë sesa ajo çfarë ka nevojë njeriu, fillimisht shkatërron buxhetin personal dhe atë familjar. Ndërsa, ata që përkufizojnë ekonominë thonë se "ekonomia është shkenca që përballon nevojat e pakufijshme përmes burimeve të kufijshme". Pra ekonomia pranon që nevojat janë të pakufijshme dhe burimet të kufijshme. Ndaj dhe burimet duhen përdorur shumë mirë, duhen kufizuar nevojat dhe konsumi duhet bërë sipas normave etike. Kjo gjë arrihet duke ndaluar shpërdorimin dhe duke ekuilibruar konsumin. Dëshirat dhe nevojat e njeriut nuk zënë të ndalen. Për të realizuar këto nuk mjafton një jetë e tërë. Kështu njeriu duhet të shpenzojë tërë jetën për nevojat e tij dhe nuk do mund të kishte kohë për nevoja shpirtërore, si, adhurim, art etj. Thonë se "Ai që nuk di çfarë kërkon, nuk e vëren atë që gjen." Njeriu i sotëm nxiton për dëshirat dhe shpenzimet e shfrenuara të tij, ngaqë ka humbur vlerat e larta dhe gjykimet e sakta. Po ashtu, i ka humbur interesi për ndjenjat e larta, si arti, letërsia, adhurimi dhe ndjesia e të shërbyerit, që i shkojnë njeriut.

Shpërdorimi ka edhe dëmet shpirtërore dhe etike, të cilat nuk janë më pak të rëndësishme sesa dëmi material dhe ekonomik i konsumit. Kjo dëshirë e drejton njeriun nga ndjenja për të pasur dhuntitë e dynjasë, që quhen *tul-i emel* (të vepruarit sikur

nuk do të vdesësh kurrë) dhe ambicie. Konsumi i shfrenuar e bën njeriun egoist. Kështu, njeriu kap dhe gëlltit gjërat e dynjasë, sikurse toka që thith ujën. Vesi kryesor i njeriut është egoizmi. Njeriu, si pasojë e dashurisë dhe e lidhjes që ka me nefsën e vet, përpiket të plotësojë dëshirat e nefsit dhe të gjejë mënyra që ta realizojë këtë gjë. Pa pasur një edukim të nefsit dhe të dëshirave, është e vështirë, madje e pamundur të frenohen këto ndjenja. Kjo qasje edukative, që synon të parandalojë shpërdorimin, mund ta pengojë sado pak njeriun të sillet si pronari i vërtetë i pasurisë, duke përfituar nga dhuntitë e botës.

Epësia e ndjenjës së altruizmit lind solidaritetin e jo shpërdorimin. Shpërdorimi i ndaluar është shpenzimi që bën njeriu për vete, mbi nevojën që ka. Nuk është shpërdorim ajo çfarë shpenzon për të tjerët. Sipas qasjes "futuvvet", që njihet si një normë etike, shpenzimi i tepruar që bën njeriu për vete, është shpërdorim, kurse shpenzimi që bën njeriu për të tjerët, sado shumë qoftë, nuk është shpërdorim. Shpërdorimi ushqen egoizmin dhe pragmatizmin. Egoizmi dhe pragmatizmi e largon njeriun nga sakrificat për tjetrin, duke menduar "jeto jetën tënde", e frenon atë të jetë bujar. Në fakt, sjellja që del në kundërshtim me këtë është qasja "një kafshatë një triko", sepse sipas këtij botëkuptimi, nuk është e rëndësishme pasuria e kësaj bote, por ndarja me të tjerët, të duash të tjerët më shumë se veten dhe të shpërndash gjithçka ke tjetër përveç një kafshate dhe një trikoje. Kjo nuk do të thotë të braktisësh punën dhe të mos jesh produktiv, por duke punuar të mos shpenzosh për vete, por për tjetrin dhe të ndihmosh vëllain që është në vështirësi, pra të bëhesh altruist. Vendi ku mund të ketë më shumë efekt dhe që mund të funksionojë më së miri botëkuptimi "një kafshatë një triko", është fusha e konsumit. Veçanërisht sot, "ekonomia e shpërdorimit" përmes publiciteteve të ndryshme ka marrë përmasa të mëdha. Gjithçka bazohet në parimin e konsumit, ndaj dhe shpërdorimi është shtuar me hapa galopantë. Duke u bazuar në mendimin "një kafshatë një triko", hyjnë nën kontroll nevojat e njeriut dhe vendin e ekonomisë së konsumit e zë ekonomia e nevojës. Kështu, njerëzit do të shpëtojnë së përdoruri në mënyrë të tepruar mundësitë që ofron teknologjia, i pasuri nuk shtyp të varfrin, i varfri do të shpëtojë së shikuari me zili pasurinë e të pasurit dhe nuk do ta vuajë tërë kohën dhimbjen e skamjes. Shpërdorim quhet kur njeriu do të realizojë çdo dëshirë që i shkon në mendje dhe mospasja kufi në këtë pikë. Kufizimi që u bën njeriu dëshirave dhe nevojave, përbën thelbin e etikës së konsumit. Një ditë, Hz. Omeri e sheh të birin, Abdullahin, tek po hante mish dhe e pyet: "Ç'ne, mish po ha?". "Po – i përgjigjet i biri, - më vajti mendja për mish, prandaj". Hz. Omeri u mërzi dhe i drejtohet të birin: "D.m.th. ti ha çfarë të shkon në mendje. A nuk e di ti se Profeti ynë ka thënë se

të hash gjithçka të shkon në mendje është shpërdorim?” (Shih. Ibn Maxhe, Et’ime, 51.) Shpërdorimi e pengon njeriun të kontrollojë nefsin. Njeriun e bën që të bëhet skllav i nefsit dhe nefsin e bën perëndi të tij. Ajeti: *“A e ke parë ti atë që ephshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?”* (Furkan, 43), pikërisht këtë dëshmon. Njeriu zakonisht nuk e vëren që po bën shpenzime të tepruara, sepse *“Kështu, shpërdoruesve iu zbukurohet ajo që punojnë.”* (Junus, 12) Tejngopja nga dhuntitë e Zotit sjell në pah nevoja dhe skamje të reja. Në syrin e një njeriu që ushqehet, vishet apo konsumon në forma të tjera, zvogëlohet vlera e dhuntive. Njeriu që nuk bën shpërdorim dhe që frenon disa dëshira të tij, është i lumtur, sepse dhuntitë kanë më vlerë në syrin e tij.

2. Dimensioi social i shpërdorimit

Shpërdorimi, ndoshta më shumë se një devijim që bën individi, është një devijim që bën shoqëria. Ai që mësohet me shpërdorimin, shkon në një gjendje që nuk mendon më për të tjerët. Në këtë mënyrë, rritet edhe ndarja klasore në shoqëri. Sjellja që bëjnë të pasurit si shpërdorues, shtyp të varfrit dhe hap disa plagë sociale tek ata, plagë të cilat mund t’i drejtojnë për në shpërdorim. Në fakt, njeriu, për sa kohë që di të ndajë me tjetrin, është i respektuar dhe i lumtur. Kushti kryesor i dashurisë është ndarja dhe sakrifica. Të ndash pasurinë me të tjerët. Ata që i ka zënë sëmundja e shpërdorimit, nuk ndajnë me të tjerët. Ndaj dhe që të mos mësohen njerëzit me shpërdorimin, Muhamedi (a.s.), u ka thënë: *“Ujin nuk duhet ta shpërdoroni, edhe sikur të merrni abdest në lumë.”* (Ibn Maxhe, Tahere, 48.) Çdo lloj shpërdorimi që bëhet sot në shtëpitë tona, është një plagë shoqërore, duke ia nisur nga uji që harxhohet kot nga rubinetet e shtëpisë sonë, deri tek ushqimi që hidhet në kosh. Thuhet se sasia vjetore e shpërdorimit që i bëjmë pasurisë dhe energjisë e ka kaluar në shifër debitin buxhetor. Lumturia e shoqërisë është e bazuar në dy shtylla të veçanta, njëra është materiale dhe tjetra shpirtërore. Fuqia ekonomike i përket asaj materiale, kurse besimi dhe etika janë shpirtërore. Shoqëritë që i ka prekur shpërdorimi, nuk mund të arrijnë fuqinë e duhur ekonomike. Kjo shoqëri nuk mund të shpëtojnë pa u bërë debitore. Huaja i bën ata skllavë edhe nga aspekti ekonomik edhe nga ai kulturor, ata mbesin të varur prej tyre. Çdo investim dhe shpenzim që bëhet në dobi të shoqërisë, është jashtë asaj çfarë quajmë shpërdorim.

Shkaqet që përgatisin shpërdorimin:

Në krye të shkaqeve që përgatisin shpërdorimin është dëshira për të konsumuar, e cila është e natyrshme (fitri) tek njeriu. Për sa kohë që kjo dëshirë nuk edukohet që të frenohet ose për sa kohë që të ketë një klimë që e mban gjallë këtë ndjenjë, njeriu gjithnjë do ta teprojë në përdorim. Një nga shkaqet që paralizojnë shpërdorimin është rrethi shoqëror,

ndikimi që bëjnë njerëzit tek njëri – tjetri. Sot kësaj i është shtuar edhe elementi “publicitet”. Mjetet reklamuese, që i drejtohen veçanërisht syrit dhe veshit, u bënë lokomotivat e ekonomisë së konsumit.

RRUGËT E SHPËRTIMIT NGA SHPËRDORIMI

Për të parandaluar shpërdorimin dhe ekuilibruar konsumin, ka disa detyra dhe përgjegjësi që bien mbi shoqërinë:

1. Në planin individual

Edukimi është rruga e parë që shpëton të mos biesh pre e shpërdorimit. Njeriu duhet edukuar fillimisht në familje, pastaj në shkollë dhe në shoqëri, lidhur me shpërdorimin. Ata duhen edukuar që të mos bëjnë shpenzime të tepruara. Të rriturit duhet të jenë shembull për të vegjëlit lidhur me kujdesin që duhet bërë ndaj materialeve të shtëpisë dhe shkollës dhe ndaj pasurisë së shtetit. Duhet ta ngulisim mirë në mendje e zemër se çdo lloj dëmi që i shkaktojmë rrethit shoqëror apo fizik, është brenda shpërdorimit. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që, aq sa ne edhe të tjerët kanë të drejtë për të jetuar. Nuk duhet harruar që për gjithçka që shpërdoret, ka njerëz që kanë nevojë për të.

2. Në planin shoqëror

Në jetën shoqërore parandaluesja kryesore është të mësosh të ndash. Duhet larguar nga ideja e shfrytëzimit të mallit të shtetit. Ne duhet të mbrojmë si të tonat vendet dhe mundësitë që përdorim në mënyrë të përbashkët. Duhet të botojmë gjëra që sensibilizojnë individin dhe shoqërinë lidhur me shëndetin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë dhe ne na duhet të zhvillojmë zakonet e të lexuarit.

3. Në planin shtetëror

Pa konsumuar nuk prodhohet, por detyrë e shtetit është t’i shpëtojë nga dhuna e publiciteteve, që vështirësojnë gjendjen ekonomike dhe shkallën sociale të njerëzve. Shteti duhet të ndërmarrë hapa parandalues për shpërdorimin e kohës, mundësive dhe duhet ta shpëtojë popullin nga ambicia e luksit dhe shpërdorimit.

E kundërta e shpërdorimit është produktiviteti. Rritja e produktivitetit në punë, në industri, në prodhimtari, pikësepari është detyrë e shtetit.

Përfundimisht, shpërdorimi është përdorimi pa ndërgjegje dhe në mënyrë të panevojshme i çdo lloj burimi dhe mundësie. Mënyra për të shpëtuar nga kjo gjë kalon përmes ndërgjegjësimit individual apo social, sensibilizimit të shtetit dhe bërjes së marrëveshjes mes shtetit dhe popullit. Nëse duam të jetojmë të lumtur në vendin tonë dhe t’u lëmë gjëra të bukura brezave që vijnë pas, atëherë le të bëjmë shpenzime më të ekuilibruara, brenda kornizës së etikës së konsumit, duhet të kërkojmë rrugë për të shpëtuar nga çdo lloj shpërdorimi.

Mëso të mendosh!

I nderuar mik, student, i ri, plak apo i vjetër, burrë apo grua, a e di se ajo që e dallon dhe lartëson njeriun duke e shquar nga qeniet dhe ekzistencat e tjera është pikërisht aftësia për të menduar!

Por a e dini që, megjithëse të gjithë njerëzit mendojnë, jo të gjithë dinë të mendojnë. Ka me mijëra doktorë shkencash, magjistra, të diplomuar, nga ata që e quajnë veten intelektualë, që kanë harxhuar dhe harxhojnë me dhjetëra mijëra orë ose të gjithë jetën e tyre, duke studiuar dhe duke menduar mbi çështje të ndërlikuara, që kanë të bëjnë me fusha nga më të ndryshmet, duke filluar që nga teoritë e mësimet e të edukimit, nga studimet e komplikuar mbi gjuhën, mbi letërsinë, mbi filozofinë, mbi dokumentet dhe metodat historike e deri në çështje që kanë të bëjnë me fusha, si matematika, mikrobiologjia, informatika e deri tek nanoteknologjia e shumë të tjera.

Dija njerëzore ka arritur sot në maja të tilla, sa që përditë kjo trashëgimi e përbashkët e qytetërimit njerëzor shtohet me ritme të jashtëzakonshme, duke e bërë të nevojshme lindjen e shkencave të reja, si edhe ndarjen e shkencave ekzistuese në degë të reja, me qëllimin për ta bërë sa më të përvetësueshëm e sa më të dobishëm për njeriun këtë thesar të vyer, që është dija dhe shkenca njerëzore.

Sot është më se e zakonshme të takosh në rrugë apo të kesh një fqinj, që e blen bukën në të njëjtin dyqan me ty dhe që është i specializuar në një degë të dijes së cilës pak vite më parë as emri nuk i dihej dhe që ne, edhe pse mund t'ia kemi dëgjuar emrin, nuk ia kemi idenë se për çfarë konkretisht shërben dhe studion. Emra të tillë shkencash e degësh të dijes si: kibernetikë, nanoteknologji, inxhinieri gjenetike, etj., na stepin dhe na bëjnë të mendojmë për domethënien e tyre, por shpesh as fjalorët gjuhësorë nuk ia dalin të përfshijnë edhe termat më të fundit të shkencës e dijes njerëzore. Pra, është e qartë se njerëzit atë aftësi të veçantë që i shquan prej qenieve dhe ekzistencave të tjera e përdorin, domethënë mendojnë. Por, a dinë të mendojnë?!

“Më jepni një pikë mbështetëse dhe me një levë mund të lëviz gjithë tokën”, thoshte gjeniu i lashtësisë, Arkimedi. Natyrisht, Arkimedi si gjeni e kishte të qartë se një levë sado e mirë dhe e fortë pa një pikë të fortë mbështetjeje nuk mund të bënte shumë. Madje, pa një pikë të tillë të fortë mbështetjeje, asnjë levë nuk është në gjendje, jo vetëm të lëvizë gjithë tokën, por madje as vetveten.

Dija apo shkenca njerëzore, kjo levë e artë në duart e njeriut, nuk mund ta lëvizë botën, pa një pikë të fortë mbështetjeje. E shumta, mund të krijojë iluzionin se po e bën një gjë të tillë, por në fakt, në vend që ta lëvizë botën dhe qytetërimin njerëzor drejt lartësive të merituar, nuk do të bëjë tjetër veçse do ta rrokullisë në një greminë, fundi i së cilës nuk dihet, por gjithsesi

është i padenjë për këtë qenie të mrekullueshme, siç është njeriu.

Thelbi i dijes qëndron në aftësinë për të dalluar atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme, do të thotë të dish vlerën dhe rendin e gjërave. Nëse një shkencëtar i diplomuar në inxhinieri gjenetike, në vend që të merrej me këtë fushë të shkencës, duke e kërkuar kënaqësinë aty ku ka studiuar aq vite, do të shpenzonte kohën e tij duke thurur barcaleta e skeçe për estradë, natyrisht që kjo do të ishte shpërdorim i asaj dhuntie të çmuar që është mendja. Edhe pse fusha e humorit, që përbën një dije më vete dhe me vlerë, do t'i dukej më kënaqësidhënëse, për të mund të thuhej se nuk di të mendojë, mbasi nuk di të shquajë atë që është e rëndësishme nga ajo që është më pak e rëndësishme.

Por gjërat e rëndësishme nuk janë medoemos më të komplikuarat. Duhet të fillojmë të mësojmë alfabetin nga gërma *a*, domethënë nga e para dhe jo nga e mesit apo e fundit. Fakti që e shohim botën përditë e më shumë përmes dritares së vogël të televizionit, nuk na bën më të mençur sesa po ta shikonim përmes fushëpamjes së gjerë e të gjallë të realitetit. Është një hap shumë pozitiv fakti që sot shumica e njerëzve dinë të lexojnë, se analfabetizmi po bëhet përditë e më tepër një kujtim i hidhur i së kaluarës, por fakti që dimë të lexojmë nuk na garanton aspak se dimë gjithashtu edhe të mendojmë. Gjakatari Beshir el Asad, edhe pse (ç')njeri i shkolluar, edhe pse e ka të qartë fundin e vet në koshin e fundërrinave të historisë, prapëseprapë nuk i dorëzohet arsyes. Me të tillë mendjembrapshtë kjo botë ka qenë e mbushur përherë plot e përplot. Përndryshe, nuk mund të shpjegohen gjithë ato luftëra, masakra e shfarosje masive, që njerëzimi ka provuar kohë mbas kohe.

Filozofi i madh i lashtësisë Sokrati, nuk i ka ditur as çerekun e emrave të shkencave të cilat ne sot i dimë, nuk ka ditur të përdorë kompjuterin, as të drejtojë makinën, as të flasë në telefon. Për më tepër, nuk ka pasur fatin të njohë mësimet e të dërguarve të Zotit dhe veçanërisht, të Dërguarit të fundit dhe më të përsosurit, Muhamedit (a.s.), por ka ditur shumë më tepër se sa pjesa më e madhe e njerëzve të sotëm, që janë të aftë të përdorin kompjuterin, t'i ngasin makinës apo të flasin në telefon. Ai ka ditur të dallojë atë që është më e rëndësishme, prandaj edhe ka thënë një frazë të thjeshtë, por gjurmëlënëse: “Njih vetveten!”

Kështu edhe në rastin e të menduarit, gjëja më e rëndësishme që njeriu duhet të dijë, është se ka vetëm një Zot, të vetëm, dhe gjithçka tjetër që ekziston është krijesë. Ai, as nuk ka lindur kënd, as nuk ka lindur prej kujt dhe nuk ka të barbarbartë me Të.

Jeta ME LUTJE

— Ali Riza Temel —



Lutja është begatia dhe bereqeti i çdo gjëje. Jeta me lutje arrin një begati nga fillimi në fund dhe shndërrohet në adhurim ndaj Zotit (xh.xh.). Faktikisht, lutja është thelbi i të gjithë adhurimeve. Është strehim te Allahu Teala dhe thirrje ndaj Tij për ndihmë. Ajo është shprehje e paaftësisë së robit të pafuqishëm, është shprehje e modestisë, e dëshirës dhe e përgjërimit të tij kundrejt Krijuesit të Lartë.

Vlera e robit është aq sa i lutet Allahut Teala. **Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj.”** (Furkan, 77.) Ndërsa i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e shpreh kështu rëndësinë e lutjes: **“Te Allahu nuk ka asgjë më të vlefshme se lutja.”** (Ahmed b. Hanbel, II, 362)

Të lutesh është një mirësi. Nga një aspekt tjetër, është pranim në audiencën hyjnore. Allahu Teala nuk e lejon robin të bëjë një dua, të cilën nuk ia pranon, ndërsa pranimin e lutjes, e di vetëm Allahu se kur dhe ku do ta bëjë. Mbi të gjitha, çdo kërkesë e robit, mund të mos jetë e mirë për të. Është një mirësi që Allahu i Madhëruar nuk i pranon kërkesat e robit, të cilat mund të jenë të këqija për të. Njeriu mund ta shikojë të keqen si të mirë dhe të mirën si të keqe. Lutja më e qëlluar është kërkimi i më të mirës në çdo gjë.

Lutja është një urë ndërmjet *ubudijetit* dhe *rububijetit*. Ajo është mosshkëputja e lidhjes me

Allahun dhe qëndrimi i lidhur gjithmonë me Të. Allahu i Madhëruar, që është më afër nesh se vetja jonë dhe se damarët e qafës, na urdhëron t’i lutemi Atij: **“Lutmuni Mua, në mënyrë që t’ju pranoj lutjen.”** (Gafir, 60)

Lutja e sinqertë është dëshmi për lënien e së keqes dhe vullnet për kryerjen e së mirës që kërkohet nga Zoti, xhelle xhelaluhu. Robi thërret Allahun e Madhëruar për ndihmë, kur nis një udhëtim apo kur fillon një punë dhe thotë:

“O Zot! Unë jam i paaftë. Nuk kam mundësi ta ndihmoj as veten time. Unë kam nevojë për mbrojtjen dhe mbështetjen Tënde.” Lutja e atij që nuk ka vullnet për të ecur dhe për të punuar, është e pavlerë. Nëse robi e nxjerr veten jashtë funksionit, ndërkohë që ka mundësi të veprojë si njeri, së pari kjo është mosrespektimi i vetes së tij. Njeriu shpëton nga përgjegjësia vetëm kur është në një pozitë që nuk mund të bëjë gjë.

Para së gjithash, njeriu duhet të përdorë të gjithë fuqinë dhe mundësitë e tij për të bërë apo për të lënë një punë, pastaj duhet t’i lutet Allahut Teala që t’i japë sukses. Njeriu nuk mund të thotë: “Çfarë nevoje ka për Allahun, pasi t’i kem bërë të gjitha?” Sepse, nëse nuk dëshiron Allahu i Lartësuar, njeriu nuk mund të marrë frymë qoftë edhe një herë. Faktikisht, njeriu nxjerr në pah vullnetin për të bërë diçka, ndërsa Allahu i Lartmadhëruar, i jep sukses në atë gjë. Në Kuran thuhet:



“Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante.” (Enfal, 17)

Gjuajtja e robit është figurative, ndërsa gjuajtja e Allahut Teala është e vërtetë. Kjo e vërtetë tregon se Allahu i Madhëruar është i pranishëm në çdo moment. Nëse njeriu i afrohet Allahut (xh. xh.), Allahu i Lartësuar bëhet dora e tij që mban, syri i tij që shikon dhe veshi i tij që dëgjon. Pastaj njeriu gjuan me Atë, shikon me Atë dhe dëgjon me Atë. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Ki frikë nga mendjemprehtësia e besimtarit, sepse ai shikon me dritën e Allahut Teala.”

Ai që shikon nga këndvështrimi, që urdhëron Allahu Teala, shikon të vërtetën. Lutja është kthim te Allahu duke kërkuar fuqi nga Ai dhe duke i kërkuar mbrojtje nga rreziqet. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Prandaj ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut.” (Edh-Dharijat, 50.) Ne gjithmonë i kërkojmë ndihmë Allahut (xh.xh.), prej djallit që është armiku ynë më i madh. *Istiadheja* është kërkim i mbrojtjes nga Allahu. Në suren Felek dhe En-Nas, tregohet qartë se nga çfarë gjërash duhet t'i kërkojmë mbrojtje Zotit.

Jeta është një aventurë që rrjedh ndërmjet shpresës dhe frikës. Esenca e lutjeve është arritja e atyre që shpresojmë dhe siguria prej asaj që frikësohemi. Adresa e lutjes është Allahu Teala. Vetëm te mëshira dhe falja e Zotit (xh.xh.), mund të mbrohemi prej ndëshkimit dhe zemërimit të

Tij. Lutja është një britmë shprese, një përqendrim i fuqisë dhe një përpjekje për mbledhjen e vetes.

Jeta e peygamberëve është e gjitha lutje. Të gjithë profetët, nga Hazreti Ademi (a.s.) e deri te Hazreti Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, fytyrat dhe zemrat e tyre i kanë drejtuar nga kënaqësia e Zotit dhe gjithmonë nga Ai (xh.sh.), kanë marrë fuqi.

Hz. Ademi, alejhis-selam dhe Hz. Havaja, iu lutën Zotit kështu:

Ata thanë: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi prej të humburve.” (A'raf, 23)

Nuhu, alejhis-selam, iu lut Zotit:

“Unë u munda, prandaj më ndihmo!” (Kamer, 10)

Ibrahimi, alejhis-selam, iu lut:

“O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!” (Ibrahim, 35)

Musai, alejhis-selam, iu lut:

“O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime, që ata të kuptojnë fjalën time!” (Ta Ha, 25-28) Ndërsa në disa ajete të tjera, Allahu Teala thotë:

(Kujtoje) **Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: “Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”** (Enbija, 83)

(Kujtoje) **Zekerijan, kur iu lut Zotit të vet: “O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je Trashëgimtari më i mirë.”** (Enbija, 89)

Ai (Luti) tha: “O Zoti im, më ndihmo kundër popullit zullumqar!” (Ankebut, 30.)

(Sulejmani tha:) **“O Zoti im, më frymëzo të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me Mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”** (En-Neml, 19.)

(Kujtoje) **Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, prandaj thirri nga errësira: “S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”** (Enbija, 87.)

Edhe Hazreti Isai, alejhis-selam, i është lutur gjithmonë Zotit dhe në lidhje me lutjen, ka thënë:

“Mos u bëni si hipokritët kur luteni, sepse atyre u pëlqen të luten nëpër sinagogë dhe në krye të vendeve, në mënyrë që t’i shikojnë njerëzit.” (Mateu, 6/5.) Kërkoni dhe do t’ju jepet. Kërkoni, se do të gjeni. Trokitni derën dhe ajo do t’ju hapet, sepse çdo kërkues, merr. Ai që kërkon, gjen dhe dera i hapet atij që troket. Cili prej jush i jep gurë birit të tij, kur ai kërkon bukë dhe gjarpër kur kërkon peshk? Edhe pse ju jeni të këqinj, dini t’u jepni fëmijëve tuaj dhurata të mira. Ndërsa Zoti që është në qiell, jep gjëra pa masë dhe shumë të bukura.” (Mateu, 7/7-11.)

Fjalën baba në Ungjill, e kam përkthyer Zot. Faktikisht kjo është e vërteta. Sepse fjalët baba dhe bir, këtu janë në kuptim metaforik dhe janë përdorur për të shprehur afritet. Gabimi më i madh i të krishterëve është ngatërimi i metaforës me të vërtetën.

Këtu është e pamundur t’i shkruajmë të gjitha lutjet e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, sepse jeta e Tij është lutje nga fillimi deri në fund. Kur shtrihej në shtrat, kur hynte në shtëpi, kur dilte nga shtëpia, kur vishte rrobat, kur hipte në kafshë, kur shkonte në treg, kur hante, kur pinte, kur hynte e dilte nga tualeti etj. Në jetën e Tij, Alejhis-selami, nuk kishte moment pa lutje.

Për pranimin e lutjes ka disa kushte. Një lutje në lidhje me faljen e mëkateve, së pari duhet të mbështetet te një ndjenjë pendimi e thellë dhe duhet nxjerrë në pah vendosmëria e vullneti për të mos e bërë edhe një herë. Së pari, ne kryejmë adhurimet dhe pastaj e parashtrijmë kërkesën tonë me modesti, në mënyrë që të kemi të drejtë për të kërkuar diçka nga Allahu i Madhëruar. Pra, së pari adhurimi, pastaj ndihma dhe udhëzimi, ashtu siç themi kur lexojmë suren Fatiha në çdo namaz:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (Fatiha, 5) Dhe Dhe kuptimi është ky: Së pari, ne duhet të kryejmë detyrën e adhurimit ndaj Allahut Teala, pastaj të kërkojmë ndihmë nga Ai. Kjo nuk është tregti. Adhurimet tona nuk janë kurrë kundërvlera e atyre që na ka dhënë Allahu. Ne, me ibadetet tona, nxjerrim në pah vetëm respektin dhe vullnetin për ta adhuruar Atë.

Fjalët dhe sjelljet, që tërheqin kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), janë shkak për pranimin e lutjeve. Në lidhje me këtë aspekt, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: **“Ai që dëshiron t’i pranohet lutja dhe t’i hiqet vështirësia, le të ndihmojë dikë që është në vështirësi!”** (Ahmed b. Hanbel, II, 23)

Goja duhet të jetë e pastër, zemra e pastër, ushqimi dhe veshmbathja duhet të jenë hallall dhe të pastra, në mënyrë që të pranohet lutja. Në audiencën e Zotit, xhelle xhelaluhu, nuk dilet duke dhunuar të drejtat e njerëzve, sepse ai që nuk ua jep hakun të tjerëve, nuk ka të drejtë të kërkojë nga Allahu i Madhëruar. Lutja duhet të bëhet me sinqeritet dhe me modesti. Allahu, xhelle xhelaluhu, thotë:

“Lutjuni Zotit tuaj përlshëm dhe ngadalë! Njemend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin.” (A’raf, 55.)

Lutja është burim fuqie. Ai që i kërkon mbrojtje Allahut Teala dhe që e thërret për ndihmë, ka trokitur derën më të mirë dhe i është drejtuar Atij që të mund ta ndihmojë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Nëse ju ndihmon Allahu, s’ka kush t’ju mposhtë e, nëse ju lë pa ndihmën e Tij, kush është ai që do t’ju ndihmojë, përveç Tij?! Pra, vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët.” (Al’ Imran, 160.)

RREZIKU

i ndryshimeve dytësore

— Muhamed Gazali —

Isha dëshmitar i një grindjeje të zjarrtë mes dy grupeve njerëzish, njëri mendonte se duhet të thuhet pa zë “Amin” pas imamit, ndërsa grupi tjetër kishte mendimin se duhet të thuhet me zë të lartë “Amin!”

Dikush kishte propozuar që të vinin tek unë për gjykimin e çështjes dhe të vendosja kufirin e kësaj grindjeje...

Thashë: “Të thuash *Amin* është dua. E rëndësishme në të është të përgjërohesh dhe të lutesh. Në qoftë se prekesh gjatë lutjes dhe e ngre zërin apo, nëse përgjërohesh dhe nuk flet, është e njëjta gjë!...”

Njëri prej dëgjuesve, ndërkohë që sytë po i nxirrinin flakë, tha: “Nuk kuptuam asgjë!”

I thashë: “Po, se të tillë jeni. Ju prisni një përgjigje që do të kënaqë shejtanin e kryeneçësisë, i cili fryhet shumë në kësi lloj debatesh të nxehta dhe ju bën armiq të urryer të njëri-tjetrit. Dhe, në qoftë se nuk ekziston mundësi tjetër veçse një përgjigje juridike, atëherë ta dini se ngritja e zërit në *Amin* është medhheb, por edhe heshtja në *Amin* është medhheb dhe që të dyja janë të transmetuara e in-shallah kanë shpërblimin e tyre.”

Të dy grupet u larguan prej meje të ngushtuar dhe ndjeva një si rehati, sepse ata ikën nga unë. Madje, kuptova varfërinë e këtyre njerëzve për një edukator me largëpamës, për t'i ngritur në një nivel më të lartë se sa kjo mendjelehtësi, e cila i ka bllokuar prej shpirtit të adhurimit dhe edukatës së namazit.

Ky ndryshim i fikhut juridik është një shembull

i dhjetëra e dhjetëra rasteve të tilla, që zënë kohën dhe kokën e njerëzve bosh, ndezin fitne, zhvlerësojnë moralin dhe këpusin çfarë Allahu ka urdhëruar të mbajnë lidhur...

Më përfytyrohet sikur këto ndryshime dytësore përngjasojnë me format e bakterieve, të cilat na tregohen nëpër librat e mjekësisë, ku poshtë tyre shënohet “mikrob”, filan sëmundje e zmadhuar 1000 herë!!.

Zmadhimi i këtyre formave për t'i njohur, është i kuptueshëm, por çfarë kuptimi ka zmadhimi i këtyre ndryshimeve në mesin e mendimeve dhe opinionëve të disa dijetarëve, deri sa ato të duken sikur janë të vërtetat e popujve të zhdukur? Rezultatet e tyre kanë qenë bela për shoqërinë tonë fetare, sepse ky hiperbolizim i fabrikuar mbuloi fusha të gjera, të cilat duhej të lëvizeshin prej moralit se asnjë popull nuk ngrihej, përveçse prej tyre. Kështu që, në vend që t'i zëmë njerëzit me formimin e virtyteve të larta, sinqeritetin, besnikërinë, mbajtjen e premtimit, turpin etj., i kemi zënë me diçka që mendojmë se ka më shumë shpërblim dhe dobi.

Ky është një iluzion i madh, sepse mungesa e moralit do të thotë përhapje e hipokrizisë, fesadit dhe humbje e popujve...

Unë kam mendimin se ndezja e fanatizmit të medhhebeve ka qenë plan dredharak për largimin e vëmendjes së opinionit prej kritikave politike dhe ndjekjes së gabimeve, të cilat e varrosën që moti, për së gjalli shtetin islam! Siç duket, plani akoma është aktiv dhe vazhdon ende të zbatohet!!

DY BAZAT E NJË SHOQ

Koha dhe historia kanë vërtetuar se një familje, një klan, popull apo shtet, që të ketë themele të forta dhe një jetë të gjatë, ka nevojë për individë të ushqyer mirë me elementin bazë të domosdoshmërisë së vetë krijimit njerëzor, atë të dijes, kufijtë e së cilës nuk mund të pranojnë kufizime ideologjike, politike, interesash apo diçkaje tjetër. Libri me prejardhje hyjnore, Kurani, i vetmi, i cili ruan origjinalitetin e tij më të lashtë dhe unik, do ta niste me fjalën “ikre” lexo (mëso)¹ mesazhin e tij drejtuar njerëzimit të zhytur në injorancën e harresës së vetë këtij mesazhi, duke u rikujtuar njerëzve se është dija ajo që i dallon nga qeniet e tjera dhe se për këtë arsye mbartin mbi vete vlerat e të menduarit dhe të të logjikuarit.

Gjithsesi, nuk mjafton vetëm me kaq, sepse kjo dije e gjerë në kufijtë e saj dhe e prirur nga presioni egoist i qenies njerëzore për të realizur atë ç’ka është negative apo e dëmshme për të tjerët, ka nevojë për një edukim të fortë moral, i cili e orienton në të mirën dhe pozitiven, e kontrollon dhe e stabilizon në mostejkalimin në negativen dhe e plotëson formimin e individit perfekt, bërthamën apo esencën e shoqërisë së ëndërruar. Me fjalë të tjera, dituria e shëndoshë, e gërshetuar me moral të lartë, është sekreti i lumturisë së individit, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.

Po të shikojmë sot, shumë vende moderne kanë arritur majat e piramidave në shkencë dhe teknologji, në sajë të një procesi të hapur dhe mjaft të lodhshëm të një farë “robotizimi” të qenies njerëzore, duke e ushqyer atë me njohuri dhe aftësi të thëna, pse jo, superdobiprurëse për shoqërinë. Ky kompleksitet, dashje apo padashje, ka marrë vrullshëm maratonën e perfeksionimit të të krijuarit “njeri” të kohës si veglën më fitimprurëse në riprodhimin e modeleve komerciale, por duke anashkaluar, neglizhuar ose harruar për fatin e keq, aspektin tjetër bazë të lumturisë dhe misionit njerëzor, aspektin moralo-etik. Jo pa të keq, sot si domosdoshmëri e kohës – mbase e vonuar - është parë trajtimi në universitete i temave “etika e prodhimit” ose “etika e konsumimit”.

Dikush zotëron njohuri të gjera në shkencën e anatomisë, biologjisë, mjekësisë, por për të provuar aftësitë e tij, është i gatshëm të eksperimentojë çdo lloj gjallese në format më ekstreme, madje edhe vetë

qenien njerëzore. Këtu mund të përmendim rastin e tentativës për të futur në barkun e femrës njeri, spermatozoide të një mashkulli majmun², duke u ofruar pacienteve një shumë të hollash – mbase thjesht për të parë nëse krijesa që do të dalë, do t’i ngjajë sadopak programuesit të saj! Dikush tjetër vazhdon të prodhojë e riprodhojë armë të shkatërrimit në masë, vetëm e vetëm për përfitime ekonomike, pa menduar se ku do të përdoren këto armë! E të tjerë sfidojnë matematikën, fizikën, astronominë, shpikin kompjutera e makineri, ndërtojnë në ujë e lundrojnë në tokë, por shprehen se e kanë prejardhjen nga majmuni, janë gnostikë, ateistë ose duke përfituar nga “ligji modern” i të drejtave të njeriut shprehen me “krenarinë” më të madhe - madje mundohen edhe ta imponojnë tek të tjerët - se janë homoseksualë, travestitë, lesbike...! Mundësi të shumta, të ofruara nga aftësitë e zhvillimit shkencor, kurrë të para më parë nga njerëzimi, por të shoqëruara me një degradim marramendës të karakterit hyjnor, të cilin e zotëron njeriu! Duket se diçka mungon. Mungon mekanizmi që e kontrollon dhe perfeksionon “makinen njeri”, morali.

Për të dhënë një shembull tjetër më praktik, mjafton t’i hedhim një shikim botës së politikës. Të gjithë ndjejnë pasojat negative të mungesës së etikës (moralit) në fushën politike. Në fakt, politika është arti i promovimit të së mirës së përbashkët e i lumturisë për të gjithë. Por duke e zhveshur vetveten nga konceptet dhe parimet e etikës, nga të qenët politikë transformohet në “politikërinë” e interesave dhe privilegjeve. Nga ana tjetër, në mungesë të etikës porta mbetet e hapur ndaj çdo lloj forme të korrupsionit.

Edhe eksperiencia mbi ekologjinë ka zbuluar se raporti i qenies njerëzore me natyrën - pra me qeniet e tjera - nuk mund të bazohet vetëm mbi përdorimin apo shfrytëzimin e kësaj të fundit, por duhet të bazohet në normat etike universale, përdërisa shfrytëzimi i natyrës të mos jetë transformuar në abuzim, duke shkatërruar kështu mundësinë e jetesës, veçanërisht për gjeneratat e ardhshme. I zhveshur nga etika, vetë aktiviteti shkencor fillon t’i krijojë frikë qenies njerëzore.

Lind pyetja: çfarë është morali – ky efekt kaq i

1. Sure: Alak 96/1

2. Rikujtojmë se e kundërta është provuar, pra është vendosur në barkun e një majmuni femër sperma e njeriut, por për fatin e mirë nuk ka dhënë rezultat.

PËRIE TË ËNDËRRUAR

fortë në formimin e karakterit njerëzor – dhe ku mund të gjendet ai? Morali është ajo vepër, e cila, para së gjithash është objektivist e mirë dhe për më tepër, duhet realizuar nga personi në fjalë në pavarësi të plotë nga avantazhet apo disavantazhet që mund t'i sjellë realizimi i kësaj vepre. Sokrati e ka shprehur shumë bukur këtë karakter të moralit, kur ka thënë se preferonte të ishte viktimë e të padrejtës, sesa ta kryente atë.

Gjithashtu, morali përcakton atë ç'ka është në meritën e të qenit njeri dhe ç'ka nuk është. Të jesh i besueshëm ndaj një miku, është meritë e të qenit njeri. Të mos jesh i besueshëm, nuk është meritë, por tradhti. Ta mbrosh jetën e një individi të pafajshëm, është meritë e njeriut – është sikur të shpëtosh të gjithë njerëzimin, thotë Kurani - dhe t'ia marrësh jetën atij nuk është meritë, por krim – dhe kondisderohet sikur të kesh vrarë të gjithë njerëzimin³.

Morali përcakton gjithashtu – sipas Kantit – ato akte të cilat kryhen për të respektuar atë ç'ka duhet bërë, pa marrë parasysh pajtueshmërinë me detyrën. Nëse një tregtar shet gjithmonë me çmim të ulët, për të mos humbur klientelën e tij, ai nuk kryen një akt moral. Por, nëse ai shet me çmim të drejtë për të respektuar detyrën (është ndërgjegjja e tij që ia kërkon), atëherë akti i tij është moral.

Kurse sipas Kurtubiut, morali është një mori cilësish të njeriut, të cilat përcaktojnë sjelljen dhe veprimtarinë e tij ndaj të tjerëve. Ato mund të jenë cilësi të mira ose të këqija. Cilësi e mirë, sipas kuptimit të përgjithshëm, është: të ndjesh obligim në vetvete për të tjerët, kurse kuptimi i shtjelluar: falja e gabimit, butësia, bujaria, durimi, mëshira, ndihmesa, dashuria e ndërsjelltë, zemërbutësia etj. Cilësitë e këqija janë e kundërta e asaj që u përmend më lart⁴.

Koncepti i vërtetë i moralit nuk duhet të jetë, as thjesht ai i krahasuar me ligjin natyror të të bërit mirë, por është diçka e thellë në shpirtin e njeriut, e mbjellë shumë kohë më parë se sa egoja e tij dhe e kultivuar me anë të një Fryme, nga e cila e ka zanafillën e gjithë ekzistenca. Për këtë arsye, mosprezenca e tij (moralit) tek njeriu krijon një destabilizim të madh human dhe kjo mungesë vjen e shprehur në fjalorin gjuhësor me fjalën “imoralitet” ose në atë

fetar me fjalën “mëkat, gjynah”.

Nga parimi i moralit fetar, njeriu jofetar nuk bën mirë, por bën vepra kalimtare momentalisht të dobishme. Sikurse edhe njeriu besimtar nuk mund të bëjë mirë – vepra e tij e mirë nuk ka asnjë vlerë - nëse nuk zotëron moral të lartë. Kjo vërtetohet edhe nga hadithi: “Nuk ka besim pa moral dhe nuk ka moral pa fe”⁵. Mendimtari dhe shkrimtari frëng Jean Jacques Rousseau pati shkruar: “Në fillim kam menduar se është e mundur të jesh i moralshëm e të mos besosh në Zotin. Tani e kam të qartë se kjo është e pamundur dhe se bindjet e mia të dikurshme ishin thjesht iluzione”.

Atëherë, përdërisa burimi kryesor i moralit është Krijuesi i gjithçkaje, edhe njeriu me moral të lartë zotëron dhuratën më të shtrenjtë të kësaj bote. Ndërsa çelësi që hap portën e moralit të lartë, nuk mund të jetë tjetër veçse afrimiteti i krijesës me Krijuesin me anë të së vetmes linjë komunikimi, atë të Islamit fe. Ibn Kajimi, duke komentuar fjalën e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit (s.a.s.): “Puna e mirë është morali i mirë, ndërsa puna e keqe është ajo që fsheh në gjoksin tënd dhe nuk dëshiron që ta dinë njerëzit”⁶, shpjegonte faktin se “feja (Islami) është e gjitha moral dhe ai që ngrihet në moral, ngrihet edhe në fe, gjithashtu.”⁷

Pra, ka ardhur koha të kuptojmë se nuk është e mirë (morale) që të krenohemi me pasuri, pushtet, bukuri, gra e fëmijë. Sa e artë është fjala e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në të cilën na tregon pozicionin ose gradën që kemi përballë njëri-tjetrit, kur thotë: “Më të mirët prej jush janë ata që kanë moral më të lartë”⁸. Dituria na ndriçon mendjen për të gjetur Zotin, për të zbuluar universin dhe atë ç'ka na rrethon, pse jo edhe vetveten, kurse morali na ndriçon zemrën për t'u dhënë kuptim këtyre të gjithave. Atëherë, le të garojmë në kërkimin e dijes dhe në perfeksionimin e moralit, si dy nga bazat kryesore për të arritur gradën e më të mirit dhe për të ndërtuar shoqërinë e ëndërruar, atë shoqëri të cilën Zoti na e urdhëron, Pejgamberi (s.a.s.), na e këshillon dhe njerëzimi në përgjithësi e dëshiron.

5. Nuk jam i sigurtë për vërtetësinë e këtij hadithi!

6. Transmeton Muslimi në Sahihun e tij në librin: “El-birru ëes-sileh”, Hadithi nr. 14, 4/1980.

7. Medarixhu- salikijn: 2/320.

8. Muttefekun alejhi.

3. Sure : Maide, 5/32

4. Fet`hul Bari, 1/456



FJALË QË VUAJNË NGA MUNGESA E PËRDORIMIT

Kështu të zehërt njoha tabunë

Gjësende s'ka ku fjala s'bun.

Stefan George

— Edison Çeraj —

A mund të vuajë fjala? Në vend të përgjigjes mund të themi se një gjë është e sigurt: njeriu vuan nga reduktimi i fjalorit, ose nga presioni i të ashtuquajturës ekonomi e shprehjes, siç njihet ndryshe në mijëvjeçarin e tretë (mosha e tretë e njerëzimit?).

Të gjendur nën këtë presion, ata që banojnë në qytet janë të shtrënguar të përdorin vetëm ato pak fjalë (një pjesë e madhe anglicizma) të cilat përshtaten me logjikën dhe nevojat e tregut, apo me mitin e progresit. Dihet fort mirë nga përvoja se sa më shumë të bësh të njëjtën gjë aq më shumë gjurmë të saj mbeten te njeriu.

Kjo është një arsye e fortë se përse duhet të lexojmë poezi, pasi aty do kujtojmë jo thjesht shumë fjalë që kemi harruar, por mbi të gjitha realitetin që shënjojnë ato fjalë. Në këtë mënyrë kemi një mundësi të mësojmë ose më saktë të vetëdijsohemi se një pjesë e jona banon në muze.

Pra, nuk është qëllimi te fjala si e tillë, por tek ai realitet që na ndërmond fjala. Nëse nuk kujtojmë, atëherë jemi të detyruar të gjallojmë si çdo gjallesë.

Në fakt, me sa duket kemi të bëjmë me një paradoks, sepse varfërimi më i madh që i ndodh një gjuhe, “zyrtarisht” personifikohet te fjalori i saj, pasi shumë e shumë fjalë, në emër të “efikasitetit” dhe “ndryshimit” lihen pa përfshirë, dhe me kalimin e kohës bëhen “të vjetra”, pastaj marrin një tis përrallor ose ekzotik, derisa vjen një brez që nuk i përdor më ngaqë nuk i thonë asgjë.

Thuhet shpesh se ka gjëra/çështje/realitete/përjetime që nuk i nxë fjala/gjuha, dhe kështu kjo shndërrohet në një shtysë të fortë që shumë vetë të flasin përmes heshtjes, muzikës apo arteve pamore, pa harruar ngërçet metafizike që shkaktohen nga pamundësia e gjuhës. E thënë kjo në rastin kur një gjuhë është në ditët e saj të mira, e pacenuar nga “nevoja” e (sh)përdorimit. Çfarë mund të themi në rastin e një gjuhe që po varfërohet nga përshtatja me rregullat e kohës?!

Ka ndjesi dhe përjetime qenësore të cilat kanë nevojë për fjalë të caktuara, për fjalët “e duhura”, gjë

që i shërben pikërisht përmbushjes qenësore. Nëse këto fjalë harrohen, kemi një jetë shpirtërore gjithnjë e më të varfër, ose gjithnjë e më skematike. “Caqet e gjuhës sime janë dhe caqet e botës sime”, na kujton Wittgenstein-i.

Siç e thamë, jo se këto fjalë janë qëllim në vetvete – ato janë vetëm ura lidhëse me atë realitet që ushqen jetën tonë shpirtërore.

Në njëfarë kuptimi fjala është çelësi që hap portën e këtij realiteti.

Kujtesë: “1984”

“Winston-i ndjente sikur i qe formuar një boshllëk, sikur i kishin hequr një pjesë truri (...). Ditën që ARKEGJUHA do të zëvendësohej një herë e mirë nga NEOGJUHA, do të merrte fund edhe e fundmja lidhje me të kaluarën.”

Ky është një pasazh nga romani *1984* i Orwell-it. Hapi i parë që hedh Vëllai i Madh për të bërë realitet parajsën në tokë ka të bëjë pikërisht me gjuhën, pasi duke kontrolluar gjuhën (fjalori) kontrollon edhe kuptimin, më pas edhe mendimin. Arkegjuha përfaqëson gjuhën që përdorej në të shkuarën, kurse Neogjuha është gjuha e parajsës, këtu dhe tani. Neogjuha synon të fshijë të shkuarën, në mënyrë që të kontrollojë të tashmen, dhe “kur të mbërrihet në fund, krimi i mendimit apo psikokrimi do të jetë krejt i pamundur, ngaqë s’do të ekzistojnë më fjalët për ta ngjizur atë”.

“Një botë pa dhimbje” – një slogan tipik i kohës sonë, një lajm i mirë. Në fakt, siç thotë dhe McLuhan-i, të gjitha reklamat janë lajme të mira.

Por, nga ana tjetër, dallimi mes të mirës dhe të keqës është gjithnjë e më i brishtë. Të flasësh për të mirën dhe të keqën tingëllon përherë e më absurde, sepse kjo u kujton njerëzve se parajsa nuk është e mundur. Ata nuk duan të zgjedhin, sepse nuk e durojnë dot peshën e lirisë. Ata duan që çdo gjë të jetë e lejuar. Ata nuk e dinë çfarë duan.

Qoftë edhe një poezi e vetme mund ta zhbëjë parajsën e Vëllait të Madh.

Dy pjesët më të këqija dhe të mira të njeriut



Një ditë i urti Llokman së bashku me një nxënës të tij doli për gjah. Gjatë kthimit një prijës i një fisi i ftoi të qëndronin për darkë në shtëpinë e tij. Llokmani pranoi të qëndronte atë natë aty. Prijësi i fisit theri një dash për Llokmanin. Llokmani i tha nxënësit: “Shko dhe sill dy pjesët më të mira të kafshës!” Nxënësi shkoi dhe u kthye me gjuhën dhe zemrën e dashit në dorë.

“Të lumtë!”, i tha Llokman Hakimi, “e gjete.”

Një ditë tjetër, kur bujtën në shtëpinë e një fisi tjetër, Llokmani i tha përsëri nxënësit t’i sillte dy pjesët më të këqija.

Nxënësi shkoi dhe solli përsëri gjuhën dhe zemrën.

“Të lumtë!”, i tha Llokman Hakimi, “përsëri e gjete.”

Në të vërtetë, pjesët më të këqija dhe të mira të njeriut janë gjuha dhe zemra.

FAKTE INTERESANTE

* Pirja e ujit ka efekt parandalues ndaj paralizës dhe krizës në zemër.

* Marsi bën pjesë tek planetët që shikohen nga toka me sy të lirë. Kur është afër tokës mund të shikohet shumë qartë. Ngjyra e tij është e kuqe.

* Milingonat kanë dy stomakë, në njërin stomak ruajnë ushqimin për vete, kurse në stomakun tjetër depozitojnë ushqimin që do të ndajnë me milingonat e tjera.

“ NJË LUTJE ”

“I kërkoj mbrojtje Allahut, me fjalët e tij të plota, nga zemërimi i Tij, nga e keqja e robërve të Tij, nga vesveset e shejtanëve dhe nga ardhja e tyre te unë!”

(Ebu Davud, Tib, 19)

“ AFORIZËM ”

“Pasuria i ngjason ujit të detit: sa më shumë të pish, aq më shumë etje ke.”

Arthur Schopenhauer

VEPRAT QË TË SHPIEN NË XHENET

— Dr. Murat Kaja —

TË MOS I BËSH SHIRK ALLAHUT

“Ai që vdes pa i bërë shirk Allahut, hyn në xhenet. Ndërsa ai që vdes duke i bërë shirk Allahut, hyn në xhehenem.” (Muslim, Iman, 151)

Transmetohet se Ata Ibn Ebi Rebah, (r.a.), ka thënë:

“Abdullah ibn Abbasi, (r.a.)ma, më tha:

-A të të tregoj një grua që është prej banorëve të xhenetit?

Unë i thashë:

-Po, ma tregoj!

-E shikon këtë grua? Ja, kjo grua erdhi një ditë te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tha:

-Unë jam e sëmurë me epilepsi dhe më hapen rrobat kur më zënë krizat. Lutjuni Allahut të më shërojë!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

-Nëse duron, do të hysh në xhenet. Por sidoqoftë, nëse ti do, unë mund t'i lutem Allahut të të japë shërim.

Pastaj gruaja i tha:

-Unë e duroj sëmundjen, por lutu që të mos më hapen rrobat kur të më zënë krizat!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri dua për të. (Buhari, Merda 6; Muslim, Birr 54.)

TË MOS NXEHESH

“Mos u nxe dhe do të hysh në xhenet!” (Buhari, Edeb, 76.)

NDERSHMËRIA

“Ndershmëria në fjalë dhe në punë, të drejton drejt hajrit dhe mirësisë. Ndërsa mirësia të shpie në xhenet. Njeriu regjistrohet si i singertë te Allahu, duke thënë gjithmonë të vërtetën. Mashtrimi të zvarrit drejt devijimit. Ndërsa devijimi të shpie në xhehenem. Kur njeriu e përvetëson mashtrimin, te Allahu shkruhet si mashtrues.” (Buhari, Edeb 69)

PESË BAZAT

“Kini frikë nga Allahu! Falni pesë kohët e namazit! Agjëroni muajin e Ramazanit! Jepni zekatin e pasurisë tuaj! Bindjuni prijësve tuaj! (Në këtë mënyrë) do të hyni në xhenetin e Zotit tuaj.” (Tirmidhi, Xhuma 80)

“Më janë treguar popujt (e mëparshëm). Kam parë një peygamber që kishte pranë një grup të vogël prej tre deri në pesë vetash. Kam parë një peygamber tjetër, pranë të cilit gjendeshin një deri në dy veta. Kam parë një peygamber, që nuk kishte pranë asnjë. Në ato momente, më doli përpara një kallaballëk i madh. Pandeja se ishte umeti im. Mua më thanë: ‘Ky është umeti i Musait. Ti shiko në horizont!’ Pashë, ishte një siluetë (shumë) e madhe. Më thanë:

‘Ja, ky është umeti yt. Ndërmjet tyre ka shtatëdh-

jetë mijë vetë, që do të hyjnë në xhenet pa llogari dhe pa u ndëshkuar. Ata janë njerëzit që nuk bëjnë magji, që nuk urdhërojnë për magji, që nuk i besojnë fatit të keq dhe që i besojnë Zotit.” (Muslim, Iman 374)

ZEMRA E BUTË

“Ka disa prej njerëzve që do të hyjnë në xhenet, zemrat e tyre janë të buta (dhe i mbështeten Allahut).” (Muslim, Xhenet, 27.)

Rebia Ibni Ka’b el-Eslemi, (r.a.), ka thënë:

“E kaloja natën bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Ujin e abdesit dhe nevojat e tjera ia plotësoja unë. Si shpërblim për këtë, një herë më tha:

-Kërko nga unë çfarë të duash!”

Unë i thashë:

-Dua të jem me Ty në xhenet.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha:

-A nuk dëshiron diçka tjetër?

Unë i thashë:

-Kjo është dëshira ime.

Pejgamberi, (a.s.), më tha:

“Atëherë më ndihmo për veten tënde duke falur shumë namaze dhe duke bërë shumë sexhde!” (Muslim, Salat, 226.)

SHKUARJA NË XHAMI

“Për atë që shkon në xhami në mëngjes apo në mbrëmje, për çdo rrugë Allahu përgatit për të një gosti në xhenet.” (Buhari, Ezan 37; Muslim, Mesaxhid 285.)

“Atë që pret një pemë mbi rrugë, e cila shqetëson myslimanët, e kam parë duke notuar në mirësitë e xhenetit.” (Muslim, Birr 129.)

“Një burrë pa një pemë mbi rrugë dhe tha: ‘Beto hem në Allahun se do ta heq nga këtu, në mënyrë që të mos shqetësojë myslimanët.’ E hoqi atë dhe për këtë arsye u fut në xhenet.” (Muslim, Birr 128.)

“Një burrë po ecte në rrugë dhe pa një degë ferre. E largoi atë nga rruga. Për këtë arsye, Allahu u kënaq nga ai dhe e faloi.” (Buhari, Ezan 32)

“Ka dyzet sevape, më i larti prej të cilëve është t’i japësh dikujt amanet një dhi me qumësht për ta mjelë. Kush bën ndonjërrën prej këtyre dyzet mirësive, duke shpresuar sevapin dhe duke u besuar premtimeve për to, Allahu e fut në xhenet.” (Buhari, Hibe 35)

TË DOBËTIT, MENDJEMËDHENJTË

“A t’ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhenetit? Janë ata njerëz që nuk u jep vlerë askush, për shkak se janë të dobët dhe se shihen si të tillë nga njerëzit, por nëse ata betohen se do të bëhet kështu,

Allahu ua plotëson atë që thonë.

A t’ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhehe-nemit? Janë ata njerëz me zemër të ngurtë, të ash-për dhe mendjemëdhenj, që ecin duke u mburrur.” (Buhari, Ejan 9)

JETIMI

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nxori gishtin tregues dhe gishtin gjatë, i hapi pak dhe tha:

“Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin, do të jemi kështu në xhenet.” (Buhari, Talak 25, Edeb 24.)

“Nëse dikush merr një jetim, që gjendet ndërmjet myslimanëve dhe e çon në shtëpinë e tij për ta ushqyer, përderisa të mos bëjë ndonjë mëkat të pafalshëm, Allahu Teala e fut atë në xhenet.” (Tirmidhi, Birr 14.)

TRI VAJZA

“Kush përkujdeset dhe rrit tre fëmijë vajza, i edukon mirë ato, i marton dhe e vazhdon mirësinë e tij ndaj tyre, ai është prej banorëve të xhenetit.” (Ebu Davud, Edeb 121)

“Gruaja që vdes, duke qenë bashkëshorti i kënaqur prej saj, është prej banoreve të xhenetit.” (Tirmidhi, Rada 10.)

“Prindërit bëhen shkak, për të hyrë në xhenet nga dera kryesore.” (Tirmidhi, Birr 3)

“Nëse një njeri shkon për të pyetur një të sëmurë për gjendjen e tij apo shkon për të vizituar dikë për hir të Allahut, një engjëll i thotë kështu:

“Lum ti! Ke bërë një udhëtim të mirë. Vetes i ke përgatitur një vend strehimi në xhenet!” (Tirmidhi, Birr 64)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur një mysliman shkon për të vizituar një vëlla të sëmurë mysliman, ai është afër një hurfe të xhenetit derisa të kthehet.”

E pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë është hurfeja e xhenetit?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Është një frut i xhenetit.” (Muslim, Birr 40-42)

VIZITA E TË SËMURIT

“Nëse një mysliman shkon në mëngjes dhe viziton një vëlla mysliman të sëmurë, shtatëdhjetë mijë engjëj i kërkojnë Zotit mëshirë për të deri në mbrëmje. Nëse e viziton në mbrëmje, shtatëdhjetë mijë engjëj kërkojnë falje për të deri në mëngjes. Dhe për atë njeri ka fruta të mbledhura në xhenet.” (Tirmidhi, Xhenaiz 2. Veçanërisht shih Ebu Davud, Xhenaiz 3; Ibn Maxhe, Xhenaiz 2.)

DASHURIA E NDËRSJELLTË

“Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im se nuk do të hyni në xhenet, përderisa të mos besoni. Ju nuk do të besoni, përderisa të mos doni njëri-tjetrin. A t’ju tregoj diçka që, nëse e bëni, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin ndërmjet jush!” (Muslim, Iman, 93-94.)

Sevbani, (r.a.), ka thënë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kush më jep fjalën se nuk do të kërkojë gjë nga njerëzit, unë i garantoj xhenetin.”

I thashë:

-Unë ta jap fjalën.

Transmetuesi thotë se Sevbani nuk kërkonte gjë prej askujt. (Ebu Davud, Zekat 27)

XHENETI

E pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhenet?

I Dërguari i Allahut, alejhis-salatu ves-selam, tha:

“Respekti ndaj Allahut dhe morali i lartë.”

XHEHENEMI

Ndërsa kur e pyetën:

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhehenem,- i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Goja dhe organi gjenital.” (Tirmidhi, Birr 62)

TRI CILËSI

“Unë i jam garant se atij që e lë debatin, edhe pse është në të drejtë, do t’i jepet një shtëpi në qoshe të xhenetit. Unë i jam garant se atij që nuk gënjen qoftë edhe me shaka, do t’i jepet një shtëpi në mes të xhenetit. Unë i jam garant se atij që është i dashur, do t’i jepet një shtëpi në vendin më të lartë të xhenetit.” (Ebu Davud, Edeb 7)

TRE GRUPE

“Banorët e xhenetit janë tre grupe:

Kryetari i shtetit, që është i drejtë dhe i sukseshëm.

Ai që është i mëshirshëm dhe zemërbutë kundrejt të afërmve dhe myslimanëve.

Ai që largohet nga fitimi haram dhe nuk kërkon gjë prej askujt, edhe pse familja e tij është e madhe.” (Muslim, Xhenet 63.)

“Nëse dikush dëshiron të shpëtojë nga xhehenemi dhe të hyjë në xhenet, duhet të vdesë duke i besuar Allahut dhe Ditës së Gjykimit. Gjërat që kërkon t’i bëhen atij, edhe ai duhet t’ua bëjë të tjerëve...” (Muslim, Imare, 46)

“O njerëz! Përhapeni selamin, ushqeni të tjerët dhe

vazhdojeni lidhjen e ndihmën me të afërmit tuaj. Falni namaz kur flenë njerëzit, në mënyrë që të hyni në xhenet me paqe.” (Tirmidhi, Kijamet 42)

SUREJA IHLAS

Një burrë tha:

-Unë e dua suren “kul huvallahu ehad”.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Dashuria ndaj saj, do të të fusë në xhenet.” (Buhari, Ezan 106)

“Nëse dikush prej jush merr abdest bukur duke e plotësuar atë dhe pastaj thotë: Esh’hedu en la ilahe illallahu vahdehu la sherike leh ve esh’hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluh, atij i hapen tetë dyert e xhenetit. Ai mund të hyjë nga cila derë të dëshirojë.” (Muslim, Taharet 17)

“Kush shkon në xhami në mëngjes e mbrëmje, për çdo rrugë Allahu i përgatit atij një gosti në xhenet.” (Buhari, Ezan 37)

“Nëse një mysliman fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate nafile për hir të Allahut përveç farzeve, Allahu Teala i bën një shtëpi në xhenet” ose “atij i bëhet një shtëpi në xhenet.” (Muslim, Musafirin 103)

PESË ÇËSHTJE

Një burrë i tha të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

-Më thuaj një punë që do të më fusë në xhenet!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Adhuroje Allahun dhe mos i bëj shirk asgjë. Fale namazin, jepe zekatin dhe kujdesu për të afërmit!” (Buhari, Zekat 1, Edeb 10)

FSHATARI ARAB

Një fshatar arab erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i tha:

-O i Dërguari i Allahut! Më trego një vepër me të cilën mund të hyj në xhenet .

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

“Adhuroje Allahun pa i bërë shirk asgjë! Fali namazet farz! Jepe zekatin që është farz dhe agjëro Ramazanin!”

Beduini i tha:

-Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është jeta ime, se këtyre që më the nuk do t’u shtoj asgjë.

Kur fshatari u largua, Pejgamberi alejhis-selam, tha:

“Kushdo që kënaqet duke parë një banor të xhenetit, le të shikojë këtë burrë!” (Buhari, Zekat 1)

“Umreja është kefareti për mëkatet që bëhen deri në umren tjetër. Ndërsa, shpërblimi i haxhët të pranuar, është vetëm xheneti.” (Buhari, Umre 1; Mus-

lim, Haxh 437.)

“Kush thotë: “Subhanallahi ve bihamdihi (Unë e lartësoj Allahun nga cilësitë që nuk i kanë hije pozitës së Tij si Zot dhe e falënderoj Atë), për të mbillet në xhenet një pemë hurme.” (Tirmidhi, Davat 60.)

Ebu Musa, (r.a.), ka thënë:

“I Dërguari i Allahut, (a.s.), më ka thënë:

-A të të tregoj për njërin nga thesaret e xhenetit?

Unë i thashë:

-Po, o i Dërguari i Allahut. Më trego!

Ai (s.a.s.), më tha:

“La havle ve la kuvete illa billah” (Nuk ka vullnet dhe as fuqi përveç se me Allahun). (Buhari, Megazi 38)

GJUHA DHE TURPI

“Kush më jep fjalën se do ta mbrojë gjuhën dhe nderin, unë i premtoj xhenetin.” (Buhari, Rikak 23)

“Kush dëshiron të largohet nga xhehenemi dhe të futet në xhenet, le ta presë vdekjen duke i besuar Allahut dhe Ahiretit. Po ashtu, le të silltë ndaj të tjerëve siç dëshiron të sillen të tjerët ndaj tij.” (Muslim, Imare 46.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha atyre që kishte pranë:

-Kush prej jush është agjërueshëm sot?

Ebu Bekri, (r.a.), tha:

-Unë jam agjërueshëm, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi, alejhis-selam, tha:

-Kush ka marrë pjesë sot në një namaz xhena-zeje?

Ebu Bekri, (r.a.), tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeti:

-Kush ka ushqyer sot ndonjë jetim?

Ebu Bekri, (r.a.), tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Krenaria e Gjithësisë, (a.s.), i pyeti:

-A ka ndonjë prej jush që ka vizituar ndonjë të sëmurë?

Përsëri Ebu Bekri, (r.a.), tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Kush i bën në të njëjtën kohë këto vepra të mira, patjetër do të hyjë në xhenet.” (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 12.)

“Besimtari nuk ngopet me asnjë mirësi derisa të

hyjë në xhenet.” (Tirmidhi, Ilm 19.)

MËSIMI I DIJES

“Kush merr rrugën për të mësuar dije, Allahu Te-ala ia lehtëson atij rrugën për në xhenet. Engjëjt për shkak se i pëlqejnë, i mbulojnë ata me krahët e tyre. Krijesat që janë në qiej dhe në tokë, madje edhe peshqit në ujë, i përgjérohen Allahut për t’i falur dijetarët. Epërsia e një dijetari kundrejt dikujt që merret vetëm me ibadet, është si epërsia e hënës katërmëdhjetëshe ndaj yjeve të tjerë. Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë flori e argjend si trashëgimi, por dije. Ja pra, ai që e trashëgon këtë dije, ka fituar një kështet shumë të madh.” (Ebu Davud, Ilm 1; Tirmidhi, Ilm 19.)

SEXHDJA

Sevbanit, (r.a.), i kishin kërkuar t’u tregonte një vepër që e shpie njeriun në xhenet dhe këtë kërkesë ia kishin shprehur tri herë. Pastaj Sevbanit, (r.a.), transmetoi këtë hadith:

“Mundohu të bësh shumë sexhde, sepse Allahu të ngre një gradë dhe të fshin një gabim si shpërblim për sexhden që ke bërë.” (Muslim, Salat 225)

ATA QË DUAN DHE QË NUK DUAN TË HYJNË NË XHENET

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Umeti im do të hyjë në xhenet, përveç atyre që nuk duan.”

Sahabët e pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Kush nuk do të hyjë në xhenet?

Pejgamberi, (a.s.), tha:

“Ata që më binden mua, do të hyjnë në xhenet, ndërsa ata që më kundërshtojnë, do të thotë se nuk e duan xhenetin.” (Buhari, I’tisam 2.)

SHEHADETI

“Kush thotë si fjalë të fundit “La ilahe illallah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), do të hyjë në xhenet.” (Ebu Davud, Xhenaiz 20)

AGJËRIMI SI KURË NDAJ KANCERIT

Është një sunet, të cilin Profeti (a.s.), nuk e ka braktisur edhe kur ka udhëtuar... Agjërimi në ditët 13, 14 dhe 15 të muajve hënorë... Në hadithe të ndryshme theksohet se agjërimi i Ramazanit dhe i tri ditëve për çdo muaj, eliminon urrejtjen, armiqësinë, vesvesin etj., që ndodhet në zemër. Gjithashtu në një hadith transmetohet se agjërimi i tri ditëve për çdo muaj, eliminon “magarran/ndytësinë e shejtanit”.¹

Të dhënat e marra nga kërkimet shkencore po i tregojnë botës urtësinë e këtij suneti të pashoq. Sipas këtyre kërkimeve, thuhet se agjërimi për tre ditë me radhë rinovon sistemin mbrojtës të trupit edhe tek personat e moshuar. Në kundërshtim me mendimet e “specialistëve të ushqyerjes”, në lidhje me rreziqet që përmban agjërimi, është vëzhguar se agjërimi shton aktivizimin e qelizave embrionale, duke u bërë shkak i rinovimit të qelizave të sistemit mbrojtës, që janë rruazat e bardha të gjakut. Në këtë mënyrë, është vërtetuar se personat që agjërojnë, kanë një sistem mbrojtës më të përgatitur ndaj infeksioneve. Në mënyrë të veçantë, thuhet se me anë të agjërit mund të pastrohen prej trupit edhe qelizat e sistemit mbrojtës, të cila janë dëmtuar si rezultat i seancave të kimioterapisë tek të sëmurët me kancer.

E njëjta gjë vlen edhe për personat me imunitet të dobët trupor. Studiuesit kanë zbuluar se në mënyrë të veçantë ciklet e agjërit kanë një cilësi rigjeneruese për sistemin mbrojtës. Trupi që agjëron, pakëson shpenzimin e panevojshëm të energjisë duke u përpjekur të eliminojë qelizat e sistemit mbrojtës. Në këtë mënyrë, qelizat e rruazave të bardha që shtohen dhe rigjenerohen me ndihmën e qelizave embrionale, luajnë një rol pozitiv në luftën e trupit kundër infeksioneve dhe kancerit. Gjithashtu, është vënë re se agjërimi për tre ditë rresht i pacientëve me kancer, i ka ruajtur ata nga ndikimet e helmimit me ilaçet e kimioterapisë. Në këtë mënyrë, ndërkohë që trupi ynë që agjëron pastrohet prej qelizave të rruazave të bardha që janë vjetërsuar ose dëmtuar, në sajë të sistemit mbrojtës që shtohet e rigjenerohet, ai përpigjet të rivendosë ekuilibrin e vet. Për këtë arsye,

kërkuesit theksojnë se “ciklet e agjërit”, janë shumë efektive në formimin e një sistemi të ri mbrojtës. Përveç kësaj, nëse koha e agjërit zgjatet më shumë, kjo e detyron trupin të shkrijë burimet e glukozit (sheqerit) dhe të yndyrës, ndërkohë që ul edhe sasinë e qelizave të rruazave të bardha të gjakut. Gjithashtu, është vënë re se pasi trupi fillon të ushqehet përsëri në iftar, rruazat e bardha rigjenerohen dhe shtohen përsëri. Në të njëjtën kohë, është zbuluar edhe se me zgjatjen e kohës së agjërit, pakësohet edhe enzima PKA, e cila mendohet të jetë përgjegjëse për aktivizimin e formimit të kancerit dhe të ketë lidhje veçanërisht me fenomenin e plakjes. Kjo, tregon se agjërimi ka një ndikim pozitiv në mbrojtjen e trupit nga kanceri dhe të ruajtjes së rinisë...

Specialisti në fushën e sëmundjeve të plakjes, Valter Longo, i cili ka shpallur rezultatet e kërkimit shkencor në lidhje me “ndikimin e agjërit në trupin e njeriut”, në Universitetin e Kalifornisë së Jugut, ka thënë: “Deri më sot, nuk ka asnjë provë që agjërimi ndikon për keq. Përkundrazi, ne kemi në dorë shumë fakte në lidhje me dobitë e tij...”

Tashmë, në botën e mjekësisë alternative, agjërimi ka filluar të bëhet i njohur në kurimin e shumë sëmundjeve të aparatit të tretjes, e veçanërisht të kancerit. Një nga profesorët dhe kërkuesit shkencorë në Universitetin e Bostonit, Thomas Seyfried, këshillon një lloj agjërimi, të cilin e quan “Dietë ketonike”. Kjo dietë e rekomanduar nga Seyfried për

1. shih. Ahmed bin Hanbel. Musned. el-Fethu'r-Rabbanî, V. 10.



kancerin, konsiston në kufizimin e konsumit të karbohidrateve, të proteinave dhe të kalorive. Kjo është një formë agjërimit që mund të praktikohet për një periudhë të shkurtër.

Dieta ketonike synon që i sëmuri të arrijë në ketozë, një gjendje metabolike ku trupi në vend të karbohidrateve djeg yndyrën si burim energjie. Duhet 3 ditë agjërimit vetëm me ujë për të arritur ketozën. Qëllimi është të agjërohet derisa tumori të zhduket. Kjo mund të ndodhë pas 4 ditëve agjërimit (në raste të rralla), por ka pasur persona që u është dashur të agjërojnë mbi 30 ditë për të shëruar tumorin. Sa më i madh tumori, aq më i gjatë duhet të jetë agjërimiti. Por ka edhe tumore, të cilët për shkak të madhësisë nuk mund të zhduken vetëm me agjërimit.

Çdo ditë gjatë agjërimit, personi humbet mesatarisht 400-500 gr peshë dhe zakonisht agjërimit mund të vazhdojë normalisht pa problem, derisa personi të ketë rezerva dhjamore në trup. Trupi ushqehet me këto rezerva dhjamore gjatë agjërimit. Nëse agjërohet për më shumë se 3 ditë këshillohet prania e mjekut pranë agjëruesit. Këshillimi me mjekun është i domosdoshëm përpara agjërimit për njerëzit që vuajnë nga sëmundje kronike.



SATELITËT ARTIFICIALE: SYRI YNË NË HAPËSIRË

Në këtë shekull, në të cilin ndodhemi të ndërthurur me hapësirën, satelitët zënë një vend të rëndësishëm për njerëzimin. Me informacionet që merren prej satelitëve, mund të përdorim mjetet e informacionit si televizionin, radion dhe telefonin, për të parë në moment transmetimet direkte që bëhen në cepin tjetër të botës, mund të shkëmbejmë zërin, figurën dhe të dhënat ndërmjet kontinenteve, mund të gjejmë rrugën me anë të sistemit të navigacionit në aeroplanë, anije dhe makina, mund të evidentojmë fenomenet meteorologjike, mund të vëzhgojmë trupat qiellorë në hapësirë dhe mund të arrijmë çdo informacion që dëshirojmë në internet. Kjo teknologji ka përparuar aq shumë, sa që sot mund të ndiqet edhe aktiviteti i një personi që prej hapësirës.



“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtroni kurrsesi jeta e kësaj bote!..” (Fatir, 5)

Njeriu ka dëshira dhe instinkte që e lidhin atë pas kësaj bote, të cilat janë të gdhendura në natyrën e tij. Këto i japin formë të gjithë jetës së tij. Për sa kohë që forca dhe shëndeti i tij janë mirë, ai vazhdon të rendë pas këtyre dëshirave dhe instinkteve. Dëshira e njeriut për të vazhduar jetën dhe specien e vet, përpjekjet për t’u mbrojtur prej dëmeve, urisë, etjes etj., janë vetëm disa prej këtyre instinkteve. Gjithashtu, dëshira për arritjen e pasurisë së kësaj bote dhe mirësive të saj, si fama, ndikimi dhe sundimi i të tjerëve, arritja e sukseseve dhe e epërsisë, fitimi i respektit dhe reputacionit, etj., janë disa prej instinkteve të tjera njerëzore.

Këto ndjenja dhe instinkte, shfaqen në mënyrë të ndryshme tek njerëzit. Për shembull, synimi më i madh i jetës së disa njerëzve është pasuria. Dikush tjetër dëshiron famën dhe reputacionin dhe të gjithë jetën e shpenzon për këtë qëllim. Dikush tjetër dëshiron post dhe pozitë të lartë, arritja e të cilave është ambicia e tij më e madhe. Ndërsa synimi i dikujt tjetër, është gruaja dhe fëmijët, përveç të cilave nuk ka ideale të tjera. Ndonjëherë tek një njeri gjenden disa prej këtyre dëshirave njëherësh. Por njeriu vetëm sa sprovohet në këtë botë me këto dëshira dhe ambicie.¹ Pra, a do t’i përdorë këto si mjete apo si qëllime për arritjen e pjekurisë së tij shpirtërore. Po ashtu, a do të mund t’i kontrollojë njeriu këto ndjenja dhe dëshira?² Apo mos ndoshta do të hyjë plotësisht nën kontrollin e këtyre dhe do të bëjë një jetë pa pyetur për hallalle dhe haramet?³ Nëse këto dëshira dhe instinkte bëhen qëllimet kryesore të njeriut, ato do të përbëjnë pengesën më të madhe të tij në aspektin e devotshmërisë ndaj Zotit të vet. Për rrjedhojë, kjo gjendje, në Kuran përkufizohet si idhujtarizim i dëshirave dhe epsheve të veta.⁴ Kjo, nënkupton rënien dhe uljen e njeriut. Por nëse njeriu i përdor këto si

mjete për të fituar kënaqësinë e Allahut, në këtë rast ai ngrihet dhe lartësohet.

Në Kuran, gjendja e popujve që u nënshtuan nga dëshirat dhe epsheet e veta, tregohen në këtë mënyrë duke iu drejtuar Profetit (a.s.): **“Lëri ata të hanë e të kënaqen dhe le t’i mashtroni shpresa; ata do ta marrin vesh!”** (Hixhr, 3; shih. Teube, 69.)

Në përgjithësi, njeriu nuk merr mësim prej popujve të shkuar. Në fakt, që prej njeriut të parë e deri më sot, në këtë tokë kanë jetuar me miliarda njerëz, të cilët janë lidhur pas kësaj bote me një lakmi dhe një tamah të pakufishme. Por më në fund të gjithë janë bluar në mullirin e kësaj bote, janë bërë dhe, e nuk i kanë shpëtuar dot zhdukjes. Tashmë, në vendet ku ata kanë jetuar fryjnë vetëm erërat, emrat e tyre janë harruar, ndërsa fama e tyre është varrosur në thellësitë e historisë. Prej tyre kanë mbetur vetëm muret e kalave që kanë përdorur për t’u mbrojtur dhe për të luftuar, ose shtyllat e pallateve ku janë jetuar në luks.

Kurani flet për popujt e shkuar, të cilët kanë ndër-tuar qytetërime. Kanë gdhendur shkëmbinjtë dhe kanë ndërtuar strehime të forta e të sigurta.⁵ Në këtë mënyrë, ata kanë menduar se e kanë siguruar jetën e tyre. Sa keq! Gjithçka ishte e kotë, sepse ata kishin ardhur prej dheut dhe më në fund u kthyen në dhe, duke mos i shpëtuar dot zhdukjes.

Prej popujve të shkuar, kishte prej atyre të cilët u zhytën në kënaqësi e argëtime të pafundme të kësaj bote. Ata mendonin se do të jetonin gjithmonë aty, pranë kopshteve, të mbjellave, vreshtave dhe pemëve frutore në buzë të lumenjve.⁶ Ja pra, a nuk është pikërisht ky mendim shkaku kryesor që e largon njeriun prej Zotit të vet?

Disa prej popujve të shkuar, nuk i kishin marrë seriozisht paralajmërimet dhe thirrjet e profetëve të tyre. Ata u thoshin profetëve se nuk mund të përzihe-

1. shih. Al-i Imran, 14; Teube, 24; Tegabun, 15.

2. shih. Naziat, 40.

3. shih. Merjem, 59.

4. shih. Khathije, 23.

5. shih. Shuara, 26.

6. shih. Shuara, 146-148.

shin në jetët e tyre dhe se ata mund të adhuronin, të hanin dhe të pinin çfarë të donin. Madje ata i thoshin profetëve se nuk mund të ndërhyjnë as në fitimet e tyre, duke ua treguar hallallin apo haramin.⁷ Po ashtu, u thoshin edhe se nuk mund të përziheshin as në jetën e tyre seksuale e të vendosnin kufij duke i ndaluar të vepronin si të donin.⁸

Kjo botë është si një sallë provimi. Për shekuj me radhë shumë njerëz kanë kaluar nga kjo sallë për të kryer provimin. Dikush fitoi, e dikush humbi. Tani është radha e turnit tonë. Bota na është lënë neve amanet, ndërsa ne i jemi lënë botës. Prej Allahut kemi ardhur dhe përsëri tek Ai do të kthehemi.

Jeta e njeriut në këtë botë kalon si një garë. Ndjehet dhe instinktet që janë vendosur në natyrën e njeriut e detyrojnë atë të marrë pjesë në këtë garë. Lidhur me këtë, Kurani përdor termat “tefahur” dhe “tekathur”, që do të thonë garë për “epërsi mbi njëritjetrin, e mburrje” dhe për “zotërim të sa më shumë pasurie dhe fëmijësh”.

Në këtë jetë, njerëzit përpiqen të arrijnë epërsi ndaj njëritjetrit dhe mburren ndaj njëritjetrit me mundësitë, pozitat dhe titujt që posedojnë. Në çfarë do niveli qofshin, çdo njeri i përjeton këto ndjenja në botën e tij të brendshme. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë garën e vërtetë duke u fokusuar vetëm në garën e kësaj bote. Dhe gara kryesore, siç thekson edhe Allahu në Kuran, bëhet për të arritur faljen e Allahut dhe xhenetet e Tij të pafundme: **“Garoni me njëritjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij...”** (Hadid, 21) **“Për këto (mirësi), le të përpiqen**

7. shih. Hud, 87.

8. shih. Hud, 79.

ata që përpiqen!” (Mutafffin, 26)

Në këtë botë, njeriu kërkon nder dhe dinjitet. Që prej fëmijërisë, ai dëshiron të pëlqehet dhe të vlerësohet, të fitojë reputacion dhe respekt. Për këtë arsye, rritja në karrierë, zotërimi i titujve të ndryshëm, ngritja në poste të larta dhe shoqërimi me liderë dhe njerëz të famshëm, janë gjërat që ai i dëshiron më shumë. Ja pra, njeriu nuk duhet të harrojë kurrë një gjë ndërkohë që po lufton për të qenë me reputacion në këtë botë. Dhe ajo është fakti se nderi dhe dinjiteti arrihet vetëm me sexhden dhe bindjen ndaj Allahut.

Po, epërsia dhe virtyti i vërtetë, arrihet vetëm duke iu dorëzuar plotësisht urdhrave hyjnorë. Lidhur me këtë, ky ajet është shumë domethënës: **“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut...”** (Fatir, 10)

Në jetën e kësaj bote, njeriu jeton gjithmonë me mendje drejt së ardhmes. Ai thur ëndrra dhe bën plane në lidhje me të ardhmen. Gjithmonë përpiqet të përgatisë diçka për të ardhmen dhe në këtë mënyrë mundohet të garantojë të ardhmen e tij, sepse një nga instinktet më themelore të njeriut është vazhdimësia e ekzistencës së vet. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë as faktin se, përtej të nesërme, ka një “të nesërme” tjetër. Dhe kjo e nesërme, është dita kur do të jepet llogari para Allahut të Madhëruar. Atëherë, përgatitja për të nesërmen e kësaj bote, nuk duhet të bëhet pengesë në përgatitjen për të nesërmen pas vdekjes. Por përkundrazi, e nesërmja e kësaj bote duhet të vlerësohet si një kapital për të nesërmen e përjetshme. Kjo është edhe e vërteta që na tregon ky ajet fisnik: **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!”** (Hashr, 18)



Enes bin Malik (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Prej njerëzve ka të tillë, të cilët janë si çelësi i të mirës dhe shul i së keqes. Por ka edhe të tillë që janë çelësi i së keqes dhe shuli i së mirës. Lum si ata, në dorën të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së mirës! Dhe mjerë për ata në të dorën e të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së keqes!” (Ibni Maxhe, Sunnet, 19)

Para nesh ka dyer të panumërta... Ka prej tyre që presin të hapen me padurim, e ka të tjera që shpresojnë të mos hapen kurrë. Para nesh ka dyer të panumërta... Secila prej tyre hap dyer të reja... Para nesh ka dyer të panumërta... Jo! Çelësat e tyre nuk janë hedhur në puset pa fund, por janë në duart tona...

- Kemi çelësa në dorë?
- Po!
- Kush e tha këtë?
- Profeti!
- Cili Profet?
- Njeriu më i mirë i gjithë njerëzimit, Profeti i fundit!
- E çfarë thotë?

- Thotë se: “Prej njerëzve ka të tillë, të cilët janë si çelësi i së mirës dhe shuli i së keqes. Por ka edhe të tillë që janë çelësi i së keqes dhe shuli i së mirës. Lum si ata, në dorën të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së mirës! Dhe mjerë për ata në të dorën e të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së keqes!” (Ibni Maxhe, Sunnet, 19.)

I tregon me dorë një nga një... Kjo është derë mirësie, kjo tjetra është komplet mirësi, ndërsa tek kjo tjetra nuk ka aspak mirësi. Na lajmëron edhe për më të mirën, edhe për më të keqen. Na njofton edhe për atë, prej së keqes së të cilës duhet të ruhemi, edhe për atë, prej së keqes së të cilës duhet të strehohemi tek Allahu. Ndonjëherë na tregon për më të mirat, e ndonjëherë për veprat. Ai e lajmëron umetin e tij që e do aq shumë edhe për të keqen që duket si e mirë, edhe për të mirën që pandehet e keqe. Me një kujdes

dhe vëmendje të madhe, pa anashkaluar asnjë detaj, pa u mërziur dhe duke treguar po aq butësi sa tregon edhe një nënë ndaj fëmijës së saj, ai na mëson edhe dyert që duhet të hapen, edhe ato që duhet të kyçen. Ai na tregon njerëzit më të mirë, të cilët marrin në dorë çelësat dhe hapin dyert e mirësive pa ngurruar aspak dhe pa pasur frikë se çfarë do të ndodhë e çdo të thonë, por vetëm duke kërkuar kënaqësinë e Allahut.

Ai i përmend si “njerëzit më të mirë”, ata që sillen më mirë me bashkëshortet e tyre¹, që japin borxh pa fyer askënd², që mësojnë Kuran dhe ua mësojnë edhe të tjerëve³, që kanë jetë të gjatë dhe vepra të mira⁴, ata që kanë moral të mirë⁵ dhe ata prej të cilëve shpresohet e mira dhe jo e keqja⁶.

Gjithashtu, ai na mëson se turpi është vetëm mirësi⁷, se njerëzit e butë posedojnë mirësi të madhe⁸, se është më mirë të heshtësh se sa të flasësh padobi⁹ dhe se prej Allahut duhet kërkuar më e mira në çdo gjë, përfshi edhe në vdekje¹⁰. Ai thotë se miku më i mirë, është ai më i dobishmi për mikun e vet dhe se fqinj më i mirë, është ai që sillet më mirë me fqinjin e vet.¹¹ Ai na njofton se cilësinë e të qenit “të mirë”,

1. shih. Ibn Maxhe, Nikah, 50.
2. shih. Ibn Maxhe, Tixhare, 62.
3. shih. Ibn Maxhe, Sunne, 16.
4. shih. Tirmidhi, Zuhd, 22.
5. shih. Buhari, Edeb, 39.
6. shih. Tirmidhi, Fiten, 76.
7. shih. Muslim, Iman, 61.
8. shih. Tirmidhi, Birr, 67.
9. shih. Muslim, Iman, 74.
10. shih. Buhari, Merda, 19.
11. shih. Tirmidhi, Birr, 28.



e fitojnë ato gra që i japin qetësi burrit të vet', ata që i fitojnë të ardhurat me djersë" dhe tregtari që e shlyen borxhin në mënyrën më të mirë¹².

Në fakt, ai, çdo njeri e orienton drejt derës së mirësisë që është më e afërt me të, duke e afruar tek ajo derë. Dhe duke ia kujtuar çelësin e mirësisë që mban në dorë, e nxit atë që ta hapë sa më parë atë derë.

- A tha Profeti se në duart tona ka çelësa?

- Po!

- Atëherë përse këto dyer janë kaq larg?

- Dyert janë pas teje, por ti je ai që largohesh prej tyre!

Dyert e panumërta të mirësisë janë para nesh, ndërsa çelësat e tyre janë në dorën tonë. Atëherë, nga vjen gjithë kjo e keqe? Nëse e shtyjme hapjen e dyerve të mirësive, nëse prej disave kemi frikë, nëse disa të tjera i nënvleftësojmë dhe nëse nuk e kuptojmë se ajo që hapim nuk është veç një derë, por një rrugë e madhe, atëherë dyert e mirësive do të jenë të dënuara të zënë merimanga. Ndërsa çdo derë e së keqes, të cilës nuk mendojmë t'i vëmë kyçin, ose kujtojmë se dikush tjetër do ta mbyllë patjetër, do të vazhdojë të njollosete botën tonë me shpejtësi dhe pa u ndjerë fare. Pra, e gjithë e keqja, për të cilën themi nga doli kjo ndërkohë që ne jetojmë të lumtur, vjen nga e keqja që ne nuk e kemi penguar, ose e mira që e kemi neglizhuar.

Mirë, por përse të mirët janë kaq neglizhentë

ndërkohë që të këqijtë përpiqen pa pushim? Përse të mirët janë kaq të dobët, ndërkohë që të këqijtë janë kaq rezistentë? Përse mirësia është si një lule e rrallë dhe delikate në këtë kopsht, ndërkohë që e keqja është si një ferrë e keqe dhe helmuese?

E keqja lind të keqen, sepse ajo është e prirë të shtohet. Ndërkohë që çdo e keqe i jep kurajë të keqes tjetër dhe kanë kaq shumë dëshirë të mbështesin njëra-tjetrën, e mira qëndron kokulur. Pra, sot po jetojmë në kohën kur e mira rri kokulur dhe zemërthyer, sepse veprimi i saj është shumë i vështirë.

Njerëzimi po dëshmon kohë të vështira, kur nuk ndahet vetë e mira, por pamja e saj. Njerëzit ndjejnë një kënaqësi të jashtëzakonshme prej shfaqjes së çdolloj të mire që bëjnë. Mirëpo, mirësia është diçka që duhet vetëm të veprohet, e jo të shfaqet. Madje, besohet se sa më shumë të flitet për mirësinë e bërë, aq më shumë i humbet vlera dhe sinqeriteti.

Qëllimi i mirë, mbulon çdo mirësi si një tyl i tejdukshëm dhe mbi çdo të mirë që nuk bëhet me qëllim të sinqertë, mbetet një njollë e zezë. Ngjyra e së mirës është e bardhë dhe për nga natyra e saj nuk mund të durojë asnjë lloj njolle. Nëse njolloset, ajo nuk ndryshon aspak prej së keqes. Më pas, e mira, e keqja dhe çdo gjë përzihet. Në vend të çdo mirësie ngrihet një e keqe. Prandaj, në kohë të tilla, njeriu duhet të pyesë veten, se a e ndjen veten mirë apo jo, sepse pa qenë mirë, pa e ndjerë veten mirë, nuk mund të bësh mirësi. Pa u bërë mirë, nuk mund të jesh çelës i së mirës dhe kyç i së keqes. Para nesh ka dyer të panumërta... Prej cilës derë të hymë në Xhenet?

12. shih. Nesai, Nikah, 14.

13. shih. Ahmed b. Hanbel, II/334.

14. shih. Ahmet b. Hanbel, II/19.



BAJRAMI I KURBANIT EDUKIMI I SAKRIFICËS



Gjatë jetës së tij, njeriu i paguan çmimet më të shtrenjta për hir të dashurisë. Kjo, sepse peshorja e dashurisë së vërtetë, është sakrifica. Dashuria që nuk ka kaluar nga sprova e sakrificës, nuk është gjë tjetër veçse një pretendim i thatë.

Ndërsa besimi është dashuria më e madhe. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!” (Ankebut, 2.)

Me të vërtetë, besimi është mirësia hyjnore më e madhe, ndërsa sprova është një kriter që mat nivelin e meritës së robit për këtë mirësi. Durimi, dorëzimi dhe mbrojtja e besimit me devotshmëri, që pritet prej besimtarit, është në varësi të çmimit që paguan ai për të arritur shpërblimet hyjnore. Pra, Allahu Teala, për t'i bërë robërit e Tij ta kuptojnë mirë madhështinë dhe vlerën e mirësisë së besimit, kërkon që ata të paguajnë një çmim për të.

Në bazë të kësaj, jeta në sytë e besimtarëve të vërtetë është një sistem sprovash ku matet niveli i dashurisë së besimit. Besimtari sprovohet vazhdimisht në çështjet se sa do të sakrifikojë e do të përpiqet në rrugë të Allahut dhe se në ç'masë do të heqë dorë nga interesat e tij të kësaj bote për hir të Allahut, nëse kjo do të kërkohej. Dhe në varësi të suksesit në këto sprova, do të bëhet i afërt i Allahut, madje në fund fare do të bëhet edhe miku i Tij.

Jeta plot ndodhi mësimdhënëse e Halilullahut, pra mikut të Allahut, Ibrahimit (a.s.), është një shembull konkret i kësaj sakrifice. Kur Allahu Teala e zgjodhi Ibrahimin (a.s.), si mik të Tijin, melekët duke kujtuar tri çështjet, të cilat e zaptojnë zemrën e njeriut dhe e pengojnë miqësinë me Allahun, thanë:

“O Zot! Ai ka një shpirt dhe një emër! Si do t'i kapërcejë ai këto pengesa të tmerrshme të dashu-



risë dhe të bëhet miku Yt?”

Allahu Teala, duke e sprovuar Ibrahimin (a.s.), në këto tri çështje, të cilat njeriu e ka të vështirë t'i kapërcejë, ua shfaqti melekëve dorëzimin e tij të palëkundshëm që ishte treguesi kryesor i miqësisë së tij dhe sakrifikimit të gjithë qenies së tij për Të.

Në fillim, e sprovoi me zjarrin e Nemrudit. Kur Ibrahim (a.s.), po hidhej në zjarr, melekët i shkuan dhe kërkuan ta ndihmonin. Mirëpo ai iu përgjigj:

“Nuk kam nevojë për ju! Kush ia dha zjarrit fuqinë e djegies? Zjarrin mund ta fikë vetëm ai që e ndez.” Më pas, kërkoi mbrojtje dhe strehim tek Allahu, duke thënë: “Sa vekil i mirë është Allahu!”. Pra, për të mbrojtur teuhidin e Allahut prej idhujtarisë, ishte gati të sakrifikonte shpirtin e tij duke u djegur. Ndërsa Allahu Teala i drejtohet zjarrit dhe e urdhëron:

“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” (Enbija, 69.) Dhe zjarri u kthye në një kopsht.

Më vonë, Allahu Teala e sprovon Ibrahimin (a.s.), me pasuri, duke i falur atij tufa të panumërta. Xhebraili (a.s.), i shkoi Ibrahimit në formën e një njeriu dhe i tha:

“Kush i kakëto tufa? Am’i shet mua?” Ndërsa ai tha:

“Këto tufa janë të Zotit tim. Përkujtoje Zotin tim dhe unë do t’i fal të gjitha.”

E gjithë pasuria e humbi vlerën e saj në sytë e Ibrahimit (a.s.), në këmbim të tri herë përkujtimi të Allahut, që bëri Xhebraili (a.s.). Me kënaqësinë që ndjeu prej përkujtimit (që bëri Xhebraili), Ibrahim (a.s.), i tha:

“Merri, qofshin të gjitha të tuat!”


Ndërsa Allahu Teala u fali begati edhe pasardhësve, edhe pasurisë së tij. Kurse vetë u bë “Ebu’l-Enbija”, pra babai i pejgamberëve. Që atëherë, çdo gjë e begatë përkujtohet si “begatia

e Halil Ibrahimit”. Ndërsa, kur besimtarët duan të luten për begatinë e njëri-tjetrit, thonë: “Allahu të dhëntë begatinë e Halil Ibrahimit!”.

Së fundi, Allahu Teala e sprovoi Ibrahimin (a.s.), me bërjen kurban të birit të tij, Ismailit (a.s.). Dhe të dy ata, babë e bir, treguan një dorëzim të plotë ndaj urdhrit hyjnor. Ndërkohë që ishin duke shkuar, njëri për të bërë kurban djalin e tij, ndërsa tjetri për t’u bërë kurban nga babai i tij, të dy së bashku e gurëzuan shejtanin e mallkuar, i cili përpiquej të prishte bindjen dhe dorëzimin e tyre ndaj Allahut.

Ibrahimi (a.s.), e shtriu djalin e tij të dashur, shpirtin e shpirtit të vet, filizin e bukur që kishte dalë prej qenies së vet dhe për të cilin kishte pritur me mall deri në vitet e pleqërisë, me qëllim për ta bërë kurban dhe të përmbushte urdhrin e Allahut. Por në momentin e fundit, Allahu Teala e përgëzoi me kalimin e sprovës dhe i dërgoi për kurban një dash prej xhennetit, duke i thënë:

“..O Ibrahim! Ti e përmbushe ëndrrën. Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!” (Saffat, 104-106.)



Në këtë mënyrë, Ibrahim (a.s.), tregoi se i bindet urdhrit të Allahut në çdo lloj sprove dhe se ishte gati të sakrifikonte shpirtin e vet dhe çdo gjë tjetër për Të. Duke i thyer fronet e përkohshme të kësaj bote në zemrën e vet, në vend të tyre ndërtoi fronin e dashurisë dhe miqësisë hyjnore. Kjo, sepse ai ishte plotësisht i vetëdijshëm se të gjitha mirësitë ishin veç një amanet hyjnor. Dhe ngurrimi në dorëzimin e amanetit të Zotit të vet, nuk mund të përputhej me dashurinë e besimit të vërtetë. Ja pra, falë këtij dorëzimi, dashurie dhe mbështetjeje tek Ai, Allahu e bëri Ibrahimin (a.s.), Halil/Mik të Vetin.

MEDITIMI RRETH KURBANIT

Adhurimi i kurbanit, që është edhe një kujtim i shenjtë i Ibrahimit (a.s.), duhet t'i thellojë zemrat në meditimin e ndjenjës së sakrificës për Allahun. Kjo, sepse dashuria për Allahun Teala, i Cili na krijoi prej asgjësë dhe na fali mirësi të panumërta, kërkon të mos kursejmë asnjë lloj sakrifice.

Nuk duhet harruar se njeriu jeton në pronën e Allahut dhe sakrifica e tij për hir të Tij, prej pasurisë që është amanet i Tij, nuk është dhuratë që i bëhet Allahut, por një dhuratë që Allahu i bën robit të Tij. Kjo, sepse Allahu nuk ka nevojë për asgjë, kurse robërit kanë nevojë të pafundme për kënaqësinë dhe dashurinë e Tij.

Përveç kësaj, niveli i dashurisë sonë për Allahun varet nga vështirësitë, të cilat i përballojmë për hir të Tij dhe sakrificat që i bëjmë me dëshirë të plotë. Prandaj, Bajrami i Kurbanit, që është edhe koha, kur bëhet edukimi i sakrificës dhe mëshirës, është një fllad mëshire, i cili valëvit në detin e shpirtit tonë trashëgiminnë e shenjtë të Ibrahimit (a.s.) dhe ndjenjën e dorëzimit absolut ndaj Allahut Teala. Ky fllad duhet t'i çojë të gjithë besimtarët në një vetëllogari të thellë shpirtërore.

Duhet ta mendojmë mirë faktin se Ibrahim (a.s.), u përgatit për të sakrifikuar dashurinë që kishte për djalin e tij; dhe nga ana tjetër, Ismaili (a.s.), e ofroi shpirtin e vet pa ngurruar aspak. Padyshim se urdhri hyjnor që na është dhënë me këtë ndodhi, është që të përpiqemi të qëndrojmë brenda kuadrit të këtij ajeti fisnik: **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit...”** (Teube, 111.)

Të paguash çmimin që kërkon Allahu duke sakrifikuar në rrugën e Tij me dëshirë të plotë, me qëllim që të fitosh kënaqësinë hyjnore, bëhet shkak i arritjes së pjekurisë së besimit dhe miqësisë së Allahut. Ndërsa miqësia e vërtetë, nuk përzihet me pasurinë apo mallin. Për këtë arsye, robi nuk duhet ta harrojë kurrë se e gjithë ajo që zotëron, i takon Allahut Teala dhe se atij i

është dhënë për një kohë të shkurtër përgjegjësia e përdorimit; pra, se ai luan vetëm rolin e një ruajtësi të amanetit.

ATJE ARRIN VETËM PËRKUSHTIMI/DEVOTSHMËRIA JUJ...

Kuptimi leksikor i fjalës “Kurban” është “takarrub”, pra afrim. Për të arritur afrimin me Allahun dhe për t'u pranuar në atmosferën e miqësisë së Tij, Ai gjithmonë kërkon një kurban prej nesh, robërve të Tij. Pra, Ai dëshiron që ne të sakrifikojmë pasurinë, jetën dhe çdo mundësi që kemi.

Kjo është edhe arsyeja që qëllimi i kurbanit material, është shfaqja e dëshirës së afrimit me Allahun duke iu bindur urdhrin hyjnor. Kurhani, i cili pritet me këtë qëllim, fiton një vlerë të veçantë pranë Allahut. Faktin se ky duhet të jetë qëllimi i pastër i besimtarit për kurbanin, e shpreh qartë ky ajet fisnik:

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...” (Haxhxxh, 37.)

Prandaj, thelbi i adhurimit të kurbanit, është dorëzimi dhe bindja me gjithë shpirt dhe pa kushte ndaj Allahut Teala. Gjithashtu, ajo që do të ngrihet pranë Allahut dhe do të pranohet prej kurbanit, është pjekuria shpirtërore e robit.

Për shkak se prerja e kurbanit shpreh dashurinë që ndodhet në zemër për Allahun, është shumë e rëndësishme që ky adhurim të kryhet me respekt, delikatesë dhe edukatë. Për këtë arsye, më parë duhet që brenda mundësive, kurbanët t'i zgjedhim prej kafshëve të hijshme, të shëndetshme dhe të bëshme, sepse Allahu Teala ka urdhëruar:

“Nuk kenë për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Al ‘Imran, 92.)

Me këtë, Allahu Teala na e bën të ditur se sakrificat që do të bëjmë në rrugën e Tij, mundësisht të jenë prej gjërave të bukura e të mira që i duam dhe i pëlqejmë. Kjo, sepse sadakatë, dhurimet dhe



kurbanët që bëhen larg dyfaqësisë, shkojnë në dorën e plotfuqishme të Allahut, ende pa kaluar në dorën e nevojtarit që ia japim. Allahu Teala, në një ajet fisnik, shprehet: **“...Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet...”** (Teube, 104) Prandaj kërkohet që dhurimet të bëhen me edukatë dhe ndjenja të larta, sikur je duke ia dhënë të Përhershmit e jo të përkohshmëve.

Një ditë, nëna jonë Aishja (r.anha.), dëshiroi të jepte si sadaka një sasi mishi, të cilit i kishte ndryshuar pak era. Ndërsa Rasulallahu (a.s.), e qortoi duke i thënë:

“O Aishe! A do të falësh diçka që nuk e ha as vetë?!” (Hejthemi, III, 113)

Në lidhje me këtë çështje, shprehet qartë edhe ky ajet fisnik:

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.” (Bekare, 267.)

Edhe kjo ngjarje, që ka ndodhur midis dy djemve të Ademit (a.s.), Habilit dhe Kabilit, është shumë domethënëse në këtë çështje:

Kabili donte të martohej me motrën e tij të të njëjtit bark. Ndërsa Habili e paralajmëroi se kjo nuk ishte e lejueshme (nuk ishte hallall) dhe se duhej të martohej me një prej motrave të barkut tjetër. Mirëpo Kabili nuk e mori parasysh këtë paralajmërim dhe këmbënguli në pretendimin e vet se ky që po bënte ishte një veprim i drejtë. Për këtë arsye, me qëllim që të bëhej e qartë se kush kishte të drejtë, Habili propozoi t’i kushtonin Allahut një kurban.

Në atë kohë, kurban bëhej prej mallit që gjendej në varësi të zanatit që kishin. Gjërat që kush-toheshin si kurban, vendoseshin në majë të një mali. Kur shkohej pas një kohe të caktuar për t’u kontrolluar, shihej se kurban që ishte pranuar prej Allahut Teala ishte zhdukur nga vendi, në sajë të një zjarri që binte nga qielli dhe e shkru-mbonte.

Habili kishte një tufë me dhen dhe për kurban zgjodhi dashin më të pashëm dhe më të majmë. Ndërsa Kabili, i cili merrej me bujqësi, zgjodhi si kurban një tufë me kallëza të dobëta gruri.

Pas një kohe të caktuar, Habili me Kabilin shkuan të kontrollonin kurbanët që kishin lënë. Dashi që kishte bërë kurban Habili, ishte pranuar, ndërsa kallëzat e dobëta të grurit, që kishte bërë kurban Kabili, ishin aty ku i kishte lënë. (Ibn Sa’d, I, 36.)

Ajo që do të ngrihet dhe do të pranohet tek Allahu, është devotshmëria e robit. Ai që nuk bën një jetë të devotshme, ka probleme serioze në itikad/besim, ahlak/moral dhe muamelat/vepra. Kështu që edhe adhurimet dhe punët

e tij nuk janë në rregull, sepse me vizore të shtrembër nuk bëhet vijë e drejtë.

Prandaj, është kusht që jeta të bëhet në përputhje me urdhrat hyjnorë dhe devotshmëri të lartë. Ndërsa ajo që kërkon devotshmëria, është që adhurimet dhe veprat e mira të bëhen me “sinqeritet”, pra me vetëdijen, se ndodhesh gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Një besimtar që bën njetin për kurban, më parë duhet të ketë ndjenja të sinqerta dhe duhet të ruhet shumë mirë nga futja e gjërave të përkohshme në njetin e vet. Kurban nuk duhet të pritë për shkaqe të kota, si turpi nga të afërmit apo komshinjtë apo rënia e autoritetit në shoqëri etj. Qëllimi i vetëm duhet të jetë kënaqësia e Allahut Teala. Pra, nuk duhet të harrojmë për asnjë moment se ajo që do ta bëjë kurbanin të pranueshëm, është njetin i pastër.

Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

“Puna më e dashur për Allahun, që bën biri i Ademit në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit, është derdhja e gjakut (prerja e kurbanit). Në Ditën e Kiametit, ky kurban do të vijë me brirët, thundrat dhe qimet e veta. Ndërsa gjaku i kurbanit, arrin kënaqësinë e Allahut dhe pranohet pa rënë ende në tokë. Pra, pritni kurbanët tuaj me zemër të kënaqur!” (Ibn Maxhe, Edahi, 3; Tirmidhi, Edahi, 1/1493.)

Kjo do të thotë se kurbanët duhet t’i presim pa ndërje edhe shqetësimin më të vogël në zemër,

*“Adhurimet
e çojnë njeriun
në xhenet. Ndërsa
edukata dhe madhështia
që tregohet gjatë adhurimeve,
e çojnë atë tek Allahu dhe e
bëjnë mik me Të.”*



madje me dashuri për Allahun, me shijen e besimit dhe me ndërgjegje të pastër për sakrificën që po bën për hir të Allahut.

Parë nga një këndvështrim tjetër, kurbanit është një nga simbolet e jetës fetare. Rëndësia dhe vlera e madhe që i jepet kurbanit nga myslimanët, është prej besimit, sepse në një ajet fisnik është urdhëruar: **“...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”** (Haxh, 32)

Nënvlerësimi apo moskryerja e adhurimit të kurbanit nga ana e disa njerëzve të pakujdesshëm, me fjalët më të lehta, mund të quhet “inJORANCË”; ndërsa emërtimi i këtij adhurimi me emra të shëmtuar, si “bajram i përgjakur”, janë fjalë shumë të rrezikshme, që mund të të çojnë edhe në kufër/mohim. Çdo besimtar i pasur e ka për detyrë të presë kurban, sepse paralajmërimi i Rasullullahut (a.s.), në lidhje me këtë çështje, është shumë i rreptë:

“Kush nuk pret kurban, megjithëse i ka të gjitha mundësitë ekonomike, të mos afrohet në namazganë tonë!” (Ibën Maxhe, Edahi, 2.)

Nga kjo, kuptojmë se një njeri koprrac, i cili nuk pret kurban për hir të Allahut, megjithëse Ai i ka falur mirësi të panumërtë, nuk ka vend në shoqërinë islame. Prerja e kurbanit, është vaxhib/detyrë e çdo myslimani të pasur, që i plotëson kushtet. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

“O Njerëz! Çdo vit, çdo shtëpi e ka vaxhib të presë kurban.” (Ibën Maxhe, Edahi, 2; Tirmidhi, Edahi, 18/1518.)

RREGULLAT MORALE TË KURBANIT

Pikësëpari, asnjëherë nuk duhet harruar se kurbanit është një adhurim që bëhet për hir të Allahut. Për këtë arsye, entuziazmi shpirtëror i adhurimit në këto ditë të shenjta duhet ruajtur me përmendje dhe falënderime të Allahut. Përveç kësaj, ata që munden dhe dinë, duhet ta presin vetë kurbanin, duke u përpjekur ta ndiejnë nga afër shpirtin dhe kuptimin e kurbanit. Pejgamberi

ynë (a.s.), në haxhin e lamtumirës, preu me dorën e vet 63 prej 100 kurbanëve. Ata që nuk mund ta presin vetë, duhet t’ua besojnë këtë detyrë atyre që munden dhe mundësisht, në kohën e prerjes të qëndrojnë pranë kurbanit me ndjenja respekti dhe dashurie.

Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

“O Fatime! Çohu dhe qëndro pranë kurbanit! Dije mirë, se me pikën e parë të gjakut që bie në tokë, falen të gjitha gjynahet (e vogla), që ke bërë.” (Hakim, IV, 247/7524; Hejsemi, IV, 17; Bejhaki, Shuab, V, 483.)

Nga ana tjetër, duhet që edhe me kafshët e kurbanit të sillemi mirë, të mos i trembim, t’i ushqejmë dhe t’i çojmë në vendin e flimit pa i torturuar. Kurbanin duhet

ta therim me thikë të mprehtë, me qëllim që të mos e torturojmë.

Pejgamberi ynë (a.s.), ka porositur që thikat t’i mprehim mirë dhe larg syve të kurbanit. Gjithashtu, ai (s.a.s.), na ka dhënë edhe këto porosi:

“Kur dikush prej jush dëshiron të therë kurban, le ta bëjë shpejt!” (Ibën Maxhe, Zebahih, 3.)

“Allahu ka urdhëruar që çdo gjë të bëhet në mënyrën më të mirë... Kur të therni (kurban), bëjeni në mënyrën më të mirë! Çdo njëri prej jush le ta mprehë mirë thikën dhe ta qetësojë kurbanin!” (Muslim, Sajd, 57; Tirmidhi, Dijat, 14/1409.)

DHURIM, MËSHIRË DHE ALTRUIZËM

Për shkak se kurbanit nënkupton sakrificën prej pasurisë dhe jetës, ai është një motivim i rëndësishëm i dhurimit dhe mëshirës. Ndërsa fitimi i vërtetë, që i takon robit në kurban, është pjesa të cilën ua dhuron nevojtarëve. Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë të vërtetë:

Familja e Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), kishte prerë një dele. Pasi dhuruan një pjesë të mirë, Pejgamberi (a.s.), pyeti, se çfarë kishte ngelur prej deles. Aisheja (r.anha.), u përgjigj:

“Ka ngelur vetëm shpatulla.”

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha:



“Pse nuk thua o Aishe, se përveç shpatullës gjithçka na ka ngelur neve!” (Tirmidhi, Kijame, 33.)

Është e pëlqyeshme që mishi i kurbanit të ndahet në tri pjesë. Një e treta t’u jepet të varfërve, një e treta familjes dhe një e treta komshinjve, miqve dhe udhëtarëve. Mirëpo, ata që kanë familje shumanëtarëshe dhe janë nevojtarë, mund ta mbajnë komplet kurbanin për familjen e vet. Megjithatë, edhe në këtë rast, është e pëlqyeshme të ndahet sadaka për disa të varfër.

Nga ana tjetër, besimtarët që kanë mundësi dhe kohë, kurbanët që i kanë vaxhib, duhet t’i presin në vendin (qytetin/fshatin) e vet. Përveç kësaj, brenda mundësive, duhet të bëhen përpjekje që për të larguar fatkeqësitë, belatë dhe sëmundjet, për të shprehur falënderimin ndaj mirësive të Allahut dhe për t’u zgjatur dorën e ndihmës vëllezërve të fesë, të priten kurbane dhe të shpërndahen si sadaka tek nevojtarët në të katër anët e botës. Duke filluar që nga Afrika, sot në shumë vende ku mbizotëron uria dhe mjerimi, shumë myslimanë po presin me mall shfaqjen e vëllazërisë islame, madje një pjesë e këtyre vëllezërve tanë, edhe pse një herë në vit, arrijnë të shijojnë mishin në sajë të bajramit të kurbanit.

Një miku ynë që erdhi për vizitë në Stamboll, na tha:

“Më besoni, ka shumë njerëz që ju presin të vini në këtë bajram.” Me këto fjalë, ai solli tek ne thirrjen e vëllezërve tanë në ato vende të vuajtura dhe na kujtoi përsëri përgjegjësinë e vëllazërisë fetare.

Muslimani zotëron një botë shpirtërore plot mëshirë dhe duke edukuar shpirtin e tij, shpërndan paqe tek të gjitha krijesat. Ai është një njeri altruist, i cili i konsideron si përgjegjësi të vetën, të gjithë vëllezërit e tij të fesë në çdo vend të botës. Treguesi më i mirë i kësaj gjendjeje në këto ditë të bekuara, është që në sajë të kurbanit, të bëhemi shkak që çdo motër e vëlla i ynë i fesë, të përjetojë gëzimin e bajramit në çdo vend të botës ku arrin zemra jonë.

Për të fituar kënaqësinë hyjnore në këto ditë të bekuara, duhet të përpiqemi të fusim në botën tonë shpirtërore jetimët, të vetmuarit, të varfrit, nevojtarët dhe veçanërisht, miliona prej vëllezërve e motrave tona të fesë, të cilët po vuajnë padrejtësinë dhe pashpirtshmërinë njerëzore të shekullit tonë. Kjo është detyra jonë vëllazërore, të cilën duhet ta kryejmë qoftë edhe duke dhuruar një pjesë të vogël prej mishit të kurbanit.

Të mos harrojmë se Pejgamberi ynë (a.s.), i cili

ndjente mëshirë për umetin e tij më shumë se një nënë për fëmijën e saj, bënte kurban edhe për vete, edhe për të dobëtit prej umetit të vet. (Ebu Daud, Edahi, 3-4/2792; Ibn Sa’d, I, 249.)

Të mendojmë pak se me çfarë ndjenjash të larta vetëmohimi do ta kishin kryer adhurimin e kurbanit sahabët fisnikë, të cilët u edukuan nga dora e Pejgamberit (a.s.), po të jetonin në kohën tonë. Pra, si umeti i Muhamedit (a.s.), që jemi, duhet të përpiqemi, që brenda mundësive, të tregojmë edhe ne butësinë, mëshirën dhe bujarinë që Pejgamberi ynë (a.s.), e tregoi ndaj atyre, të cilët nuk mund të bënin kurban. Kjo përpjekje do të jetë shprehja më e bukur e falënderimit tonë ndaj Allahut Teala, i Cili na bëri prej umetit të një pejgamberi kaq të mëshirshëm.

Allahu Teala mos na ndaftë prej gjurmëve të Pejgamberit tonë (a.s.), në këtë botë dhe prej hijes së lumturisë së tij në botën tjetër. Bajrami më i madh për ne, do të jetë kur të mblidhemi nën flamurin e Hamdit/falënderimit të Pejgamberit (a.s.) dhe të meritojmë shefaatin/ndërmjetësimin e tij.

Të mos harrojmë se kjo botë është vendi i sakrificës. Dhe si shpërblim për këtë sakrificë, Allahu Teala na fton ne robërit e Vet, në Daru’s-Selam, pra në vendin e lumturisë dhe shpëtimit, në xhenetin e Tij. Për ta merituar këtë ftesë për në xhenet, Allahu kërkon që ne të jetojmë duke u përpjekur t’i kthejmë bajramet e përkohshme në kapitalin e bajrameve të përhjetshme. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar:

“Në Ditën e Kiametit, për buajt shumëngjyrësh, pra për mohuesit me qëllime të këqija dhe dyfytirëshit, do të ketë një bajram kurbanit të tmerrshëm. Atë ditë, për buajt (të shkujdesurit larg Allahut), do të ketë vdekje, ndërsa për besimtarët është ditë bajrami!”

Allahu na e bëftë të mundur t’i presim kurbanët duke marrë shembull sakrificën, dorëzimin, kënaqësinë, devotshmërinë dhe dashurinë në zemrën e Ibrahimit (a.s.). Gjithashtu, na bëftë prej atyre që përhapin paqen dhe qetësinë e bajramit në zemrat e të vuajturve, nevojtarëve dhe vëllezërve e motrave tona të fesë, duke u dhuruar prej të mirave që na ka falur Allahu Teala. Allahu na i gëzoftë fytyrat tona dhe të gjithë botës islame me lumturinë dhe gëzimin e bajrameve të vërteta...

Amin!..



O drita e Syrit tim!

— Neslihan Nur Turk —

Nëse thua se po kërkon një thesar, nuk mjaftojnë vetëm përpjekjet, në qoftë se nuk ke filluar gërmimin.

Do të qash edhe më shumë, kështu që mos i fshij lotët, o drita e syrit tim dhe përpiqu.

Tani nuk është koha për t'iu dedikuar dhimbjes, por shërimit. Por shikimi gjithnjë të ka ngelur pas. Ndërkohë që duhet të kthehesh përpara dhe të ecësh me shpresë, mos u jep rëndësi vuajtjeve që të përgojnë nga pas! Kurrë mos prano të lidhesh pas këmbëve të tyre si pranga, sepse ky shans i vetëm që quhet jetë po kalon, o drita e syrit tim.

Një vend mund të mos jetë i pastër aq sa e pandeh, ndërsa një vend tjetër mund të mos jetë aq i papastër sa pandeh. Në vend që të mashtrohesh duke u dhënë pas pamjes së jashtme, mundohu të përfitosh duke menduar mirë, sepse ai që mendon mirë, përfiton nga e pastra dhe nga e papastra. Ti shiko mirë ashtu siç të ka hije, në mënyrë që të shohësh mirësi.

S'ka gjë. Le të supozojmë, se vëllai të ka dëmtuar në diçka. Le të supozojmë se ka rënë në një gjendje që s'ka mundësi të kujdeset për ty. Madje, le të jetë i pafytyrë etj., etj... Ti përsëri duaje atë. Lutu sinqerisht për të. Nëse nuk e di se si do t'ia dalësh mbanë kësaj, po të tregoj një rrugë: Mendo sikur

është ndezur një zjarr i madh për vëllain që s'e fal dot. Aty do të digjet e përvëlohet, madje, përpara të gjithëve. Britmat e tij do arrijnë deri në kupë të qiellit. A mund të durosh? A mund ta falësh përballë kësaj panorame çfarëdo që të të ketë bërë? Nëse ti nuk e fal, zjarri do të rritet edhe më shumë, do të kthehet në xhehenem dhe ai do të përvëlohet. A ta pranon zemra këtë? Nëse thua: "E kam falur. Të mos digjet", Allahu të faltë ty, vëllain tënd dhe të gjithë ne. Por, nëse thua: "Pranoj. Ç'më duhet mua. Le të digjet", Allahu të faltë o drita e syrit tim!

Ajo që kërkohet është shija e kafes dhe sinqeriteti i atij që e bën. Atëherë, shijoj dhe mos e nënçmo, duke i thënë se qenka bërë pa shkurmë. Nëse vepëron kështu, mund të arrish një shërim që nuk e ke shpresuar. Të vërtetën fetare mund ta kuptosh vetëm duke e shijuar. Kur ta kuptosh, do të qash. Kur të qash, do të pastrohesh, o drita e syrit tim.

Sikur ta dije anën e brendshme të disave që shkon pas tyre dhe i respekton, nuk do të kaloje qoftë edhe nga afër tyre. Sikur ta dije të vërtetën e shumë prej atyre që nuk i pëlqen dhe e rrudh fytyrën, do të dëshiroje të ishe rob natë e ditë në derën e tyre. Allahu Teala fsheh shumë thesare nëpër rrënoja, në mënyrë që të mos i gjejnë të padurueshmit dhe të verbrit. Por ka edhe rrënoja që i pandehim thesare. Allahu na ruajtë të gjithëve nga shkatërrimi i këtyre mbi kokat tona. Përfundimisht, të gjesh nuk është e lehtë. Nëse thua se po kërkon thesar, nuk mjaftojnë vetëm përpjekjet, po nuk gërmove. Do të qash edhe më shumë, kështu që mos i fshij lotët, i

dashur dhe përpigu.

Të ndodhin shumë probleme për shkak të gabimeve që ke bërë dhe belave që ke kërkuar, por ti përsëri pyet: “Çfarë bëra unë?” Mbi të gjitha, kërkon fajtorë të tjerë. Në vend që të veprosh kështu, hesht dhe ki turp, sepse të turpërohesh është diçka e bukur. Ki turp, sepse ai që ka turp përpigjet të mos i përsërisë gabimet. Ki turp, sepse kundrejt Krijuesit gjithmonë të ka hije turpi. Ndoshta kështu të ulet koka, shpëton nga mendjemadhësia dhe nuk i shikon më me nënçmim robërit e Allahut Teala, o drita e syrit tim.

Ata që e teprojnë dhe i kalojnë kufijtë, janë dy llojesh: Lloji i parë sillet duke e bërë të qartë nijetin që ka. Në këtë mënyrë, të trembin dhe të bëjnë të largohesh. Lloji i dytë e fsheh nijetin e tij si një gjuetar mjeshtër. Ia fiton zemrën gjahut me dashamirësi dhe i përgatit kurthin me mirësjellje. Dy gjëra mund të bësh përballë një njeriu të tillë:

1- E kupton shpejt gjendjen, por të bën të ndihesh mirë dhe bie në kurth duke e ditur. Në këtë situatë nuk je viktimë. Kështu që mos bërtit dhe mos bëj zhurmë për shkak të mashtrimit.

2- Nuk e kupton kurthin dhe nuk e ndjen sherrin, për shkak të nijetit tënd të mirë. Madje gëzohesh, kur e shikon ngaqë e do. Por kur të biesh në kurth, e kupton se ke gabuar. Këtë herë je viktimë, por çfarë do të përfitosh, nëse bërtet pasi të biesh në kurth? Të gjithë do ta dëgjojnë. Nëse e heq baltën, ngelet shenja e saj. Ajo shenjë nuk do të të ngjitet vetëm ty, por të gjithë atyre që të rrethojnë. Atëherë, lëre veten në një qoshe dhe përsëri hesht e mos bërtit, në mënyrë që të pengosh një dëm edhe më të madh, edhe pse e di se do të përpigjen të japin argumente kundër teje dhe do të thonë: “Ishe i kënaqur dhe nuk nxore zë.” Derdh lot dhe duro për atë që të ka ndodhur! Padyshim se vjen një ditë dhe ndahet shapi nga sheqeri dhe drejtësia gjen vendin e saj.

Vjedhjen e kanë quajtur sëmundje dhe turpin e kanë quajtur rehati. Zhveshjen e konsiderojnë guxim dhe të shikuarit e zhveshjes e konsiderojnë burrëri. Pasi ranë deri në këtë gradë, disa njerëz e pandehën si famë apo mjeshtëri bërjen e disa punëve që vetëm kafshët i bëjnë përpara të gjithëve. Sikur dikush i urdhëroi: “O njerëz! Virtyti është turp dhe turpi është virtyt! Termat duhen ngatërruar. Njerëzit duhet të garojnë në neglizhencë dhe në humbje!” Ata që përpigjen në rrugë të Zotit, sikur janë kthyer në dele përballë atij që dha këtë urdhër. Ndërkohë që termat janë ngatërruar kaq shumë, ti e ke farz qëndrimin pranë atyre që e kanë zemrën e zgjuar. Këtej e tutje, duhet të shikosh më me shumë kujdes rreth e rrotull dhe duhet të qash më shumë në sexhde, o drita e syrit tim.

Shkrimet nuk mund të tregojnë tonin e zërit tënd

dhe as qëllimin e përvëlmin e zemrës tënde. Për ta konsideruar fajtor apo të pafajshëm një njeri duke u mbështetur në një argument të shkruar, duhet ta njohësh nga shumë afër atë, por prapëseprapë, zemra e atij njeriu që e njeh shumë mirë, shpeshherë është një botë misterioze për ty. Atëherë vëzhgoje, edhe një herë vëzhgoje. Nëse dëshiron të mos pendohesh më vonë, llogarite edhe anën e padukshme të çështjeve dhe mos nxito të gjykosh me atë që ke parë, o drita e syrit tim.

Para se të gjykosh, shikoje me kujdes, sepse ai që e pandeh kosh mbeturinash, mund të ketë ndonjë copë floriri. Nëse nuk ka flori, mund të ketë argjend. Nëse nuk ka argjend, mund të ketë thërime buke. Sidoqoftë, ti mësohu të shikosh me kujdes. Kontrollu përsëri para se të varësh, të presësh dhe të derdhësh. O drita e syrit tim! Mos u bëj mendjeshkurtër, dembel dhe i verbër!

The: “Unë e dua vuajtjen që më bën të të shikoj dhe të të takoj. Por pas kësaj, dua gëzimin që më bën të vij te ti.” Tha: “Ti do ta arrish edhe atë gëzim kur të mësosh të falënderosh për vuajtjen. Ja, atëherë do të qash me gëzim dhe jo me vuajtje, o drita e syrit tim.”

Ke një nijet të mirë dhe një shikim të pastër, por kjo nuk mjafton. Këtyre bukurive shtoj edhe zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë, në mënyrë që shija jote të jetë e përsosur. Mos u zemëro me asnjë. Çfarëdo që të të ndodhë, është pasojë e punëve të tua. (esh-Shura, 30) Mund të bësh çdo lloj gabimi, por nëse je i dashuruar, mos gabo ta shohësh me dyshim të dashurin, o drita e syrit tim.

Duhet të shohësh pa bërë zënka, pa ofenduar, pa sulmuar dhe pa e larguar si dallkaur atë që nuk meriton. Duhet ta pranosh se britma e papjekur nuk është gjë tjetër përveçse zhurmë. Ti duhet të rritesh për hir të respektit të nënës, e cila të ka përkundur në gjunjë përgjatë gjithë natës, duke thënë: “Rritu, rritu, rritu!” A nuk do të ishte keq për ty, o drita e syrit tim, nëse nuk i dëgjon këto që them dhe nuk ua vë veshin këtyre që shkruaj, nëse nga një mish i butë shndërrohesh në një mish të madh të papjekur?

E kam shumë të qartë se askush nuk është pa mangësi qind për qind. Por edhe të mangët qind për qind nuk ka. Allahu i bëftë sunduese të vërtetat tona dhe na mundësoftë që të përkujtohem me drejtësi. Gjitha-shtu, kam mësuar se çdo njeri ka mirësi. Po ashtu, ka edhe sherr. Allahu i shndërroftë sherret tona në mirësi, mirësitë tona i bëftë dominuese dhe na mundësoftë të përkujtohem me mirësi. Tani për tani nuk kam gjë tjetër për të thënë. Kjo është fjala ime e fundit: Mos shiko ashtu! Mos rri duke parë, por thuaj amin, o drita e syrit tim!

Ka një transmetim (të cilin do ta rrëfej më poshtë) që më prek shumë, sepse më bën të mendoj dhe më djeg shpirtin. Më djeg shpirtin, sepse nganjëherë njeriu i jepën disa mundësi që, nëse përfiton prej tyre siç duhet, bëhet mbret, përndryshe humb çdo gjë. Këto mundësi mund të jenë një mirësi e madhe për të, për familjen, për të afërmit, për të dashurit, moshatarët, madje edhe për popullin dhe vendin e tij.

Por nëse njeriu nuk mendon dhe nuk e di vlerën e tij, nganjëherë e ndërron salltanetin me një dëshirë të zakonshme dy-tre grosh, me një pasion haram dhe një epsh të ulët. Ose e flijon për mendime të çuditshme, për shqetësime të pavend, për frikë të panevojshme dhe për fantazi të errëta. Njerëzit që nuk janë të dobishëm për veten e tyre, janë të dhënë shumë pas halleve të veta dhe në këtë mënyrë, mbyten në dallgët e mjedisit të keq që i rrethon. Ata janë në burgun e zi të presionit të mëhallës. I shkatërrojnë mundësitë në pusët qorre të shpresave imagjinare, që ndoshta nuk do të realizohen kurrë. Sa bukur kanë thënë gjyshërit tanë: “Mundësia vjen një herë në dorë, kështu që mos e lërë të të ikë!”

Ja pra, një mundësi e tillë i ishte ofruar me tepsi floriri Ufejfu'l-Kindit (r.a.). Njeriu nuk shikon pemën e tij që i ka zënë sytë, por shikon filizin e tjetrit që sapo ka filluar të shpërthejë. Gabimet tona nuk ka hambar që t'i zërë, ndërsa ne flasim për mangësitë e të tjerëve. Të flasësh për të tjerët është e lehtë, por burrëria është të mos e hamë bistakun edhe vetë, nëse është haram. Ajo që nuk u ka hije të tjerëve, nuk duhet të na ketë hije as ne, apo jo?

Sa shumë gjëra humbasin ndonjëherë për shkak se shohim të këqijat e të tjerëve. Unë po i shkruaj këto dhe po i tregoj, me shpresë që të marrim mësim nga pendimi që përjetoi ky sahab.


Ufejfu'l-Kindi (r.a.), thotë: “Unë isha tregtar. Edhe Abbas bin Abdulmuttalibi ishte tregtar. Abbasi vinte në Jemen, blinte erëra të mira (parfume) dhe i shiste në periudhën e haxhit. Ai ishte miku im. Në kohën e xhahilijetit shkova në Mekë. Shkova te shtëpia e Abbas b. Abdulmuttalibit. Familjes sime desha t'i blija ca rroba nga Meka dhe disa erëra të mira nga të Abbasit.. Në kohën e drekës po qëndroja pranë tij dhe po shihja Qaben.

Në ato momente, një mesoburrë iu afrua Qabes. E ngriti kokën drejt qiellit dhe pa. Pastaj, në këmbë, u drejtua nga Qabja. Më pas erdhi një fëmijë dhe qëndroi në këmbë në të djathtë të tij. Pa kaluar shumë, erdhi një grua dhe qëndroi pas tyre. Kur burri u përkul (ra në ruku), edhe fëmija me gruan

ranë në ruku. Burri u ngrit nga rukuja dhe u drejtua. Edhe fëmija me gruan u ngritën nga rukuja dhe u drejtuan. Burri ra në sexhde. Edhe fëmija me gruan ranë në sexhde. I thashë Abbasit:

- O Abbas! Kam parë diçka të madhe dhe të mahnitshme!

- Po! Ajo është diçka e madhe! A e di ti se kush është ky burrë?



— Xhemal Nar —

VLER I MUNI



BËSIMI DËSIVE!

- Jo! Nuk e di- i thashë.
Abbasi më tha:
- Ky është Muhamed b. Abdullah b. Abdulmuttalib. Është djali i vëllait tim.
Pastaj më pyeti:
- A e di se kush është ai fëmija pranë tij?
- Jo! Nuk e di!
- Ai është Ali b. Ebu Talib b. Abdulmuttalib. Është djali i vëllait tim.

- A e di kush është kjo grua?
- Jo! Nuk e di!
- Ajo është Hatixhe bint Huvejlid. Gruaja e djalit të vëllait tim. Djali i vëllait tim thotë se kjo fe që pe dhe të cilën po e ndjekin ata, është urdhër i Zotit të qiejve dhe të tokës. Për Zotin, në të gjithë tokën, unë nuk di të ketë njerëz të tjerë në këtë fe, përveç këtyre të treve!

Ah sikur të kisha besuar atëherë dhe të bëhesha burri i dytë besimtar. Sa do dëshiroja të isha i katërti i tyre!”- thoshte i penduar Ufejfu'l-Kindi. ¹

Allahu Teala qoftë i kënaqur prej Aliut, Hatixhe bint Huvejlidit, Ufejfu'l-Kindit dhe Abbasit! Po ashtu, qoftë i kënaqur edhe prej dijetarëve që na e kanë transmetuar këtë ngjarje!

A mund ta imagjinoni dot sa mirësi të madhe humbi ky burrë?!

Të qenët burri i dytë në Islam! Të qenët mysliman më parë se Ebu Bekri (r.a.)!

Aman o Zot, sa mirësi e madhe është kjo! Sa humbje e madhe është nënvlerësimi i kësaj mundësie!

Ja pra, o vetja ime! Është e lehtë të shohësh fatkeqësinë dhe të thuash “obobo”. Po, mundësia që nuk vlerësoi ishte e madhe. Por edhe ti, nëse do të dëshiroje, mund të bëheshe një veli i madh, një mik i Allahut Teala, një mysliman shembull dhe një burrë që kur të vdisje, të qanin për ty toka dhe qiejt. Madje ti, akoma mund të bëhesh.

Përse nuk je bërë?

Mbrëmë nuk të ka lënë të ngrihesh për namazin e natës një shije e përkohshme e gjumit. Mos vallë kjo ishte diçka që nuk e ke shijuar më parë? Fjete, por çfarë fitove? A nuk mund të ngriheshe natën, pastaj të flije deri vonë? A nuk do ishte më mirë sikur të bëje dhikër në kohën e agimit dhe ta falje namazin e sabahut me xhemat? Ja pra, ikën gjithë ato mundësi...

Mos vallë ndodh ndonjë gjë, nëse nuk u jep rëndësi mashtrimeve të djallit që nxit epshet, nëse nuk dëgjon thashethemet që i vijnë të ëmbla veshit dhe nëse nuk e fiton riskun në haram?

Vete, mos më bëj të t'i numëroj të këqijat! Të gjitha gjërat e humbura për ty, janë kënaqësi e çastit. Por pendimi për to vazhdon përgjatë gjithë jetës. Ndërsa kënaqësia e vërtetë që besimi lë në zemër, nuk mbaron dhe nuk konsumohet asnjëherë.

Përderisa nuk ka dalë shpirti, ka një shpresë. Akoma nuk ke vdekur, o vetja ime. Të thënë “ah, sikur” nuk ka dobi. Pendimi në fund është i vlefshëm vetëm nëse bën dobi.

Marrëdhëniet besim-moral në Islam

— Prof. dr. Iljas Çelebi —

Qëllimi i fesë islame është sigurimi i lumturisë së njeriut në të dyja botët dhe Allahu përmes peygamberëve ka treguar rrugën e realizimit të këtij qëllimi. Peygamberët na kanë mësuar parimet e fesë, na kanë shpjeguar karakterin e marrëdhënies sonë me Zotin, me veten, me shoqërinë dhe me natyrën. Parimet e fesë shprehin pozicionin tonë ndaj Allahut dhe kozmosit.

Në të njëjtën kohë, peygamberët na kanë mësuar se çfarë duhet të bëjmë, si duhet të sillemi dhe si duhet të jetojmë për të fituar lumturinë e dy botëve. Të gjitha këto, në Kuran shprehen me termin “Salih amel” (vepër e mirë).

Me “Salih amel” nënkuptohet çdo veprim dhe sjellje e mirë, e dobishme dhe që është në harmoni me urdhëresat fetare. Veprat që këshillohen dhe urdhërohen përfshihen në termin “salih amel”. E kundërta e kësaj janë veprat e ndaluara, të dëmshme dhe të dënueshme nga ana fetare.

Vepra dhe sjellja e mirë që mund të demonstrojë njeriu, ose ka lidhje me Zotin dhe në këtë rast quhet ibadet, ose ka lidhje me njeriun dhe në këtë rast quhet moral. Tre parimet e fesë janë përmbledhur në hadithin e famshëm të Xhebrailit përmes tri fjallëve: “iman”, “islam” dhe “ihsan”. “Imani” shpreh pjesën teorike, atë çfarë duhet të besojmë, “Islami”

shpreh atë çfarë duhet të bëjmë dhe “Ihsani” shpreh sjelljet e mira dhe të hijshme. Sipas kësaj, morali përbën njërin nga tri pjesët që formojnë parimet e fesë islame. Tri shtyllat në fjalë janë prekur përmbledhtazi në suren Asr në formën “iman, vepër e mirë dhe këshillë në të vërtetë dhe durim”. Morali shpreh tërësinë e sjelljeve që shfaq një person.

Feja islame e konsideron njeriun me besimin, mendimin, ndjenjat dhe sjelljet e tij si të tërë. Besimi është produkt i zemrës, mendimi i trurit, ndjenja e ndërgjegjes dhe sjelljet produkt i organeve. Për mirëfunksionimin e jetës së njeriut, të gjithë këta elementë duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. Shembulli më i mirë i shprehjes së kësaj tërësie dhe harmonie është Peygamberi (a.s.).

Një botëkuptim është kuptimplotë, kur ai përcaktohet nga mendime, ndjenja, ideale, qëllime të larta dhe sistem besimi fetar gjithëpërfshirës. Sipas këtij këndvështrimi e ka përcaktuar Kurani dhe Suneti botëkuptimin e myslimanit dhe për këtë e ka bërë obligim besimin dhe veprimin si të pandashëm nga njëri-tjetri.

Kurani, siç trajton parimet e besimit, në mënyrë sistematike trajton edhe temat morale dhe i ofron njeriut materialin e duhur për të krijuar një sistem moral të përsosur. “Salih amel” nuk përfshin vetëm



veprim, adhurime që kanë lidhje me Allahun, si: namazi, agjërimi, haxhi etj., por përfshin të gjitha sjelljet e mira kundrejt njerëzve, si: bamirësinë, devotshmërinë, besnikërinë, përgjegjësinë. Ajeti: **“Vërtet, ata që i përulen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”** shpreh dy anët e veprës së mirë. Kurse në një vend tjetër, në mënyrë figurative fenë e përngjason me një pemë, rrënjët e së cilës simbolizojnë besimin, trangu vepër kurse frutat moralin.

Të gjitha mësimet, këshillat, sjelljet dhe veprimet e Profetit (a.s.), synojnë arritjen e dashurisë hyjnore. Si shembull mund të përmendim: *“Besimtar i vërtetë është ai që kur bën një vepër të mirë gëzohet dhe kur bën një vepër të keqe trishtohet.”* (Ahmet ibn Hanbel, Musned, I, 398.)

Një ditë, një sahabi vjen tek Pejgamberi (a.s.) dhe e pyet: “Kush është myslimani më i mirë?” Pejgamberi (a.s.), i thotë: *“Myslman më i mirë është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët janë të sigurt.”* (Buhari, Iman, 4-5.) Kurse një herë tjetër, kur e pyetën cili është islami më i mirë, tha: *“Të ushqesh njerëzit dhe të përshëndesësh me selam atë që njëj dhe atë që nuk e njëj”* (Buhari, Iman, 6.)

Kurse porosi profetike që tregojnë raportin e ngushtë besim-moral mund të numërojmë: *“Nuk mund të jesh besimtar i vërtetë, përderisa nuk dëshiron për vëllain mysliman atë që dëshiron për veten*

tënde.” (Buhari, Iman, 7) *“Ruajtja nga intrigat është pjesë e fesë.”* (Buhari, iman, 12) *“Turpi është pjesë e besimit.”* (Buhari, iman, 16) *“Xhahadi (përpyekja) është prej besimit.”* (Buhari, iman, 26)

Siç theksohet në Kuran dhe Hadith, midis moralit dhe besimit ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Nëse Islamit e përngjasojmë me një pemë, atëherë rrënjët janë besimi, degët veprat e mira dhe frutat morali i mirë. Nga kjo kuptohet lehtë që qëllimi përfundimtar dhe kryesor i pemës janë frutat. Prandaj, njeriu vetëm në këtë mënyrë mund t'i realizojë pritshmëritë. Hadithi profetik *“Unë kam ardhur për të përsosur moralin”* shpreh qëllimin përfundimtar të të gjithë sistemit.

Megjithëse pjesa teorike është shumë e qartë, për shkak të kushteve historike, koniunkturës dhe dallimeve kulturore, më vonë janë shfaqur rryma me pikëpamje të ndryshme përsa i përket marrëdhënies mes besimit dhe moralit.

Morali nga pikëpamja e sjelljes përfshihet tek veprat e mira, kurse nga pikëpamja e ndjenjave dhe vlerave përfshihet te besimi. Prandaj, me marrëdhënien besim-moral nënkuptojmë gërshetimin midis këtyre tri shtyllave kryesore. Fatkeqësisht, morali është shpëputur nga shkencat bazike islame, duke iu bashkëngjitur filozofisë. Por morali në kulturën islame nuk ekziston thjesht si një teori, ai së pari është gjendje që jetohet dhe shijohet.

Shija e Jetës

— Mehmet Dinç —

“Njeriu i pasur mendon se po shijon lirinë, kur merr ushqime me çanta të tëra dhe pa bërë llogari fare. Njerëzit që përcaktojnë vlerën e tyre, sipas parasë që harxhojnë, mendojnë se kanë arritur kulmin e shijes së jetës. **Mirëpo, pikërisht ata që mendojnë se po e shijojnë jetën në maksimum, mbesin pa dyshim dhe të dështuar përballë jetës.** (Otobüsname, Fatma Karabıyık Barbarosoğlu, fq. 53)

Nëse do të pyesni çfarë është shija e jetës, do të merrnit me qindra përgjigje të ndryshme. Mes përgjigjeve, në mendje vijnë natyrshëm menjëherë: të kesh një kartë krediti të palimituar, të bësh një shëtitje nëpër botë, të blesh makinën apo shtëpinë që pëlqen më shumë etj. Mirëpo, jam në dyshim nëse do të vinte ndonjë përgjigje nga ndonjëri: “Shija e jetës arrihet kur di të jesh i lumtur me atë që ke?” Jetojmë në një shoqëri konsumi dhe për arsye të virusit të konsumit që po përhapet me shpejtësi nga njëri tek tjetri, njerëzit besojnë se duke konsumuar do të rrojnë më shumë, se do të jenë më të lumtur. Ndaj dhe për të festuar një gjë që e duan dhe për t’u ngushëlluar për diçka që i mërzi, ndjekin të njëjtën rrugë: konsumin. Ka njerëz, ëndrra e të cilëve është të fitojnë telebingo dhe që fituesit e telebingos i shohin si njerëzit më me fat të botës, për arsye se mendojnë që jetën mund ta shijojnë duke konsumuar dhe konsumimin e shohin si ideal më vete.

Duke fituar nga puna ditë-natë, mendojnë se do të çlodhen duke konsumuar dhe nisin të ndjekin ata njerëz, që e kanë realizuar këtë objektiv. Ndjekin programe të llojit “gossip” dhe lexojnë rreth “thashethemeve mbi të famshmit”. Madje, nuk mjaftohen me kaq, por bëhen gazetarë vullnetarë të thashethemeve të zonës ku banojnë, duke analizuar pasuritë dhe mundësitë materiale të të tjerëve dhe “informojnë” fqinjët kur vijnë për vizitë.

Fëmijët që rriten në një rreth të tillë, të krijuar prej këtyre njerëzve, e kërkojnë lumturinë aty ku e kërkojnë të rriturit. Duan ta kenë çdo gjë që pëlqejnë. Çmenden derisa t’u realizohen dëshirat dhe pas një kohe shumë

të shkurtër, pasi u realizohet ajo çfarë dëshironin, sillen njësoj me atë që deshën me këmbëngulje, sikur të ishte apo të mos ishte, madje, duke e supozuar që nuk ekziston më, kërkojnë një tjetër.

Tashmë janë bërë legjendë ata fëmijë që flinin me rroba apo këpucë nga qejfi dhe gëzimi që i kishin blerë vetëm për bajrame dhe askush tashmë nuk e beson se një fëmijë i sotëm mund ta përjetojë të njëjtën kënaqësi dhe gëzim.

Mjaftueshmëria, pra, të qenët i kënaqur me atë që ke, është një thesar i çmuar. Të moshuarit na kanë mësuar se jeta shijohet vetëm përmes mjaftueshmërisë. Unë njoh pak njerëz që mjaftohen me atë që kanë dhe që nuk kërkojnë më shumë, njerëz që shijojnë jetën të lumtur, duke u mjaftuar me atë që kanë. Fatëkeqësisht, as një në njëmijë nuk është. Çdokush kërkon të fitojë sa më shumë, me një neps që nuk resht kurrë, kërkon gjithnjë e më shumë të ketë. Mendojnë se jeta shijohet duke fituar sa më shumë, duke konsumuar sa më shumë dhe duke zotëruar sa më shumë gjëra. Mirëpo, si ai që pi ujë të kripur, i cili ndihet gjithnjë i etur, njeriu sa më shumë të konsumojë, ndjen nevojën të konsumojë sërish, sa më shumë të marrë, ndjen nevojën të marrë më tepër, sa më shumë të ketë, ndjen nevojën të ketë më tepër. Por askush nuk mund ta bëjë veten të lumtur me ndjenjën e të pasurit të sa më shumë gjërave. Në këtë botë të vdekshme, këta lloj njerëzish nuk mund ta marrin nga asnjëlloj ushqimi shijen që marrin të varfrit nga një lloj i vetëm ushqimi, kur hanë të uritur në një enë dhe nuk mund të qeshin kurrë me gjithë zemër dhe duke u vezulluar sytë, siç gëzohen të varfrit, nga një gjë e vogël. Këta njerëz bëjnë një jetë të mjerë, duke bërë një garë të pakuptimtë dhe pafund deri në vdekje.

Aftësia shpirtërore për të qenë i kënaqur me atë që ke, është thesari i humbur, pa të cilin nuk ka lumturi. Duhet ta gjejmë dhe ta zotërojmë atë për t’iu kthyer normalitetit, mesatares dhe lumturisë.



Mund të fle edhe në stuhi

A. Jasin Demirxhi

Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë: *“Begatitë, që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t’i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”* (Fatir, 2.)

La Tahzen / Mos u mërzi

Në këtë botë nuk mund të gjesh asnjëri që nuk ka halle apo vështirësi, qofshin ato pak apo shumë. Atëherë, ngushtimin që lind në zemrën tënde për shkak të vështirësive dhe vuajtjeve me të cilat po përballësh, zgjeroje me vepra të mira, në mënyrë që zemra të gjejë qetësi.

La Tahzen / Mos u mërzi

“Kije kujdes zemrën! Gjithmonë mbroje gjendjen e dhikrit dhe qetësisë shpirtërore! Kur të përparosh në këtë rrugë, vendos t’i dalësh për zot zemrës deri në një kufi të caktuar, vendos se nuk do ta humbësh afrimitetin me Allahun (xh.sh.) dhe se nuk do të biesh në neglizhencë! Nëse vepron kështu, do ta arrish qëllimin dhe do ta plotësosh dëshirën tënde.”

Para disa vitesh, një bujk kishte blerë një fermë në një kodër ku frynte shumë erë. Pasi u vendos aty, puna e parë që bëri ishte gjetja e një ndihmësi. Por as në fshatrat e afërta dhe as në ata të largëta askush nuk donte të punonte në fermën e tij. Të gjithë ata që kërkonin punë, hiqnin dorë sapo shihnin vendin e punës dhe thonin: “Këtë vend e rrahin shumë stuhitë. Do të ishte mirë që edhe ju të hiqnit dorë nga kjo fermë.”

Së fundi, punën e pranoi një burrë i dobët, që e kishte kaluar moshën e mesme. Pronari i fermës e pa gjendjen e burrit dhe nuk duroi dot pa e pyetur:

“A di të punosh në fermë?” Burri i tha: “Diçka mendoj se di. Them se mund të fle edhe kur të fillojë stuhia.”

Pronari i fermës mendoi pak për këtë fjalë pa lidhje, por pastaj nuk i dha shumë rëndësi dhe e mori burrin në punë. Pasi kaluan disa javë dhe vuri re se burri i administronte mirë punët e fermës, u qetësua.

Derisa filloi stuhia.

Në mes të natës, u zgjua prej zhurmës së frikshme të stuhisë. Ajo ishte aq e tërbuar, sa edhe ndërtesa dukej se po shkulej nga vendi. Menjëherë u ngrit nga shtrati dhe shkoi në dhomën e punëtorit: “Çohu, çohu! Ka filluar stuhia. Le të bëjmë çdo gjë që duhet para se era t’i marrë të gjitha!” Burri pa u ngritur fare nga shtrati pëshpëriti:

“Mos u brengosni, zotëri! Shkoni dhe flini! Unë ju pata thënë kur më morët në punë se mund të fle edhe kur të fillojë stuhia.”

Bujku desh u hutua nga nënvlerësimi i punëtorit. Puna e parë që do të bënte të nesërmen, ishte përzënia e tij, por tani duhej të gjente një zgjidhje për stuhinë. Doli jashtë dhe shkoi te mullarët e kashtës. Sa çudi! Mullarët e kashtës ishin vënë bashkë, ishin mbuluar me mushama dhe ishin lidhur fort. Shkoi në ahur. Të gjitha lopët ishin futur brenda dhe dera ishte mbyllur mirë. Pastaj u drejtua nga shtëpia. Qepenat e shtëpisë ishin të mbyllura.

Bujku u kthye i qetë në dhomën e tij dhe u shtri në shtrat. Stuhia vazhdonte të fishkëllente. Buzëqeshi dhe, kur po mbyllte sytë, pëshpëriti:

“Mund të fle edhe kur të fillojë stuhia.”

Si përfundim, nëse

- logjikisht (keni dije dhe plane),

- shpirtërisht (lutje),

- materialisht (merrni masa) kundrejt vështirësive,

mund të flini rehat edhe kur të fillojë stuhia. Madje gjatë gjithë jetës.

Mesazhi i Fjalës së bukur

— Idris Arpat —

Në suren el-Isra, thuhet:

“Thuaju, robërve të Mi, të flasni atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.” (Isra, 53.)

Allahu (xh.sh.), i cili i ka dhënë njeriut aftësinë e të folurit, thotë: ***“Thuaju, robërve të Mi, të flasni atë që është më e mira.”***

Kur lexoni këtë ajet, zemrën ua ngroh dëshira për të hyrë në grupin e fatlumëve, që Allahu i Lartësuar i përmend me shprehjen “ibadi / robërit e Mi”.

Mendoni: Allahu i Madhëruar, me mëshirën e Tij të pafundme, i drejton bisedat tuaja. Me këdo që të flisni, ju urdhëron të zgjidhni fjalët më të mira. Urdhëron të flisni pa e lënduar bashkëbiseduesin tuaj dhe të gjeni e të shprehni atë fjalë që hedh në zemrën e tij dashurinë ndaj së vërtetës.

Ju duhet ta respektoni këtë, kur të flisni edhe me mëkatarët dhe qafirët. Kundrejt tyre nuk duhet

të përdorni fjalë të prera dhe lënduese. Çështjen e atij që keni përballë, nuk duhet ta nënçmoni. Bashkëbiseduesin nuk duhet ta detyroni të përdorë shprehje nxitëse. Duhet të jeni të kujdesshëm kundrejt cytjeve të djallit të mallkuar.

Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët të zgjedhin më të mirën dhe të sillen me ndjeshmëri pothuajse në çdo çështje. Për shembull, urdhëron që të kenë kujdes se çfarë hanë dhe çfarë pinë. Ndërmjet mirësive të pafundme që i ka nënshtruar ndaj njerëzve, urdhëron që të zgjedhin hallallin dhe të pastrën. (Shik. el-Bakara, 2/168.) Kjo mund të themi se ka lidhje me strukturën fizike dhe me jetën individuale. Ndërsa në ajetin që përbën temën tonë, flitet për dinamikën bazë që formon paqen dhe qetësinë në jetën sociale. Kjo përkon me misionin e vërtetë të besimtarit, që vërtetohet me këtë ajet:

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin. (Sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” (Al ‘Imran, 110.)

Atëherë, gjithmonë jeni të detyruar të flisni duke zgjedhur fjalët më të bukura, më të drejta

dhe më të dobishme. Nisur nga kjo, ajeti fisnik që përbën temën tonë, shpreh një domosdoshmëri përtej garës së virtutshmërisë, sepse këtu shprehet një urdhër që s'ka lidhje me kohën dhe vendin.

Tani po mendoj:

Çfarë është fjala *e mirë*? Sepse jam i detyruar ta di këtë, që të zbatoj urdhrin e dhënë në ajet. Në këtë çështje, përgjigjen e pyetjes e gjej në një ajet tjetër. Në suren Fussilet, Allahu Teala pyet:

“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman.’”? (Shih 41/33.)

Transmetohet se personi, për cilësitë e të cilit bëhet fjalë në këtë ajet, është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Kjo e bën edhe më të domosdoshme zgjedhjen e fjalës së bukur në çdo aspekt.

Në Ruhu'l-Bejan thuhet: Fjala më e bukur është përkujtimi i Allahut, duke thënë ‘la ilahe illallah’ me plot sinqeritet. Vepra më e bukur është çdo lloj pune që bëhet në përputhje me të vërtetën dhe me fenë. Ndërsa, karakteri më i bukur është që njeriu t’i dorëzohet me gjithë vullnetin e tij Allahut Teala, t’u bëjë mirë njerëzve pa pritur ndonjë shpërblim prej tyre, t’i falë të këqijat që mund t’i vijnë prej tyre, të gjendet ndërmjet njerëzve duke shfaqur dashuri për ta dhe t’i inkurajojë njerëzit për të bërë vepra të mira, pa i imponuar e t’i ndalojë nga e keqja pa i nënçmuar.

“Thuaju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.”

Ndërsa rezultatet e rrezikshme, që lindin nga moszbatimi i këtij urdhri të ajetit fisnik, shpjegohen kështu:

Përndryshe, shejtani do të hyjë ndërmjet njerëzve dhe do t’i inkurajojë për t’u grindur me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre do të mbjellë farërat e prishjes me sjellje të ashpra dhe të vrazhda. Sepse, përderisa njerëzit të mos e këshillojnë njëri-tjetrin dhe të mos sugjerojnë për të mira, djalli hyn lehtësisht ndërmjet tyre dhe ua shkatërroi ndjenjat e vëllazërisë.

Tani mund të themi: Fjalët e bukura nxjerrin në pah sjellje të mira dhe me to arrihet uniteti dhe vëllazëria në shoqëri. Ndërsa sjelljet e vrazhda, që lindin prej fjalëve të shëmtuara, e shkatërrojnë mjedisin e qetë, i cili është formuar me përkujdesje. Sepse djalli gjen mundësinë për t’i ngatërruar njerëzit me anë të fjalëve të shëmtuara, të

vrazhda dhe të pahijshme.

Në fjalët e pamatura, që dalin nga goja në momentin e zemërimit, gjenden rrugë që ndikojnë për të prishur.

Atëherë, fjala e bukur është një valvul sigurie, që nuk i jep mundësi kalimi armikut të përbeuar të njerëzve, shejtanit, për të hyrë në fushat, ku mund të ndikojë. Ëmbëlsinë e Islamit mund t’ia shfaqim botës vetëm me anë të tyre (fjalëve të bukura). Kapitali ynë më i rëndësishëm është fytyra jonë e buzëqeshur, është fjala jonë e bukur dhe gjuha jonë e ëmbël. Në të njëjtën kohë, ajeti fisnik tregon edhe zgjidhjen e këtij problemi, në mënyrë që të mos i jepet shejtanit ajo mundësi.

Në suren el-Bekare thuhet se një fjalë e bukur, që i inkurajon njerëzit për mirësi dhe falja e gabimeve, është më e lartë se lëmosha që përcillet me fyerje. (Shih 2/263.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë se fjala e bukur është më e vlefshme se lëmosha me të cilën ushqehen të uriturit dhe plotësohen nevojat e tyre. (Shih Buhari, Edeb, 34.) Po ashtu, na ka paralajmëruar se fjala e shëmtuar është haram për t’u thënë.

Sa paralajmërim i madh është ky për njeriun, i cili komunikon me anë të të folurit, që është cilësia më e dallueshme ndërmjet të gjitha krijesave.

Sigurisht se fjala më e bukur është Kurani Fisnik dhe njeriu që flet më bukur është i Dërguari i Allahut, (a.s.), nëpërmjet të cilit Kurani iu shpall njerëzimit. Të tjerat janë të vlefshme dhe të bukura, aq sa kanë afërsi dhe përputhshmëri ndaj këtyre të dyjave.

Meqë myslimanëve u takon autoriteti dhe përgjegjësia për t’ia shpallur njerëzimit fjalët e bukura që burojnë prej këtyre, sot është shumë me rëndësi që ta mbartin, ndejnë dhe jetojnë këtë hijeshi me të gjithë seriozitetin e madh të saj.

Gjëja e mirë dhe e bukur, sigurisht gjithmonë është e vlefshme. Por vlefshmëria për të cilën po flasim, ndryshon sipas mungesës dhe shumicës së asaj gjëje. Atëherë, të gjithë duhet të themi fjalët më të bukura, në mënyrë që të zbukurojmë veprat, moralin dhe mendimet tona. Zemrave që nuk e njohin këtë shije, duhet t’u thuhet fjalë të bukura si lëmoshë. Ne duhet ta përhapim këtë amanet në çdo vend ku mund të arrijmë, duke filluar nga të afërmit.



Grudaja e parë MYSLIMANE

— Adem Saraç —

E gjithë e jeta e nënës sonë, Hadixhes, radijallahu anha, është e mbushur me shembuj të bukur në çdo aspekt. Mirëpo, këtu do të përpiqemi të përmbledhim, vetëm sjelljen e saj të pashoqe në kohën kur zbriti shpallja e parë.

Kur Pejgamberit tonë (a.s.), i erdhi shpallja për herë të parë, shkoi në shtëpi i frikësuar dhe tha: *“Më mbuloni! Më mbuloni!”*. Nëna jonë Hadixhja (r.a.), ia plotësoi kërkesën me dashuri dhe butësi. Më pas, me një zë që të ngrohte shpirtin, shprehet me këto fjalë madhështore:

*“Ti gjithmonë ke qenë i ndritur. Mirëpo tani, në fytyrën tënde shoh një nur që nuk e kam parë deri më sot dhe ndjej një aromë që nuk e kam ndjerë më parë!”*¹

Më vonë, Pejgamberi (a.s.), u qetësua dhe pasi u ngrit, u ul në vendin ku ishte shtrirë. Kur e pa që erdhi në vete, Hadixhja (r.a.), menjëherë shkoi dhe u ul pranë tij. Kaloi nga ura e syrit dhe u ul në vendin e shpirtit të tij, duke u munduar të kuptonte atë që kishte ndodhur!

Pejgamberi ynë (a.s.), duke e parë me dashuri, i tregoi një për një çdo gjë që kishte ndodhur në malin Hira. Pastaj shprehu shqetësimin e tij, duke thënë:

*“Kam frikë se do të më ndodhë ndonjë e keqe!”*²

Ndërsa nëna jonë Hadixhja (r.a.), u përpoq ta qetësonte me fjalët më të bukura dhe më të ngrohta, duke i thënë:

“Mos ki frikë, mos u shqetëso! Ty nuk do të të ndodhë gjë! Betohe në Allahun e Madhëri-shëm, se Ai nuk do të të turpërojë dhe nuk do të të hidhërojë asnjëherë, sepse ti kujdesesh për të afërmit, u qan hallin të dobtëve dhe i ndihmon ata. Ti nuk i nënçmon të varfrit, të mjerët e të vetmuarit, por ulesh dhe bisedon me ta, duke i ndihmuar me aq sa ke mundësi. Ti je mikpritës dhe të pëlqen t'i gostisësh miqtë. Ti përpiqesh t'i ndihmosh të gjithë pa dallim, të mëdhenj apo të vegjël qofshin. Ti nuk e njeh hilen dhe mashtrimin. Ti flet gjithmonë të drejtën. Ti je një njeri, të cilin e duan, e respektojnë dhe e besojnë

1. Ibn Ishak, Siretu Ibn Ishak el-Musemmâ bi Kitabi'l Mubtede' ve'l-Meb'as ve'l-Megazi, fq. 60; Ibn Haxher el-Askalani, el-Isabe fi Temjizi's-Sahabe, vol. 4, fq. 2428; Bejhaki, Delailu'n-Nubuue ve Ma'rifetu Ahvâli Sahibi'sh-Sheria, Vol. 2, fq. 148.

2. Taberi, Tarihu'l-Umem ve'l-Muluk, vol. 2, fq. 2207; Ibn Sejjidunnas, Ujunu'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve'sh-Shemâil ve's-Sijer, vol. 1, fq. 86.

të gjithë. Tek ti janë mbledhur të gjitha virtytet e mira. Prandaj, mos ki frikë, mos u shqetëso! Allahu kujdeset për ty. Me lejen e Allahut, nuk do të të ndodhë asgjë e keqe!³

Pas një kohe të gjatë, kjo ndodhi u përsërit sërish. Mirëpo, këtë herë, sapo u shtri, u çua dhe u ul në vend. Ndërsa nëna jonë Hadixhja (r.a.), filloi t'i fliste me gjithë shpirt me një zë të mbushur plot mëshirë:

“Përse u ngritët menjëherë? Ju nuk pushuat aspak!”

Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj me këto fjalë:

“*Tashmë iku koha e pushimit dhe rehatisë, o Hadixhe!*”⁴

Pasi tha këto fjalë, filloi të këndonte një nga një, ajetet e para të sures el-Muddethir...

“O ti, i mbështjellë (o Muham-med)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)! Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë dhe për hir të Zotit tënd, duro!” (Muddethir, 1-7.)

Drita hyjnore që do të shndriste gjithë universin, po lindte nga shtëpia e Pejgamberit tonë (a.s.), i cili u ngrit nga vendi ku ishte shtrirë, duke u zhytur nga drita në dritë me ndriçimin e atyre ajeteve fisnike.

Ndërkohë që sulltani i pejgamberëve po këndonte këto ajete, nëna jonë Hadixhja (r.a.), kishte humbur në sytë e tij të bekuar që shkëlqenin nga drita. Ajo i dëgjoi fjalët që dilnin nga gjuha e tij e bekuar, sikur po mblidhte perla, xhevahire dhe diamante. Dëgjoi dhe kuptoi. U trondit dhe u valëvit si dallgët e oqeanit.

Pejgamberi ynë (a.s.), i tregoi shkurtimisht për detyrën që i kishte ngarkuar Allahu Teala. Ai tha

3. Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vol. 1, fq. 81, pika 90; vol. 5, fq. 260-265, pika 2875; Ibn Abdilber, el-Isti'ab fi Ma'rifeti'l-Ashab, vol. 4, fq. 353; Ibn Habib, el-Muhabber, fq. 79; Ibn Hazm, Xhevamiu's-Sire, fq. 295.

4. Dhehebi, Tarihu'l-Islam ve Vefejatu'l-Meshahir ve'l-A'lâm, fq. 128; Ebu'l-Fida Ibn Kethir, el-Bidaje ve'n-Nihaje, vol. 3, fq. 13, 24.

se tashmë Allahu e kishte ngarkuar me detyrën e thirrjes së njerëzve në Islam dhe shtoi:

“*E kujt mund t'ia tregoj këtë të vërtetë? Kush do të më mbështesë mua?*”⁵

Kjo zonjë e lartë, e cila po i dëgjonte me vëmendje të madhe fjalët e Pejgamberit të Allahut, duke qenë e vetëdijshme se me çfarë kishte të bënte, shfaqti një qëndrim mjaft të hijshëm. Për shkak se gjithmonë i gjendej pranë, pa nguruar aspak dhe me një entuziazëm të madh u hodh e tha:

“O i Dërguar i Allahut! Unë të pranoj ty dhe të mbështes e para! Më thirr mua të parën në rrugën e Allahut!”⁶

Fjalët e Hadixhes (r.a.), e gëzuan pa masë shpirtin e Pejgamberit tonë (a.s.). Hadixhja (r.a.), ishte e para që e pranoi ftesën hyjnore dhe e para që u nderua me Islam. Në këtë mënyrë, trangu i umetit të Muhamedit (a.s.), filloi me nënën tonë Hadixhe (r.a.). Ajo zuri vendin si myslimania e parë në historinë islame.


E kishte kuptuar. Ajo e kishte kuptuar shumë mirë se për çfarë bëhej fjalë! Ndryshimi kishte filluar. Procesi i ndriçimit kishte filluar, sepse drita kishte lindur!

Tashmë po fillonte një periudhë e re! Jeta kishte fituar kuptimin e saj dhe besimi ishte bërë kriteri i vlerave të patjetërsueshme. Tashmë çdo fjalë dhe vepër do të matej e peshohej me besim. Në bazë të kësaj, do të flitej dhe jetohej.

Hadixhja (r.a.), hyri në historinë islame, si gruaja e parë myslimane. Po ashtu, ajo gjatë gjithë jetës, jetoi si e para e myslimanëve dhe, megjithëse kanë kaluar shumë shekuj që nga vdekja e saj, ajo gjithmonë mban vendin si myslimania e parë. Nëna jonë, Hadixhja (r.a.), e cila në burimet historike konsiderohet si myslimania e parë, do të qëndrojë e tillë edhe në zemrat e të gjithë myslimanëve deri në Ditën e Kiametit...

5. Ibn Sejjidunnas, Ujuni'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve'sh-Shemail ve's-Sijer, vol. 1, fq. 91-92.

6. Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vol. 5, fq. 82-84.



VARFËRIA, FANATIZMI DHE FETARIA E THATË

— M. Muhtar Esh-Shenkiti —

Ibn Rexhebi, në librin me titull “Zejl Tabakati el-Hanabile” transmeton nga Ibn Akili lavdërimin që u bëhet Hanbelive të Bagdadit. Në këtë lavdërim zënë vend këto shprehje: “Ishin një popull me temperament të fortë. Morali dhe karakteri i tyre nuk i lejonte të përziheshin me njerëzit. Ndërmjet tyre sundonte serioziteti. Ndërsa shaka bënin pak.”

Allame edh-Dhehebiu, në librin me titull “el-Iber fi haberi men Gaber”, transmeton këtë, në lidhje me Shejh Abdussettar el-Mukaddesin dhe thotë: “Ai u preokupua me sunetin. Debatoi me kundërshtarët dhe u bëri tekfir. Sulmoi shkollën Esh’arite dhe e akuzoi me texhsim (antropomorfi). Pastaj kundërshtoi Hanbelitë dhe i la. Ai kishte një moral të vështirë e të ngurtë që e shoqëronte mirësia dhe feja e thatë.”

Përsëri edh-Dhehebiu, në librin me titull “Sijeru A’lami’n-Nubela”, duke komentuar fjalët e Shejh Ebi Hatim bin Hamusit: “Asnjë njeri që nuk është Hanbeli, nuk është mysliman”, thotë: “Ebu Hatim bin Hamusi merrej me hadithin. Ai kishte një kuptim të thatë dhe një moral të vështirë.”

Fjalët e Ibn Akilit, në lidhje me temperamentin e Hanbelive dhe të Dhehebiut në lidhje me el-Mukaddesin e me Ibn Hamusin, janë bërë përmbledhje e cilësive më të rëndësishme ideore dhe psikologjike të disa thirrësve selefi dhe burrave të kësaj lëvizjeje:

-Ata merrreshin me mbledhjen e sunetit profetik

dhe me shqyrtimin e zinxhirëve të transmetimit të tij. Me ta, Allahu në këtë fushë i bëri dobi umetit në përgjithësi. Ata, siç ka ndodhur edhe në shekujt e mëvonshëm, nuk e merrnin lehtë çështjen e transmetimit, por selefitë nuk i bashkuan dot frytet e transmetimit me konceptimin e mendjes. Për këtë arsye, dokumentimi i transmetimeve të ata ngeli i privuar nga analiza dhe fikhu ngeli i privuar nga transmetimet.

Madje, në traditën e disa selefive mendja e logjika u pranuan si ofendim dhe me vetë vullnetin e tyre u zhveshën prej saj sikur të mos e kishin dëgjuar fjalën e poetit Umer bin el-Verdi: “Si mund të vrapojë në çmenduri një njeri që mendon?!”

-Ata u zhytën në debate lakmitare në çështjet e itikadit. Kjo gjendje argumenton se selefizmi bashkëkohor është kthyer në një situatë të ngjashme me ekolin e kelamit, që është i apasionuar për t’u zhytur në çështjet delikate të akaidit, pa pasur ndonjë nevojë shariatike. Kjo nuk përputhet me metodën e selefizmit, e cila është formuar mbi modestinë larg vështirësimit, lojërave teorike dhe zhytjeve në çështje delikate, përveç kur është e nevojshme.

-Kundërshtarët e tyre myslimanë i sulmojnë ashpër dhe u bëjnë tekfir në shumë çështje që kundërshtimi është i lejuar. Mund të themi edhe këtë: Ndërkohë që ithtarët e feve të tjera përpiqen ta shtojnë numrin e tyre, disa selefi mundohen ta pakësojnë numrin e myslimanëve. Natyrisht, disa

xhemate selefije kanë tërhequr shumë probleme dhe vështirësi ndaj vetes. Përsëri ata kanë hapur plagë të thella në strukturën e umetit, për shkak të sjelljeve të ashpra ndaj kundërshtarëve dhe tekfirit që u bëjnë.

Ky konceptim largues nuk njihet asnjë kufi. Çdo ditë e ngushtojnë hallkën dhe i nxjerrin jashtë konceptit “es-sunnetu ve’l-xhema” disa prej grupeve të reja, që me të vërtetë zotërojnë këndvështrime selefiste. Këtë koncept e kanë kthyer në një mur të lartë ndërmjet tyre dhe umetit në përgjithësi.

-Së fundi, vjen vetia e një fetarie të vrazhdë, të ngurtë dhe të thatë larg simpatisë, butësisë, ndjenjës, delikatesës shpirtërore dhe kënaqësisë së bukurisë. Kjo logjikë e imponimit dhe e epërsisë është një fetari e përzgjedhur ndaj logjikës së bindjes dhe fitimit. Sipas disa xhemateve selefie, kjo prirje ka një plan të pasëm historik dhe shoqëror. Ndërsa sipas disa selefivë të tjerë, kjo prirje buron nga metoda e arsimit dhe edukimit. Kjo metodë mbështetet në mburrjen intelektuale dhe në frikën kulturore.

Këto cilësi nuk janë të përgjithshme për të gjithë selefite apo hanbelite. Përgjithësimi i kësaj nuk është larg padrejtësisë. Po në të njëjtën mënyrë, ky vlerësim (që bëhet për hanbelite), nuk do të thotë se është i pavlefshëm edhe për klasat fetare të tjera, sepse edhe ato nuk janë larg këtij. Në këtë material kemi shtjelluar shkollën selefite, për shkak se këto cilësi janë më evidente te ata dhe që sot në fushën e fesë kanë mjaft ndikim.

NËSE IDENTITETI VRET REFORMËN DHE ZHVILLIMIN

Profesori i Akademisë Britanike dhe i Universitetit të Oxfordit, Abdulhakim Murad, thotë se disa selefie e kanë konkretizuar mburrjen intelektuale dhe nënvlerësimin dhe këtë e ka quajtur “varfëria e fanaticizmit” (poverty of fanaticism). Ndërsa ne do ta quajmë “medresetu’l-iktifa ve’l-inkifa” (shkolla e mjaftueshmërisë dhe e mbylljes në vetvete).

Fanatizmi është pjellë e ndjenjës së një mjaftueshmërie të gabuar, që nuk ndjen nevojë për kulturën, dijen dhe mënyrën e jetesës së të tjerëve. Në historinë e kulturës ka një të vërtetë, e cila është: Hapja dhe toleranca sjellin pasuri intelektuale e shpirtërore, ndërsa fanatizmi shkakton varfëri intelektuale dhe joproduktivitet shpirtëror.

Filozofi Claude-Levi Straus thotë se nxjerrja në pah e diçkaje të re mund të realizohet vetëm në kufirin ndërmjet dy kulturave. Ndërsa filozofi Muhamed Ikbali, këtë vlerësim e shpreh në formën e një kornize islame: “Bota islame mund të zhvillohet vetëm me një zemër lindore dhe një mendje perëndimore.” Të gjithë ata që e burgosin veten në kulturën historike, e dënojnë atë në joproduktivitet dhe zbehtësi. Ky debat i hapje-mbylljes ka një lidhje të fuqishme me ekuilibrin e fuqisë dhe dobësisë.

Popujt në periudhat e fuqishme priren ndaj besimit të vetes, ndaj kureshtjes për dije, ndaj dashurisë për të zbuluar dhe ndaj etjes për informacion, në periudhat e dobësisë i kaplon dobësia e besimit në vetvete, e fanatizmit fetar dhe i refuzojnë shumë-llojshmëritë intelektuale, etnike e kulturore.

Arabët dhe myslimanët zgjeroheshin dhe evoluonin në periudhat kur ishin të fuqishëm e të zhvilluar. E ekzaminonin botën dhe përpiqeshin për të mësuar ndonjë gjë nga çdo popull dhe kulturë. Madje, ata gjetën dikë si el-Biruni që të shkruajë librin “Fjalët e pranueshme apo të papranueshme nga mendja e indianëve”. Ndërsa sot shikojmë se selefite shfaqin metoda që nxjerrin në pah një personalitet të lëkundur e që frikësohet nga vetvetja si “lufta intelektuale e kulturore”.

Për shkak të këtij personaliteti, që e ka humbur besimin ndaj vetvetes, u humb mendimi i përmirësimit dhe i zhvillimit për të cilin fonte Afganin, Muhamed Abduhu e të tjerë si këta para njëqind vitesh. Mentaliteti i identitetit dhe frika që ndiej për këtë, e vrau mendimin e reformës që kërkonte me këmbëngulje Reshit Rizai, ndërsa selefite e kundërshtonin.

Ridvan es-Sejjid, në librin e tij me titull “Sijasetu’l-Islami’l-Muasir” vrojton shikëputjen ndërmjet shkollës së reformës në kohën e Abduhut e të Afganit, që çështje më kryesore kishte zhvillimin dhe mentalitetin islam në gjysmën e dytë të shekullit XX, që më shumë ishte i prirur ndaj identitetit.

Për këtë arsye, Ridvan es-Sejjid mendon se Muhamed Abduhu vjen para Reshit Rizasë, Reshit Rizaja para Hasan el-Bennas, Hasan el-Benna para Sejjid Kutubit dhe Sejjid Kutubi para Umer Abdurrahmanit. Reshit Rizai në fillim ishte reformator, pastaj kaloi në selefizëm dhe mbyllje në vetvete. Ai është hallka e kalimit ndërmjet dy shkollave. Për këtë arsye, Dr. Muhamed Ammara refuzon që Reshit Rizaja të vendoset në kategorinë e reformatorëve. Ammara ia ka qëlluar në këtë çështje, sepse reforma dhe përmirësimi nuk përputhen me metodën e mjaftueshmërisë dhe mbylljes në vetvete.

SELEFIZMI MBRETËROR DHE SELEFIZMI KAOTIK

Kur para disa vitesh po bisedoja me profesorin tim me origjinë Libaneze në Universitetin e Teksasit për selefizmin, ai bëri një vlerësim që meriton të mendohet shumë dhe tha: “Selefizmi është dy lloj: Selefizmi mbretëror (monarkist) dhe selefizmi kaotik (anarkist).” Ky vlerësim e përmbledh shumë bukur thellësinë e krizës metodike të selefivë.

Selefite nuk kanë bërë ndonjë program deri tani për ndryshim pozitiv. Ata janë në prirjen e bindjes ose të përballimit të rreptë. Falënderimi i qoftë Allahu që selefite nuk janë burgosur vetëm brenda këtyre dy rrymave. Në periudhën e fundit ka dalë

një rrymë e tretë që është më afër shpirtit të reformës dhe përmirësimit. Kjo rrymë mban një rrugë ndërmjet këtyre dy rrymave ekstremiste mbi të cilat po flasim në këtë material.

Selefizmi mbretëror legalizon ato që bëjnë drejtuesit e padrejtë dhe e këshillon popullin t'u bindet e t'u nënshtrohet atyre. Popullin e sugjerojnë të qëndrojnë larg fitnes dhe përçarjes... Madje, disa fakihë të tyre kanë dhënë fetva se protestat paqësore janë haram dhe se një student i të dijes nuk i ka hije të ndjekë kanalën el-Xhezira, sepse velijju'l-emr nuk e pëlqëka këtë kanal!!!

Ndërsa selefizmi kaotik, në të njëjtën kohë u ka dalë kundër drejtuesve e shoqërisë dhe përipiqet ta hedhë në ajër të gjithë universin, duke shpresuar se do të lindë një botë e re, për cilësitë e së cilës nuk kanë ndonjë imagjinatë të qartë.

Të gjitha këto nuk do të thonë se këto dy rryma kanë kontradikta në çdo gjë. Përkundrazi, rryma mbretërore bie në konsensus me rrymën kaotike në ashpërsinë intelektuale, jurisprudenciale dhe në prononcimin e zjarrtë që pothuajse rrethon të gjithë kundërshtarët. Faktikisht, mund të themi këtë: Selefizmi kaotik, krahas rrezikut të qëndrimit praktik, përshtatet më shumë me tezat teorike dhe bie më pak në kundërshtim me logjikën e tyre. Ndërsa selefizmi mbretëror shfaq një kontradiktë të qartë qesharake ndërmjet ashpërsisë intelektuale dhe nënshtrimit praktik.

Ndërsa lidhja logjike ndërmjet dy shkollave selefite është shumë e fortë. Secila prej tyre merr nga tjetra shkaqet e qëndrimit në jetë, të zhvillimit e të lartësimit. Selefizmi mbretëror e vlerëson si largim nga bindja dhe copëtim të xhematit çdo qëndrim kundër ligjeve të shëmtuara, të cilat shikohen sot nëpër shtetet myslimane. Në këtë mënyrë, ai është i paaftë të ndajë nga njëra-tjetra opozitën paqësore me kryengritjen e armatosur në aspektin e fikhut.

Për këtë arsye, përpara të rinjve të zjarrtë nuk lë rrugë tjetër përveç ashpërsisë që nuk ka logjikë. Ndërsa selefizmi kaotik, me ashpërsinë e verbër që shfaq pa pasur ndonjë plan frenimi moral dhe ndryshimi programor, e forcon ndikimin e selefizmit mbretëror dhe i jep të drejtë metodës së tij. Në këtë mënyrë të dyja shkollat ushqehen nga njëra-tjetra.

LARGIMI NGA IMITIMI DHE PAAFTËSIA PËR IXHTIHAD

Proceset kalimtare në jetën e shoqërive nuk ndodhin pa dhunë dhe dhimbje. Këtë e shikojmë në historinë e Europës në ditët e revolucionit francez dhe në historinë e Amerikës në ditët e revolucionit amerikan. Normalisht edhe popujt myslimanë që po përjetojnë proceset kalimtare sot, për fat të keq, nuk po ndodhin pa dhunë. Ky bllokim politik që gjendet te popujt, është i thellë dhe kronik.

Përsëri, prapambetja në fushat e strukturës administrative, ligjore dhe zbatimit të ligjit te këta popuj, është në përmasa skandaloze. Të gjitha këto janë nga një shkak që u hap derën shumë lloj dhunash intelektuale dhe politike. Kjo dhunë mund të veshë pektun e fesë, siç ndodh te selefizmi kaotik i sotshëm, por mund të veshë edhe pektun sekularist, siç ndodh te grupet e majta të shekullit të njëzetë.

Por kur të shikohet në thellësi, vihet re se kjo dhunë, siç mund të jetë shprehje e një transformimi dhe krize kalimtare shoqërore, po ashtu është edhe njëra prej shenjave të mosekzistencës së ligjit politik në popujt myslimanë e veçanërisht ata arabë. Sot vendet tona kanë nevojë që njerëzit e mençur të marrin në dorë drejtimin e punëve, t'i nxjerrin popujt nga procesi kalimtar ku realisht ndodhen dhe t'i lartësojnë në aspektin intelektual, shoqëror e politik duke paguar sa më pak kundërvlerë dhe duke hequr sa më pak dhimbje.

Dhuna intelektuale e politike, siç nuk është një alternativë ligjore, nuk është edhe një alternativë diktature, përkundrazi dhuna e fuqizon diktaturën, e legalizon atë dhe ia zgjat jetën.

Kjo çështje lidhet me shkallën e praktikimit të demokracisë së vërtetë dhe lirisë së zgjedhur te popujt tanë. Popujt e lirë kanë potenciale për ta rregulluar veten e tyre me metoda të qytetëruara. Ndërsa në popujt e shtypur, njerëzit strehohen në logjikën e fuqisë me pretekstet më qesharake. Në këtë mënyrë, populli mbetet i izoluar ndërmjet shpatës së prijësit tiran dhe tesbihëve të dervishit servil. Që të dy këta, siç thotë Muhamed Ikbali, janë fatkeqësi për të ardhmen e umetit dhe të popullit.

Deri kur do të zgjasë heshtja ime?

Sulltani dhe dervishi kënaqet shumë nga kjo.

Me këtë tesbih e me këtë shpatë,

Që të dy jetojnë me gjërat që u japin ato.

Ne myslimanët jemi një umet që nuk e pranojmë imitimin dhe të paaftë për ixhtihad. Ky është misteri i vuajtjes sonë aktuale. Tashmë ka ardhur koha për të shpëtuar nga ky qorrsokak. Refuzimi i imitimit është krenari dhe nder. Në këtë çështje toleranca nuk është e lejuar. Ndërsa paaftësia në ixhtihad është poshtërsi dhe shkatërrim. Të ne reforma duhet të fillojë me shpëtimin e fesë nga pushteti i shtetit. Liria e ndërgjegjes është baza e besnikërisë së etikës së vërtetë. Ndërsa liria e mendimit është baza e nxjerrjes në pah së një gjëje të re.

Kur të respektohet liria dhe parimet islame që e bëjnë të lirë njeriun, atëherë do të dalë në pah fallsiteti i fetarisë së rreme që i prangos këto parime dhe e kthen në instikt shkatërrues shpirtin e mirë dhe krijues që sjell Islami. Tashmë, ka ardhur koha që, pa na ikur ky shans, të përballemi me varfërinë e fanatizmit dhe fetarinë e thatë.

RUAJTJA

Nga përgojimi

— Sadik Dana —

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Kur më nxorën në qiej natën e miraxhit, pashë një grup njerëzish. Nga kraharorët e tyre këputej mish dhe u jepej kafshata-kafshata në gojë. Atyre u thuhej:

‘Hani mishin e vëllezërve që i përgojuat!...’ Kur e pashë këtë pamje, e pyeta Xhebrailin:

‘O Xhebrail! Kush janë këta?’ Ai m’u përgjigj: ‘Këta janë përgjuesit prej umetit tënd.’

Xhabiri dhe Ebu Saïdi, radijallahu anhuma, transmetojnë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Largohuni prej përgojimit. Sigurisht, përgojimi është më i keq se imoraliteti, sepse, nëse dikush bën imoralitet dhe pendohet, Allahu mund t’ia pranojë pendimin. Por atë që përgojon, Allahu nuk e fal, derisa ta falë i përgojuari.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur të flasësh për vëllain mysliman diçka që atij nuk i pëlqen, e ke përgojuar atë.”

Miqtë e Allahut, arifët dhe të sinqertët janë ata që e sundojnë zemrën, gjuhën dhe i kryejnë adhurimet. Të flasësh për të tjerët dhe të përgojosh është shumë e lehtë, sepse kjo realizohet edhe me ndihmën e nefsit. Si nuk mund ta heqë nga goja çamçakëzin ai që është mësuar me të, nuk mund ta lërë përgojimin edhe ai që është i dhënë pas tij.

Përgojimi është njëra prej sëmundjeve më të këqija shpirtërore në kohën tonë, që po përhapet shumë, ngaqë është pakësuar dija rreth fesë, dija për Allahun dhe frika ndaj Tij. Për të shpëtuar prej saj, duhet t’i dalim për zot vullnetit tonë, të qëndrojmë shumë me të devotshmit e të mirët dhe të marrim pjesë në kuvendet e tyre fetare. Njeriu që e di kuptimin e ajetit **“ue huve meakum ejnema kuntum – Ai është me ju kudo që ju të gjendeni ”**, gjithmonë është i kujdesshëm.

Çdo lëvizje dhe sjellje e atij që e kupton se është nën vëzhgimin e Allahut Teala, është në përputhshmëri me kënaqësinë e Zotit, (xh.sh.) dhe me edukatën islame. Ai nuk shfaq sjellje të ulëta. Nuk mund të ulet këmbë mbi këmbë apo duke u shtrirë pa ndonjë arsye të fortë dhe largohet nga ata që e duan shumë dynjanë si dhe nga përgjuesit, ashtu sikur i largohet luanit. Sepse njeriu, do apo nuk do, merr prej gjendjes së atij me të cilin qëndron, domethënë, merr prej veseve të tij. Zgjidhja e kësaj mund të arrihet duke u ngritur në kohën e agimit, duke falur namaz nate dhe pastaj, duke u lutur me insistim:

“O Zot! Më bëj prej atyre që bëjnë punë me të cilat je i kënaqur. Më mbro prej mëkateve dhe veçanërisht prej përgojimit, koprracisë, urretjes, smirës dhe prej dashurisë ndaj kësaj bote!” Sepse ka shumë prej adhuruesve që

kanë bërë padrejtësi për shkak të dashurisë dhe interesit të kësaj bote.

Ekspozimi i së keqes së të keqit në vendin e duhur dhe kur është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos dëmtojë të tjerët, nuk është përgojim. Ai që ka informacion për këtë dhe e fsheh kur duhet ta ekspozojë, është përgjegjës për të.

Për shembull, nëse dikush dëshiron të bëhet ortak me dikë tjetër, por ai me të cilin dëshiron të bëhet ortak u ka ngrënë paratë disa njerëzve të tjerë, kjo nuk duhet të fshehet, por duhet të thuhet e vërteta kur të pyetet. Nëse personi për të cilin pyetet është i drejtë, duhet të thuhet: “Është shumë i drejtë dhe punon me pastërti në tregti. Është shumë i mirë.”

Apo, nëse dikush kërkon dorën e një vajze dhe kërkon informacion prej nesh, së pari duhet t’i tregojmë për cilësitë e larta të asaj vajze. Nëse ajo vjedh apo është e pamoralshme, nuk duhet t’ia fshehim atij, sepse, ai që pyet, na ka besuar. Ajo që na takon ne të bëjmë, është të shprehurit e së vërtetës dhe së drejtës.

Këto të fshehta i thuhet vetëm atij që pyet. Nëse përhapen rreth e rrotull, atëherë kjo kthehet në përgojim.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Ditën e Gjykimit do të hapet libri i sevapeve të dikujt. Ai do të thotë: ‘O Zot! Unë pata bërë këto adhurime kur isha në dynja. Por ato nuk janë të shkruara në libër.’ Atij do t’i thuhet: ‘Ato të janë fshirë nga libri dhe janë shkruar në librin e atyre që i ke përgojuar.’

Ditën e Gjykimit do të hapet libri i sevapeve të dikujt tjetër. Aty shikon ibadete, të cilat nuk i ka bërë. Atij i thuhet: ‘Këto janë sevapet e atyre që të kanë përgojuar.’

Në një hadith fisnik, thuhet:

“Nëse dikush përgojohet, le t’i kërkojë falje Allahut Teala për atë që e ka përgojuar.”

Ndërsa në një hadith tjetër fisnik, thuhet:

“Atë që përgojon, Allahu Teala e dënon me dhjetë gjëra:

1. E largon nga mëshira e Tij.
2. E largon nga engjëjt.
3. Ia shkatërron adhurimet dhe të mirat e tij.
4. E largon nga i Dërguari i Tij.
5. I zemërohet.
6. E kthen kokëposhtë kur t’ia marrë shpirtin.
7. I jep ndëshkim të rëndë në varr.
8. Ia lë veprat pa sevape në momentet e vdekjes.
9. E afron drejt xhehenemit.
10. E largon nga xheneti.”



Ushqime natyrore apo përforcuese

— Dr. Ali Akben —

Nuk ka ditë që në median e shkruar të mos ndeshemi me artikuj apo lajme rreth ushqyerjes, shëndetit, jetës së gjatë dhe jetesës cilësore. Të dhënat e ndryshme dhe të shumta që formulohen në lidhje me jetesën e shëndetshme, duam apo s'duam, tërheqin vëmendjen e njerëzve.

Orientimet rreth ushqyerjes organike dhe naty-

rale, që vitet e fundit janë bërë edhe pak modë, pothuajse janë shndërruar në kamerdare shpëtimi për njeriun e sotëm që është i lodhur, i mërziur dhe i dëshpëruar.

Problemet e shumta shëndetësore dhe gjërat negative me të cilat përballemi, si rezultat i gabimeve të pafalshme që bëjmë në të ushqyer, në

stilin e jetesës dhe në jetën tonë, na përgatisin terrenin për të vepruar në mënyrë të pavetëdijshme.

Informimet e pabaza që dëgjohen andej-këndej, ose sensacionet e partnerëve e të miqve gjoja se kjo vitaminë i bën mirë filan sëmundjeje dhe numri i njerëzve që presin shërim për shqetësimet e tyre të ndryshme nga disa vitamina minerale përforcuese, po shtohet çdo ditë me shpejtësi.

Nëse jeni një njeri i painformuar mjaftueshëm nga aspekti i dijes shëndetësore, jeni pak i ndjeshëm ndaj dobive e dëmeve dhe lehtësisht i imponuar nga të tjerët, duhet ta lexoni këtë artikull. Duhet ta lexoni, sepse industria e vitaminave, ushqimeve përforcuese dhe ilaçeve nga e cila vendet perëndimore kanë shumë vështirësi për të dalë, ka filluar të bëhet problem edhe në vendin tonë.

Njeriu i sotëm po përballet me këto ushqime përforcuese sikur të ekzistonin disa sëmundje që janë bërë problem për njerëzit në kohëra të jash-tëzakonshme, si luftë, tërmet apo zi buke. Vallë, sa janë të vërteta dhe të sinqerta këto këshilla dhe sugjerime që duken si të pafajshme e që na ngjiten pothuajse si rrodhe me logjikën, “unë e kam marrë dhe më ka bërë mirë, prandaj merre edhe ti”, gjë e cila transmetohet pareshtur në programet televizive apo që shkon gojë më gojë nga fqinji te fqinji tjetër!

Vitaminat A-D-E-K, që njihen edhe si ADEK, janë vitamina që nuk mund t’i hedhim lehtë, ngaqë mbarten në qelizat tona duke u shkrirë në dhjamë pasi të merren. Domethënë, teprica e tyre që organizmi nuk e nxjerr dot jashtë, mund të na helmojë duke u mbledhur në indet dhe qelizat tona.

Në të njëjtën mënyrë, edhe metalet, si: kalciumi, zhiva, fosfori dhe arseniku, që gjenden te disa ushqime përforcuese, të cilat quhen suplement, hyjnë në qelizat tona dhe shkaktojnë dëmtime të përhershme. Edhe disa prej problemeve më të rëndësishme të njeriut të sotëm, e dimë se janë dobësia, lodhja dhe gjumi i çrregullt që kanë lidhje me helmimin e rëndë të metaleve.

Kur studiojmë probleme, të tilla si sjelljet e çrregullta te fëmijët, mangësia e përqendrimit dhe shpërqendrimi i memories e vëmendjes, shohim se ata lindin nga ushqimet e rafinuara, pijet me gaz dhe kola, ushqimet me ngjyruet dhe ushqimet përforcuese.

Arritjet në shkencë e në art dhe zhvillimi marra-mendës në teknologjinë e përparimit të shpejtë në civilizim, i kanë bërë njerëzit e vërtetë pothuajse artificialë. Tashmë, mjaftohemi me aromën e frutave në vend të shijes dhe erës së tyre dhe jetojmë duke pandehur se kemi ngrënë fruta.

Përse vitaminat dhe ushqimet përforcuese, që na shfaqen si kamerdare shpëtimi nuk e japin efektin e pritshëm prej tyre, në mënyrë që të shpëtojmë nga shumë sëmundje, si: hiperaktiviteti, shpërqendrimi i vëmendjes, sëmundjet alergjike, astma, stresi, çrregullimi i gjumit, dobësia, kapitja, lodhja, dëshpërimi etj...

Përse nuk vijmë në vete prej sëmundjeve, edhe pse i bëjmë analizat dhe filmat me teknologjinë më të përpiktë? Përse nuk e arrijmë dot rezultatit e pritshëm në shumë sëmundje nga ilaçet dhe ushqimet përforcuese që na shfaqen si zgjidhje të mrekullueshme? Ne duhet ta pranojmë të vërtetën se nuk mund të arrijmë në një rezultat duke bërë letërsi zgjidhjesh e çajresh dhe duke shtuar pyetjet...

Nëse i hedhim një sy të shpejtë fabrikës së qelizës, që është guri më i vogël bazë i strukturës sonë, menjëherë mund të shikojmë përsosmërinë dhe natyrshmërinë e saj. Kjo fabrikë pothuajse ka një mbrojtje të veçantë kundrejt çdo gjëje që nuk është e natyrshme. Kur elementin e hekurit, ndaj të cilit ka nevojë për të prodhuar gjak, ta sigurojmë nga rrugë të natyrshme, ajo funksionon më me produktivitet dhe më shëndetshëm. Një qelizë gjaku e përpunon shumë më lehtë hekurin nga materialet e natyrshme, si: pekmezi, perimet me gjethe jeshile, fasulja, thjerrëza dhe mish. Ndërsa hekurin e ushqimeve përforcuese të rafinuara, lëre që nuk e përpunon, por e ka shumë të vështirë edhe për ta thithur...

Ne mund të japim edhe shumë shembuj të tjerë, por përmbledhja e kësaj çështjeje është kjo: Kur të konsumojmë fruta e perime në stinën e tyre, duke marrë ushqime natyrale me masë e ekuilibër, nuk kemi nevojë ta mashtrojmë veten duke marrë preparate (përgatesa) të ushqimeve përforcuese apo të vitaminave. Uroj që nën dritën e maksimës “mbrojtje nga dëmi”, që është pranuar universalisht në mjekësi, ta mbajmë larg trupin tonë nga çdo gjë negative, të cilin Zoti (xh.xh.), na e ka dhënë amanet dhe na e ka bërë obligim ta ruajmë.

Dëllinja

lëngu magjik

Dëllinja përmban një sërë acidesh organike të rëndësishme për trupin e njeriut gjithashtu sheqerna natyrale, kalium e kalcium. Dëllinja është magjike, sepse me pijen që mund ta prodhoni lehtësisht në shtëpitë tuaja, pastroni veshkat dhe sistemin urinar, trajtoni problemet e stomakut sidomos tretjes si dhe pastroni mushkëritë tuaja nga sekrecionet.

VLERAT E DËLLINJËS

Dëllinja përmban një sërë acidesh organike të rëndësishme për trupin e njeriut gjithashtu sheqerna natyrale, kalium e kalcium. Ndër vlerat kryesore të dëllinjës dhe lëngut magjik është pastrimi i mushkërive. Shpesh dëllinja përdoret për pastrimin e bronkeve nga infeksionet dhe sekrecionet. Pas ndihmesës për mushkëri të pastra vjen stomaku, të cilin dëllinja e ndihmon në tretjen e ushqimit si dhe nga djegiet apo forma të ngjashme të ulcerës.

Efekti tjetër pozitiv i dëllinjës është vërtetuar në sistemin urinar e veshka. Konsumimi i lëngut që përfitohet nga to, pastron veshkën dhe shëron ciste që shpesh hasen te femrat. Gjithashtu përdorimi i dëllinjës ndikon në uljen e kolesterolit, diabetit dhe sasisë së ujit të tepërt në trup. Dëllinja mund të përdoret dhe në formë vaji, i cili përdoret për çlirim të kontraktimeve muskulore.

PËRGATITJA


Pasi të keni blerë një sasi, të paktën 2-3 kilogram, duhet ta lani mirë e ta pastroni nga gjethet. Në një damixhane qelqi ose një tjetër enë por që të jetë qelq, futni dëllinjat dhe shtojini ujë. Raporti është një kilogram dëllinja me 4 litra ujë. Për 40 ditë radhazi, ena duhet të rrijë në një vend të errët e të thatë, e pasi të mbushet koha, ju mund të shijoni lëngun magjik. Nëse i fusni gjatë verës me dëllinja të vjetra, shishja duhet të hapet për 4-5 javë.

PËRDORIMI

Kjo pije e përfitur zgjat për disa kohë, pasi duhet të veproni në këtë mënyrë; Kur të hapni enën ditën e parë ju do të merrni një sasi të caktuar, një apo dy litra lëng dëllinje, e po atë sasi që morët, ju do e zëvendësoni sërish në damixhane me ujë të pastër. Kështu do të veproni sa herë të merrni një broke lëngë në damixhane, do e zëvendësoni me po aq sasi uji. Kjo zgjat deri në momentin kur ju do kuptoni vetë se cilësia e lëngut që përfitonit e ka humbur shijen e fortë të fillimit.

KUJDES:

Përdorimi afatgjatë i kokrrave të dëllinjës mund të shkaktojë irritime dhe dëmtime në veshka, sepse dëllinja praktikisht sforcon veshkën. Kjo është arsyeja përse dëllinja rekomandohet për 30 ditë çdo 4-5 muaj. Nëse jeni shtatzënë ose po përpiqeni të krijoni familje, atëherë mos e përdorni dëllinjën. Shmangeni atë edhe nëse ushqeni fëmijën me gji. Dëllinja arrin të ulë sheqernat në gjak, dhe shkakton shqetësime serioze tek njerëzit me diabet.





Lëngu i majdanozit

një thesar i vërtetë vlerash

Tufat me ngjyrë të ndezur të majdanozit janë ndjellëse dhe plot vlera për çdo lëng me bazë perimesh dhe frutash që ofrojnë energji, vitamina dhe minerale për organizmin. Lëngu i majdanozit mund të pihet veçmas ose të kombinohet me lëngje të tjera të freskëta si atë të mollës, portokallit e të tjera që janë bujare në vlera ushqimore dhe shëndetësore.

Një gotë e mbushur në gjysmë me majdanoz të freskët ofron 30 ml lëng.

PËRFITIMET E VITAMINËS A

Vitamina A është thelbësore për shëndetin e zemrës, mushkërisë dhe veshkave. Ajo luan rol thelbësor në mirëqenien e syve dhe mbron ngjyrën e retinës. Një racion prej 30 ml lëng majdanozi plotëson 14 përqind të dozës së rekomanduar ditore të kësaj vitamine për meshkujt, 18 përqind të dozës së nevojshme për femrat, 16 përqind për femrat shtatzënë dhe 10 përqind për nënat lehonë.

PËRFITIMET E VITAMINËS C

Vitamina C tretet në ujë, ndaj ajo nuk duhet të mungojë asnjëherë në trup, sidomos pas faktit që një pjesë e madhe e saj largohet nëpërmjet urinimit. Kjo vitaminë thelbësore ndihmon në riparimin e dëmeve në organizëm, prodhon kolagenin për enët e gjakut dhe lëkurën, por edhe përshpejton shërimin e plagëve. Vitamina C shërben si antioksidant, duke mbrojtur trupin nga radikalet e lira dhe toksinat mjedisore.

Në një sasi prej 30 ml lëng majdanozi, gjenden 40 miligramë vitaminë C që plotëson 45 përqind të dozës së rekomanduar për meshkujt dhe 50 përqind të asaj për femrat. Femrat shtatzënë dhe nënat

lehonë kanë nevojë për më shumë vitaminë C. E njëjta sasi lëngu ofron 47 përqind dhe 33 përqind të dozave të rekomanduara respektive të kësaj vitamine për këtë kategori. Pirja e duhanit pakëson sasi të vitaminës C ndaj duhanpirësit kanë nevojë për shumë vitaminë

PËRFITIMET E VITAMINËS K

Vitamina K që gjendet me bollëk tek barishtet dhe tek majdanozi e mbron organizmin nga mpiksjet e gjakut. Sasi të ulëta të kësaj vitamine mund të shkaktojnë gjakderdhje, ose vështirësi në rimëkëmbjen nga lëndimet dhe plagët.

Vitamina K bashkëshoqërohet me kalciumin për mirëmbajtjen e kockave dhe dhëmbëve. Në 30 ml lëng majdanozi gjenden 492 mikrogramë të vitaminës K, shumë më tepër se sasia e rekomanduar e kësaj vitamine për femrat dhe meshkujt.

PËRFITIMET E FOLATIT

Folati, pjesë e grupit të vitaminave B, ndihmon me funksionet e qelizave dhe indeve. Ai ndihmon organizmin të prodhojë proteinë, qeliza të kuqe të gjakut dhe ADN-në. Ajo pakëson rrezikun e shfaqjes së anemisë në rastet kur nivelet e hekurit në gjak janë të ulëta.

Folati është i nevojshëm për të pakësuar rrezikun e defekteve në lindje. Në 30 ml lëng majdanozi gjenden 46 mikrogram folat, ose 11.5 përqind të dozës së rekomanduar ditore për meshkujt dhe femrat dhe mbi 9 përqind të dozës ditore për femrat shtatzënë dhe nënat lehonë.



IPHONE DO TË RAPORTOJË AUTOMATIKISHT NË POLICI VENDNDODHJEN E PËRDORUESVE

Apple ka njoftuar se pajisjet e saj në versionin iOS 12 automatikisht do të ndajnë vendndodhjen e përdoruesve që bëjnë thirrje për një numër emergjence 911 për Amerikën e Veriut. Qëllimi i opsionit të ri është reduktimi i kohës së përgjigjes pas thirrjes së një qytetari.

Apple thotë se 80 për qind e thirrjeve në 911 vijnë nga telefonat mobil, por infrastruktura e vjetruar e bën të vështirë gjetjen e shpejtë të personit që ka bërë thirrjen. Ky ndryshim me iOS 12 është i bazuar në HELO (Hybridized Emergency Location) të Apple, i nisur në 2015, i cili do të integrohet në softuerin ekzistues të shumë qendrave 911 me ndihmën e kompanisë teknologjike RapidSOS.

SHKENCËTARËT ZBULOJNË SI TË SHPËTOHET SHKRIRJA E ANTARKTIDËS

Niveli i deteve do të rritet dhe të gjitha vendet bregdetare mund të rrezikohen seriozisht nga përbytyt, nëse nuk bëhet asgjë për ta ndaluar shkrirjen masive të akullit të detit në Antarktidë.

Këtë e mbështesin nëntë shkencëtarët që kanë marrë çmime nëpër dekada duke studiuar kontinentin e akullit dhe ujërat përreth tij. Ata propozojnë dy skenarë, bazuar në të dhënat sipas autorëve, se ç'mund të ndodhë nëse bota nuk bën asgjë.

PSE DUHET TË KUJDESEMI PËR ANTARKTIDËN?

Ka pinguinë të mrekullueshëm që jetojnë atje, por natyrisht kjo nuk është e vetmja arsye pse duhet të kujdesemi për Antarktidën. Ajo është e mbuluar

nga akuj që kanalizohen në oqeanë nëpërmjet një rrjeti të akullnajave.

Kohët e fundit, kontinenti ka parë një reduktim në shkallën e pjesëve lundruese të akujve. Këto pjesë janë zvogëluar në numër për shkak të ngrohjes së planetit tonë, mendojnë shkencëtarët.

Kontinenti është veçanërisht i ndjeshëm ndaj efekteve të ndotjes. Vrime në ozon, e cila është e përqendruar në këtë rajon, shkaktohet pjesërisht nga çlirimi i klorofluorokarboneve që vijnë nga kondicioneret ajrore, kanaçe aerosole e procese të tjera. Vrime lejon të depërtojë drita ultravjollcë, e cila kontribuon në temperatura të larta. Era e fortë perëndimore, edhe për shkak të ndryshimeve klimatike dëmton akullin e detit, transmeton.





Rritja e aciditetit të oqeanit, tani më problemi numër një në tërë botën, për shkak të rritjes së sasisë së dyoksidit të karbonit nga ndotja, gjithashtu dëmton kafshët që jetojnë në ujëra dhe mund të shkaktojë probleme riprodhuese edhe tek peshqit.

SKENARI I TMERRSHËM

Në skenarin e parë të paraqitur në raportin e ri, nëse askush nuk bën asgjë për të reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe planeti vazhdon të ngrohet, Oqeani Jugor dhe Antarktika mund të shkrihen në masë të madhe: Rreth një e katërta e vëllimit të akullit të detit ndoshta do të zhduket deri në vitin 2070.

Kjo është në krye të normës rekorde në të cilën kontinenti tashmë po humbet akullin e detit. Sipas një studimi të ri, Antarktida ka humbur mesatarisht 53 miliardë deri në 71 miliardë tonë metrikë akull midis viteve 1992 dhe 2011.

Nëse akulli i detit shkrihet, kjo do të thotë një rritje në nivelet e deteve rreth globit. Në rastin më të keq, deri në vitin 2070, deti ndoshta do të rritet rreth gjysmë metër nga ku ishte në vitin 2000. Brigjet amerikane ndoshta do të shihnin rritje edhe më të lartë të detit, gjë që do të ishte një katastrofë e pakthyeshme. Kjo do të shkaktonte rreth 1 trilionë

dollarë dëme vetëm në Shtetet e Bashkuara, besojnë studiuesit.

Në këtë skenar, temperatura mesatare do të rritet rreth 3.5 gradë Celsius. Kombet e Bashkuara konsiderojnë një rritje 2 gradë e cila edhe kjo është “katastrofike”.

SKENARI OPTIMIST

Nëse të gjithë do të punojmë së bashku duke kufizuar gazrat serrë deri në vitin 2070, skenari i dytë parashikon se ka një shans që Antarktida të jetë e ngjashme me atë që është tani.

Fletët e akullit ende do të dobësoheshin, por kjo veçse do të ngadalësohej, ashtu siç do të rritej aciditeti i oqeanit. Disa nga speciet më të ndryshme do të vazhdonin në rënie të popullsisë, por speciet tjera do të përshtateshin.

Rënia e vazhdueshme e akullit të detit do të vazhonte t'i detyronte kafshët që të ambientohen me sfidat dhe mënyrën se si do të ushqeheshin. Stabilizimi i akullit do të mund të zvogëlonte frekuencën me të cilën ndodhin ngjarje ekstreme të cilat lëndojnë këto specie. Teknologjia e zhvilluar për të ridizajnuar bazat e Antarktidës pas këtyre ndryshimeve mund të përdoret për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në pjesë të tjera të botës.

KINA NXJERR NË TREG ROBOTIN DADO

Prindërit kinezë e kanë zgjidhur çështjen se kush do t'i mbajë fëmijët e tyre.

Roboti i-Pal, që kushton 1400 dollarë, është dadoja perfekte për të vegjlit. Ai flet dy gjuhë, jep mësim matematike, tregon barsoleta dhe komunikon me fëmijët me anë të një ekrani që ka në gjoks.

Roboti sillet si një fëmijë 4-8 vjeç, duke u bërë si një pjesëtar shtesë i familjes dhe duke i hequr prindërve ngarkesën e përkujdesjes për të voglin. Një aplikacion në celular u lejon gjithashtu prindërve që të shohin dhe të dëgjojnë gjithçka që ndodh në afërsi të robotit-dado.



Para jush
kanë kaluar shumë
shembuj (popujsh).
Prandaj udhëtoni
nëpër botë
dhe shihni si ishte
fundi i atyre që i
përgënjeshtroan
profetët.

(Âl 'Imran, 137)